



Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut

# REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

ZGJEDHJET LOKALE  
17 dhe 31 tetor 2021

Misioni i ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve  
Raporti përfundimtar



Varshavë  
25 mars 2022

## PËRMBAJTJA

I.	PËRMBLEDHJE .....	1
II.	HYRJE DHE MIRËNJOHJE.....	5
III.	SFONDI DHE KONTEKSTI POLITIK.....	5
IV.	KORNIZA LIGJORE DHE SISTENMI ZGJEDHOR.....	6
V.	ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE .....	8
VI.	REGJISTRIMI I VOTUESVE .....	12
VII.	REGJISTRIMI I KANDIDATËVE.....	15
VIII.	FUSHATA.....	17
IX.	FINANCIMI I FUSHATËS.....	19
X.	MEDIAT .....	22
	A. AMBIENTI MEDIATIK .....	22
	B. KORNIZA LIGJORE.....	22
	C. MONITORIMI I MEDIAVE NGA MVZ-JA E ODIHR-IT.....	24
XI.	KUNDËRSHTIMET DHE ANKESAT .....	25
	A. KORNIZA LIGJORE.....	25
	B. KUNDËRSHTIMET PARAZGJEDHORE .....	26
	C. KUNDËRSHTIMET NË DITËN E ZGJEDHJEVE DHE PAS ZGJEDHJEVE .....	26
XII.	VËZHguesIT QYTETARË DHE NDËRKOMBËTARË.....	28
XIII.	DITËT E ZGJEDHJEVE .....	29
	A. RRETHI I PARË .....	29
	B. SHPALLJA E REZULTATEVE PËRFUNDIMTARE TË RRETHIT TË PARË .....	32
	C. RRETHI I DYTË .....	32
	D. ZHVILLIMET PAS ZGJEDHJEVE .....	33
XIV.	REKOMANDIME.....	34
	A. REKOMANDIMET PRIORITARE .....	34
	B. REKOMANDIME TË TJERA .....	35
	SHTOJCA I: REZULTATET E ZGJEDHJEVE.....	39
	SHTOJCA II: LISTA E VËZHguesVE NË MISIONIN PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE TË ODIHR-IT .....	51
	RRETH ODIHR-IT.....	55

**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT**  
**ZGJEDHJET LOKALE**  
**17 dhe 31 tetor 2021**

**Raporti përfundimtar i Misionit të ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve<sup>1</sup>**

**I. PËRMBLEDHJE**

Në përgjigje të ftesës nga autoritetet e Republikës së Maqedonisë së Veriut për t'i vëzhguar zgjedhjet lokale të 17 tetorit të vitit 2021 dhe në përputhje me mandatin e saj, Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut e OSBE-së (ODIHR) më 7 shtator e krijoi Misionin për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MVZ) për t'i vëzhguar këto zgjedhje. MVZ-ja e ODIHR-it vlerësoi se a u zhvillua procesi zgjedhor në përputhje me angazhimet e OSBE-së dhe obligimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike, dhe me legjislacionin e vendit.

Në Deklaratën e saj të Gjetjeve dhe Përfundimeve Preliminare për rrethin e parë të zgjedhjeve të lëshuar më 18 tetor, MVZ-ja e ODIHR-it përfundoi se zgjedhjet “ishin konkurruese dhe liritë themelore u respektuan gjerësisht, por mangësitë e shumta në kornizën ligjore e nënvizojnë nevojën për një reformë gjithëpërfshirëse. Partitë kryesore parlamentare gëzojnë përparësi sistemore, veçanërisht në shpërndarjen e burimeve publike për zhvillim të fushatës, duke përfshirë edhe në media. Kandidatët mund të zhvillonin fushatën lirshëm, por retorika negative, që shpesh i kishte për synim gratë, e tërhoqi vëmendjen nga debatet e fokusuar në probleme konkrete. Administrata zgjedhore e respektoi shumicën e afateve ligjore, por aftësia e saj për ta përmbushur mandatin e saj u kufizua për shkak të personelit dhe kapacitetit të kufizuar operativ. Zbatimi i vonshëm i identifikimit biometrik të votuesve krijoi sfida shtesë në administrimin e zgjedhjeve. Dita e zgjedhjeve, duke përfshirë edhe numërimin e votave, në përgjithësi, u vlerësua pozitivisht, përkundër problemeve të shpeshta me pajisjet biometrike, votimin në grup dhe disa gabimeve procedurale gjatë numërimit dhe nxjerrjes së rezultateve. Publikimi i informacionit zgjedhor gjatë gjithë ditës, duke përfshirë edhe të dhënat e rezultateve paraprake për secilin vendvotim në natën e zgjedhjeve, e rriti transparencën”. Në Deklaratën e saj të Gjetjeve dhe Përfundimeve Preliminare, MVZ-ja e ODIHR-it përfundoi se rrethi i dytë “i dytë u karakterizua nga një fushatë konkurruese në të cilën u respektuan liritë themelore, por retorika negative dhe raportimet për frikësimin e garuesve dhe presionin mbi votuesit potencialisht e tërhoqën vëmendjen nga procesi. Administrata zgjedhore bëri disa përpjekje për t'i adresuar mangësitë procedurale të vërejtura gjatë rrethit të parë, dhe dita e zgjedhjeve të rrethit të dytë kaloi pa probleme, megjithëse disa probleme vazhduan dhe mangësitë e shumta në trajtimin e kundërshtimeve i minuan mjetet efektive ligjore.

Kushtetuta i garanton liritë themelore, ndërsa Kodi Zgjedhor shërben si bazë teknike për zhvillimin e të gjitha llojeve të zgjedhjeve. Boshllëqet dhe mospërputhjet e shumta në kornizën ligjore zgjedhore, duke përfshirë edhe ato të shkaktuara nga ndryshimet e shpeshta dhe shpesh të papërputhura, e zvogëluan sigurinë ligjore dhe ndikuan negativisht në administrimin pa pengesa të zgjedhjeve. Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) miratoi rregullore për t'i plotësuar ligjet, por shumë prej tyre përmbanin mospërputhje dhe u miratuan vetëm pak para ditës së zgjedhjeve, gjë që e përkeqësoi pasigurinë ligjore. Më 15 shtator, Kuvendi miratoi një numër ndryshimesh në Kodin Zgjedhor që vlejnë për këto zgjedhje, me procedurë të shkurtuar dhe pa debat publik ose konsultim me palët kryesore të interesit që është në kundërshtim me praktikën e mira ndërkombëtare. Këto amendamente adresuan pjesërisht disa rekomandime të mëparshme të ODIHR-it, si për shembull për përcaktimin e kohëzgjatjes së mandatit të anëtarëve të KSHZ-së. Megjithatë, rekomandimet e tjera të ODIHR-it, duke përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me një rishikim gjithëpërfshirës të kornizës ligjore zgjedhor, mbeten të patrajuara.

---

<sup>1</sup> Versioni në gjuhën angleze i këtij raporti është dokumenti i vetëm zyrtar. Janë siguruar edhe përkthime jozyrtare në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe.

Shumica e bashkëbiseduesve të MVZ-së së ODIHR-it nënvizuan se reformat më gjithëpërfshirëse dhe me një proces konsultativ, mbeten të nevojshme.

Zgjedhjet lokale mbahen çdo katër vjet për të zgjedhur këshillat dhe kryetarët e 80 komunave dhe të Qytetit të Shkupit. Këshillat zgjidhen sipas sistemit proporcional me lista të mbyllura, ndërsa kryetarët e komunave zgjidhen në garë me sistemin e shumicës. Nëse asnjë kandidat për kryetar komune nuk fiton shumicën absolute të votave të hedhura në rrethin e parë të zgjedhjeve, dy javë më vonë mbahet rrethi i dytë, midis dy kandidatëve me numër më të madh votash. Kërkesa që një e treta e votuesve të regjistruar duhet të dalin në rrethin e parë që zgjedhjet për kryetar komune të jenë të vlefshme vlen edhe për zgjedhjet e përsëritura, duke krijuar mundësi për një seri të zgjedhjeve të dështuara.

Në të dyja rrethet zgjedhore Administrata zgjedhore e respektoi shumicën e afateve ligjore, përkundër afatit të ngushtë kohor për t'u përshtatur me ndryshimet e fundit dhe risitë e tjera. Megjithatë, kapaciteti i saj operativ dhe aftësia për ta kryer detyrën e saj në mënyrë të pavarur, u kufizuan për shkak të mungesës së personelit të përhershëm dhe vendet e lira në pozicionet kryesore. KSHZ-ja në përgjithësi i kreu detyrat e saj në mënyrë kolegjiale dhe mbajti mbledhje të rregullta të hapura, shumica e të cilave u transmetuan drejtpërdrejt në internet. Megjithatë, disa mbledhje të KSHZ-së nuk u lajmëruan paraprakisht, dhe jo të gjitha vendimet dhe udhëzimet u publikuan në mënyrë konsekuente dhe në kohë, gjë që e dëmtoi transparencën e përgjithshme të procesit. Megjithëse shumica e Komisioneve Zgjedhore Komunale (KZZ) dhe Komisioni Zgjedhor i Qytetit të Shkupit (KZQK) i menaxhuan përgatitjet teknike dhe administrative të zgjedhjeve në mënyrë adekuate, KZK-të dhe Këshillat Zgjedhorë (KZ) u përballën me një largim të konsiderueshëm midis anëtarëve të tyre, gjë që, në disa raste, e pengoi punën e tyre.

Shumica e bashkëbiseduesve të MVZ-së së ODIHR-it shprehën besim në saktësinë dhe besueshmërinë e regjistrimit të votuesve, megjithëse disa pranuan se një numër i konsiderueshëm i votuesve të regjistruar banojnë jashtë vendit. Qytetarët mund të privohen nga e drejta e votës me vendim të gjykatës në bazë të aftësisë së kufizuar intelektuale ose psiko-sociale, që është në kundërshtim me detyrimet dhe standardet ndërkombëtare. Kërkesa ligjore që KSHZ-ja ta mirëmbajë regjistrin e votuesve me nxjerrjen e drejtpërdrejtë të të dhënave nga Regjistri qendror i popullsisë ende nuk është zbatuar në praktikë. Qytetarët mund t'i kontrollojnë dhe të kërkojnë korrigjime në të dhënat e tyre të regjistrimit si votues qoftë online apo në zyrat rajonale të KSHZ-së, por procesit të verifikimit i mungojnë mbrojtjet adekuate për të dhënat personale dhe përfshirja në lista është e kufizuar në mënyrë të panevojshme për qytetarët që kanë letërnjoftim të vlefshëm. Identifikimi biometrik i votuesve u përdor për herë të parë në këto zgjedhje pa ndonjë projekt pilot ose testim gjithëpërfshirës. Afati i shkurtër kohor për zbatimin, e pengoi KSHZ-në që t'i miratojë në kohë aktet nënligjore, procedurat, trajnimet dhe edukimin e votuesve. Megjithatë, shumica e bashkëbiseduesve të MVZ-së së ODIHR-it, duke përfshirë partitë politike, e mirëpritën futjen në përdorim të identifikimit biometrik të votuesve, si një mjet efektiv për të parandaluar mashtrimin, duke përfshirë votimin e shumëfishtë dhe prezantimin e rrejshëm në emër të ndonjë votuesi tjetër.

Procesi i regjistrimit të kandidatëve, në përgjithësi, ishte gjithëpërfshirës. KZK-të dhe KZQK-ja regjistruan gjithsej 299 kandidatë për kryetarë të komunave dhe 571 lista këshilltarësh me 10,649 kandidatë. Kandidatët mund të emërohen nga partitë politike dhe koalicionet e partive, ose mund të kandidojnë në mënyrë të pavarur, të mbështetur nga grupe të votuesve; megjithatë, pamundësia për të garantuar individualisht për këshilltar është në kundërshtim me angazhimet e OSBE-së. Numri i nënshkrimeve mbështetëse që kërkohen për kandidaturat e pavarura tejkalon 1 për qind në shumicën e komunave, që është në kundërshtim me praktikën e mira ndërkombëtare. Personave të cilëve u është hequr e drejta e votës për shkak të aftësisë së kufizuar intelektuale ose psiko-sociale u mohohet e drejta për të kandiduar, në kundërshtim me obligimet ndërkombëtare.

Fushata zgjedhore gjatë të dy rrethëve zgjedhore ishte konkurruese, aktive dhe përgjithësisht paqësore në të gjithë vendin. Megjithëse masat e sigurisë në lidhje me pandeminë e COVID-19 ndikuan në

fushatë, të drejtat dhe liritë themelore u respektuan dhe garuesit, në përgjithësi, mund ta zhvillonin fushatën lirshëm dhe mund t'i përcillnin mesazhet e tyre. Megjithatë, retorika negative ndikoi në ambientin e fushatës dhe e tërhoqi vëmendjen nga debatet e fokusuara në probleme konkrete. Ndalimet ekzistuese për përdorimin e burimeve administrative në fushatë u përforcuan me ndryshimet e shtatorit të vitit 2021, por në mungesë të monitorimit sistematik nga institucionet përkatëse, efektiviteti i këtyre masave mbeti i paqartë. Në të dy rrethet zgjedhore, vëzhguesit e MVZ-së së ODIHR-it pranuan raportime të vazhdueshme, disa prej të cilave ishin të dokumentuara, për presion ndaj votuesve, duke përfshirë edhe ndaj nëpunësve publikë, për të votuar për garues të caktuar, si dhe për presion ndaj kandidatëve. Në rrethin e parë, MVZ-ja e ODIHR-it gjithashtu vuri në dukje raste të izoluar të frikësimit të kandidatëve dhe pranoi pretendime për presion ndaj kandidatëve për t'u tërhequr. MVZ-ja e ODIHR-it gjithashtu pranoi pretendime për blerje votash. Megjithëse disa hetime të rasteve individuale u iniciuan para të dy ditëve të zgjedhjeve, liderët politikë në përgjithësi nuk reagueshin ndaj këtyre pretendimeve ose nuk dhanë deklarata për t'i dekurajuar veprimet e tilla.

Në përgjithësi, gratë ishin më pak të përfaqësuara në procesin zgjedhor. Përbërja e organeve për menaxhimin e zgjedhjeve në përgjithësi ishte në përputhje me kërkesat ligjore për përfaqësimin gjinor dhe etnik, por vetëm dy nga shtatë anëtarët e KSHZ-së janë gra. Gratë përbënin rreth 45 për qind të të gjithë kandidatëve për këshilltarë, në përputhje me kërkesat ligjore për përfaqësimin gjinor, dhe ishin bartëse në 111 lista, mirëpo vetëm 8 për qind e kandidatëve për kryetarë komune ishin gra. Në mungesë të rregulloreve të qarta për zhvillim të fushatës në rrjetet sociale dhe për moderim efektiv të komenteve nga partitë dhe kandidatët në faqet e tyre në mediat sociale, shumë kandidatë, shpesh herë gratë, ishin në shënjestër të gjuhës fyese. Çështjet që lidhen me barazinë gjinore dhe të drejtat e grave kryesisht mungonin në platformat dhe fjalimet e garuesve, dhe gratë nuk ishin të përfaqësuara në mënyrë adekuat në fushatat e partive.

Përkundër kornizës gjithëpërfshirëse ligjore për financimin e fushatës, disa zbrazëtira dhe mospërputhje mbeten, e po ashtu edhe rekomandimet e institucioneve përkatëse nuk janë zbatuar. Fushatat zgjedhore mund të financohen nga fondet vetanake të partive politike dhe kreditë bankare, si dhe nga donacionet. Ligji i përcakton shumat maksimale për donacionet dhe shpenzimet e fushatës dhe parashikon sanksione për shkeljen e rregullave të financimit të fushatës. Megjithatë, nga garuesit nuk u kërkua t'i shpalosin të gjitha burimet e të ardhurave, apo shpenzimet, përpara ditëve të zgjedhjeve, që është në kundërshtim me praktikën e mirë ndërkombe. Edhe pse disa garues nuk arritën të dorëzojnë asnjë raport të përkohshëm për financimin e fushatës, nuk u shqiptua asnjë sanksion. Në përgjithësi, informacioni i kufizuar publik edhe mbikëqyrja e pamjaftueshme e zvogëloi transparencën dhe e minoi zbulimin dhe parandalimin e shkeljeve të mundshme.

Monitorimi i mediave nga MVZ-ja e ODIHR-it zbuloi se mbulimi i përgjithshëm në lidhje me zgjedhjet në të dy rrethet ishte me ton neutral. Gjatë periudhës së fushatës zyrtare, dy partitë më të mëdha dominuan në lajmet e transmetuesve kombëtarë të monitoruar, ndërsa partitë më të vogla dhe kandidatët e pavarur patën mbulim të kufizuar në mediat kombëtare në të dy rrethet. Pasi që kishte më pak kandidatë në rrethin e dytë, transmetuesit e monitoruar u ofruan votuesve informata të mjaftueshme për garuesit. Përkundër rekomandimeve të mëparshme të ODIHR-it, Kodi Zgjedhor vazhdon ta përcaktojë përmbajtjen e lajmeve të transmetuesit publik. Reklamat e paguara në mediat transmetuese, të shkruara dhe ato online gjatë fushatës financohen drejtpërdrejt dhe ekskluzivisht nga buxheti i shtetit, gjë që u kritikua nga disa bashkëbisedues se e inkurajon klientelizmin. Rregullorja joadekuate për shpërndarjen e këtyre mjeteve midis garuesve bëri që në të dy rrethet, pjesa dërrmuese e kohës së transmetimit dhe e mjeteve shtetërore për reklamim në media iu ndanë partive më të mëdha. Ndonëse në përputhje me ligjin, kjo gjë i vuri në pozitë të pafavorshme kandidatët e partive më të vogla dhe garuesit e pavarur, në kundërshtim me angazhimet e OSBE-së dhe praktikën e mira ndërkombe.

Legjislacioni për zgjidhjen e kontesteve zgjedhore përmban zbrazëtira dhe paqartësi të shumta, të cilat e pengojnë procesin, ndërsa afatet e reja kohore, të përcaktuara me ndryshimet më të fundit në Kodin

Zgjedhor, krijuan paqartësi shtesë. Rekomandimet e mëparshme të ODIHR-it në lidhje me shqyrtimin e kontesteve zgjedhore mbeten të patrajtuara, duke përfshirë edhe bazën ligjore për të parashtruar kundërshtime. Mungesa e përgjithshme e njohjes së procedurave për trajtimin e kundërshtimeve të parashtruara nga votuesit në radhët e KZK-ve çoi zbatimin jokonsekuent të tyre. Si rezultat i kësaj, një numër kundërshtimesh të tilla nuk u trajtuan, duke i privuar ata votues nga mundësia për të votuar dhe duke i minuar mjetet efektive ligjore. Mangësitë e shumta në trajtimin e ankesave në KSHZ, duke përfshirë zbatimin formalist ose jokonsekuent të kërkesave për pranueshmërinë e tyre dhe mospublikimi i vendimeve, e minuan të drejtën për mjet efektiv ligjor dhe e zvogëluan transparencën. Përkundër kërkesës ligjore për të mbajtur seancë publike, Gjykata Administrative shumicën e ankesave e shqyrtoi pa seancë publike, që është në kundërshtim me detyrimet ndërkombëtare.

Kodi Zgjedhor parashikon vëzhgimin qytetar dhe ndërkombëtar, e gjithashtu u jep të drejtë garuesve të regjistruar të caktojnë përfaqësuesit e tyre të autorizuar për ta ndjekur të gjithë procesin zgjedhor, gjë që kontribuoi për transparencën e procesit. Kapaciteti dhe interesimi i organizatave të shoqërisë civile për të vëzhguar ishte i kufizuar në këto zgjedhje. Gjithsej, për të dy rrethet zgjedhore, KSHZ-ja akreditoi 7 organizata vëzhguese qytetare me gjithsej 1,210 vëzhgues, si dhe 2 organizata ndërkombëtare dhe 19 delegacione diplomatike dhe të huaja. Në mënyrë gjithëpërfshirëse, KSHZ-ja e zgjati periudhën e akreditimit të vëzhguesve për të gjitha organizatat që dëshirojnë ta vëzhgojnë rrethin e dytë, dhe akreditimet e lëshuara në rrethin e parë mbetën të vlefshme. Përkundër apeleve të vazhdueshme të KSHZ-së, pengesat për disa vëzhgues dhe gazetarë në disa vendvotime vazhduan.

Dita e zgjedhjeve e rrethit të parë më 17 tetor ishte në përgjithësi paqësore, me një pjesëmarrje prej 51.4 për qind të votuesve, të shpallur nga KSHZ-ja. Vëzhguesit e MVZ-së së ODIHR-it i vlerësuan pozitivisht proceset e hapjes dhe të votimit në vendvotimet e vëzhguara, megjithatë vunë re probleme të shpeshta me pajisjet identifikuese biometrike, në veçanti dështimin e përhapur të pajisjeve për të skenuar me sukses gjurmët e gishtërinjve të votuesve. Ndërsa procedurat e votimit në përgjithësi u respektuan, ashtu si edhe masat e mbrojtjes nga KOVID-19, vëzhguesit e MVZ-së së ODIHR-it vunë re probleme me fshehtësinë e votës, si dhe votimin në grup të përhapur gjerësisht, që ndikon negativisht në pjesëmarrjen e grave. Numërimi i votave u vlerësua pozitivisht në pjesën dërrmuese të vendvotimeve ku u vëzhgua ky proces, por vëzhguesit e MVZ-së së ODIHR-it raportuan se shumë KZ nuk i ndoqën procedurat e përcaktuara dhe kishin vështirësi në kompletimin e protokolleve të rezultateve. Megjithëse vëzhguesit e MVZ-së të ODIHR-it vlerësuan se përcaktimi i vlefshmërisë së fletëvotimeve ishte në përgjithësi i arsyeshëm dhe konsekuent, një numër i konsiderueshëm e fletëvotimeve të pavlefshme u vunë re në të gjithë vendin. Procesi i nxjerrjes së rezultateve u vlerësua negativisht në shumë raporte që u dorëzuan nga vëzhguesit e MVZ-së së ODIHR-it, kryesisht për shkak të kushteve të joadekuate dhe organizimit të dobët.

Në përputhje me metodologjinë e ODIHR-it, në mungesë të vëzhguesve afatshkurtër për rrethin e dytë, MVZ-ja e ODIHR-it nuk i vëzhgoi procedurat e ditës së zgjedhjeve më 31 tetor në mënyrë sistematike ose gjithëpërfshirëse, por anëtarët e misionit vizituan një numër të kufizuar vendvotimesh. Procesi i votimit në vendvotimet e vizituara u vlerësua se ishte i organizuar mirë, transparent dhe i qetë, megjithëse autoritetet raportuan incidente të izoluara. Megjithëse procedurat e përcaktuara u respektuan në masë të madhe, vazhduan disa probleme të vërejtura në rrethin e parë, duke përfshirë problemet teknike me identifikimin biometrik të votuesve. Numërimet e pakta të votave që u vëzhguan ishin kryesisht transparente, por respektimi i procedurave të përcaktuara ndryshonte ndjeshëm. KSHZ-ja njoftoi se pjesëmarrja në votime ishte 49.65 për qind dhe filloi t'i publikojë rezultatet preliminare menjëherë pas mbylljes së votimit, duke e rritur kështu transparencën.

Ky raport ofron një numër rekomandimesh për t'i mbështetur përpjekjet për t'i afruar zgjedhjet në Maqedoninë e Veriut në përputhje me përkushtimet e OSBE-së dhe obligimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike. Rekomandimet prioritare kanë të bëjnë me kornizën ligjore, administratën zgjedhore, të drejtat e votës, regjistrimin e votuesve, presionin ndaj votuesve dhe

nëpunësve shtetërorë dhe publikë, financimin e fushatës, shqyrtimin e mosmarrëveshjeve zgjedhore dhe mediat. OSBE/ODIHR-i është i gatshëm që t'u ndihmojë autoriteteve për ta përmirësuar më tej procesin zgjedhor dhe për t'i trajtuar rekomandimet që gjenden në këtë raport dhe në raportet e mëparshme.

## II. HYRJE DHE MIRËNJOHJE

Në përgjigje të ftesës nga autoritetet e Republikës së Maqedonisë së Veriut për t'i vëzhguar zgjedhjet lokale të 17 tetorit të vitit 2021 dhe në përputhje me mandatin e saj, Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut e OSBE-së (ODIHR) më 7 shtator e krijoi Misionin për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MVZ). Misioni i udhëhequr nga Tana de Zulueta, përbëhej nga 16 anëtarë të ekipit kryesor në Shkup dhe 20 vëzhgues afatgjatë, të cilët më 15 shtator u shpërndanë në 9 lokacione në mbarë vendin. Në ditën e zgjedhjeve të rrethit të parë më 17 tetor, MVZ-ja e ODIHR-it shpërndau 165 vëzhgues nga 29 vende. Gratë përbënin 48 për qind të vëzhguesve të ODIHR-it të shpërndarë në rrethin e parë. Për rrethin e dytë më 31 tetor, në vend mbetën 13 anëtarë të ekipit kryesor dhe 10 vëzhgues afatgjatë. Vëzhguesit e ODIHR-it për rrethin e dytë erdhën nga 13 vende. Pesëmbëdhjetë nga vëzhguesit e ODIHR-it në rrethin e dytë ishin gra. MVZ-ja e ODIHR-it qëndroi në vend deri më 3 nëntor.

MVZ-ja e ODIHR-it vlerësoi se a u zhvillua procesi zgjedhor në përputhje me angazhimet e OSBE-së dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike, si dhe me legjislacionin e vendit. Ky raport përfundimtar pason pas dy Deklaratave për gjetjet dhe përfundimet paraprake, që u publikuan më 18 tetor dhe 1 nëntor të viti 2021.<sup>2</sup>

MVZ-ja e ODIHR-it dëshiron të falënderojë autoritetet e Maqedonisë së veriut për ftesën e tyre për të vëzhguar zgjedhjet, dhe Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ) dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme për ndihmën dhe bashkëpunimin e tyre. Ajo gjithashtu shpreh mirënjohjen e saj për institucionet e tjera shtetërore kombëtare dhe lokale, partitë politike dhe koalicionet, kandidatët, shoqërinë civile, mediat, përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare dhe bashkëbiseduesit e tjerë për ndarjen e pikëpamjeve të tyre dhe për bashkëpunimin e tyre.

## III. SFONDI DHE KONTEKSTI POLITIK

Më 6 gusht të vitit 2021, Kryetari i Kuvendit i shpalli zgjedhjet lokale për më 17 tetor. Zgjedhjet e mëparshme lokale u mbajtën në vitin 2017, kur koalicioni zgjedhor i udhëhequr nga Lidhja Social Demokratike e Maqedonisë (LSDM), e cila kishte krijuar qeveri pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të mbajtura në dhjetor të vitit 2016, fitoi kontrollin në shumicën e komunave.<sup>3</sup> Qeveria, e kryesuar nga kryetari i LSDM-së, Zoran Zaev, u mbështet nga një koalicion i LSDM-së, Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI-së) dhe disa partive më të vogla politike.<sup>4</sup>

Gratë janë më pak të përfaqësuara në funksionet e zgjedhura publike, me 45 nga 120 vende (37.5 për qind) në kuvendin aktual, dhe 4 nga 15 postet ministore në qeveri. Në zgjedhjet lokale të vitit 2017,

<sup>2</sup> Shih [raportet e mëparshme ODIHR-it për zgjedhjet në Maqedoninë e Veriut](#). ODIHR ka miratuar [Deklaratën e Parimeve për Vëzhgimin Ndërkombëtar të Zgjedhjeve të vitit 2005](#).

<sup>3</sup> Pas zgjedhjeve lokale të vitit 2017, nga 80 komuna dhe Qyteti i Shkupit, LSDM-ja mbajti 57 kryetarë komunash, Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI) i shqiptarëve etnikë - 10, Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase - Partia Demokratike për Unitetin Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE) - 5, dhe Aleanca për Shqiptarët (ASH) - 3, ndërsa 3 kryetarë komunash ishin të pavarur. Partia Demokratike e Shqiptarëve (PDSH), Lëvizja BESA e shqiptarëve etnikë (BESA) dhe Partia Demokratike e Turqve në Maqedoni (PDTM) mbajti nga një kryetar komune.

<sup>4</sup> Qeveria përfshinte gjithashtu një ministër nga BESA dhe një nga Partia Liberal Demokratike (PLD). Koalicioni i udhëhequr nga LSDM-ja që i fitoi zgjedhjet e parakohshme parlamentare në vitin 2020 përfshinte 20 parti më të vogla.

gratë u zgjodhën në vetëm 6 nga 81 postet e kryetarëve të komunave, dhe 455 nga 1,388 këshilltarë të zgjedhur ishin gra (33.7 për qind).

Në periudhën para këtyre zgjedhjeve, çështjet e politikës kombëtare dhe ndërkombëtare dominuan në debatin publik dhe u reflektuan përfundimisht në fushatat e zgjedhjeve lokale. Këto përfshinin aspiratat e vendit për anëtarësimin në Bashkimin Evropian (BE) dhe vonesat e vazhdueshme të bisedimeve për anëtarësim, mosmarrëveshjet mbi menaxhimin e pandemisë së KOVID-19 nga qeveria, dhe situatën ekonomike, veçanërisht shkallën e lartë të papunësisë dhe të emigracionit. Regjistrimi i popullsisë, i pari që nga viti 2002, u krye midis 5 dhe 30 shtatorit, edhe pse pati kërkesa për ta zgjatur periudhën e regjistrimit dhe pretendime nga partitë opozitare se metodologjia ishte joadekuate.<sup>5</sup>

#### IV. KORNIZA LIGJORE DHE SISTENMI ZGJEDHOR

Zgjedhjet lokale janë të rregulluara kryesisht me Kushtetutën e vitit 1991, Kodin Zgjedhor të vitit 2006, dhe aktet e tjera relevante. duke përfshirë Ligjin për Financimin e Partive Politike të vitit 2004, , Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave të vitit 2019, Ligjin për Mediat të vitit 2013 dhe Ligjin për Shërbimet Audio dhe Audio-Vizuale Mediatike të vitit 2013. Maqedonia e Veriut i ka ratifikuar instrumentet kryesore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut që kanë të bëjnë me mbajtjen e zgjedhjeve demokratike.<sup>6</sup>

Kushtetuta i garanton liritë themelore, ndërsa Kodi Zgjedhor shërben si bazë teknike për zhvillimin e të gjitha llojeve të zgjedhjeve. Zbrazëtitat dhe mospërputhjet e shumta në Kodin Zgjedhor, duke përfshirë edhe ato të shkaktuara nga ndryshimet e shpeshta dhe shpesh të papërputhura, e zvogëluan sigurinë ligjore dhe ndikuan negativisht në administrimin pa pengesa të këtyre zgjedhjeve. KSHZ-ja miratoi rregullore për t'i plotësuar ligjet ekzistuese, por shumë nga këto rregullore përmbanin mospërputhje dhe u miratuan vetëm pak para ditës së zgjedhjeve, gjë që e përkeqësoi më tej pasigurinë ligjore.

Kodi Zgjedhor është ndryshuar ndjeshëm që nga zgjedhjet e mëparshme lokale, duke përfshirë edhe dy herë në vitin 2021.<sup>7</sup> Në një mbledhje të paparaparë më 15 shtator, në kundërshtim me praktikën e mira ndërkombëtare, Kuvendi miratoi një numër ndryshimesh që vlejnin për këto zgjedhje lokale.<sup>8</sup> Me këto ndryshime, ndër të tjera, u përcaktua kohëzgjatja e mandatit të anëtarëve të KSHZ-së, u mundësua tërheqja e listave të kandidatëve brenda 48 orëve nga regjistrimi, si dhe u përcaktua përgjegjësia e pjesëmarrësve në fushatë për përmbajtjen e reklamave të fushatës, duke i trajtuar kështu disa rekomandime të mëparshme të ODIHR-it. Me këto ndryshime gjithashtu u rregulluan disa aspekte të procedurave zgjedhore gjatë një pandemie, si dhe përdorimi e automjeteve publike gjatë periudhës

<sup>5</sup> Për shembull, partitë AA dhe "Levica" (E Majta) e kritikuan metodologjinë dhe kërkuan zgjatjen e regjistrimit, duke pretenduar se nuk ishin përfshirë të gjithë qytetarët.

<sup>6</sup> Duke përfshirë Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike të vitit 1966 (PNDCP), Konventën Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor të vitit 1965 (KNEDR), Konventën e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave të vitit 1979 (KEDNG), Konventën e KB-së kundër Korrupsionit të vitit 2003 (KKBKK), Konventën e KB-së për të Drejtat e të Personave me Aftësi të Kufizuara të vitit 2006 (KDPK), dhe Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore të vitit 1950 (KEDNJ). Maqedonia e Veriut është anëtare e Komisionit Evropian për Demokraci përmes Ligjit të Këshillit të Evropës (Komisioni i Venedikut) dhe e Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO).

<sup>7</sup> Më 2 prill u miratuan ndryshimet për t'i plotësuar dispozitat për identifikimin biometrik të votuesve. Më parë, ndryshimet në Kodin Zgjedhor u miratuan në shkurt të vitit 2020, duke ndikuar në shumicën e procedurave zgjedhore dhe përgjegjësitë kryesore të administratës zgjedhore. Kodi u ndryshua gjithashtu në vitin 2017, 2018 dhe 2019.

<sup>8</sup> Seksioni 5 i Deklaratës Interpretuese të Komisionit të Venedikut i vitit 2005 mbi Stabilitetin e Legjisllacionit Zgjedhor [Deklarata Interpretative mbi Stabilitetin e Legjisllacionit Zgjedhor e vitit 2005](#) parashikon që "çdo reformë e legjisllacionit zgjedhor që do të zbatohet gjatë zgjedhjeve duhet të bëhet mjaft herët që të mund të zbatohet me të vërtetë në zgjedhje".



zgjedhore, dhe u shkurtua afati për dorëzimin e raporteve përfundimtare të financimit të fushatës. Përkundër ndryshimeve të shpeshta të Kodit Zgjedhor, një numër rekomandimesh të ODIHR-it mbeten të patrajtuara, duke i përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me një rishikim gjithëpërfshirës të kornizës ligjore zgjedhore.<sup>9</sup>

Amendamentet e 15 shtatorit u miratuan me procedurë të shkurtuar, pa debat paraprak publik dhe pa konsultim me palët kryesore të interesuara, duke përfshirë institucionet përkatëse shtetërore, të cilat i shprehën shqetësime MVZ-së së ODIHR-it në lidhje me miratimin e nxituar të ndryshimeve të rëndësishme dhe për kapacitetin teknik për t'i zbatuar ato në kohën e kufizuar që ishte në dispozicion përpara ditës së zgjedhjeve.<sup>10</sup> Megjithëse Ministria e Drejtësisë në janar formoi një grup pune ndërinstytucional i përbërë nga përfaqësues të partive politike, organizatave të shoqërisë civile (OSHC), komuniteti i ekspertëve dhe organizatave ndërkombëtare, për të propozuar ndryshime në Kodin Zgjedhor, MVZ-ja e ODIHR-it u informua se partitë politike në përgjithësi, ishin ngurruese për të kontribuar në punën e tij dhe se shumë sugjerime nga grupi i punës nuk u morën parasysh nga Kuvendi.<sup>11</sup>

*Korniza ligjore duhet të rishikohet në mënyrë gjithëpërfshirëse për t'i trajtuar të gjitha rekomandimet e patrajtuara të ODIHR-it dhe për të eliminuar zbrazëtirat dhe mospërputhjet e shumta ekzistuese. Kuvendi duhet ta bëjë këtë rishikim shumë përpara zgjedhjeve të ardhshme, pas një procesi konsultimi të hapur dhe gjithëpërfshirës, në të cilin propozimet nga të gjitha palët e interesuara do të merren parasysh me seriozitet.*

Zgjedhjet lokale mbahen çdo katër vjet për të zgjedhur këshillat dhe kryetarët e 80 komunave dhe të Qytetit të Shkupit. Këshillat komunalë zgjidhen sipas sistemit proporcional me lista të mbyllura, pa prag të përcaktuar. Numri i këshilltarëve në secilën komunë varion nga 9 deri në 33, varësisht nga numri i popullsisë.<sup>12</sup>

Kryetarët e komunave zgjidhen me sistem të shumicës. Për t'u zgjedhur në rrethin e parë, kandidati duhet të fitojë shumicën absolute të votave të hedhura. Përndryshe, dy javë më vonë zhvillohet rrethi i dytë, mes dy kandidatëve me më shumë vota. Një e treta e votuesve të regjistruar duhet të dalin në zgjedhjet për kryetar komune, që ato të jenë të vlefshme në rrethin e parë. Nëse nuk arrihet pragu i kërkuar, zgjedhjet duhet të përsëriten. Megjithatë, Kodi Zgjedhor nuk përcakton se kur duhet të mbahet votimi i përsëritur.<sup>13</sup> Për zgjedhjet e përsëritura vlen e njëjta kërkesë për dalje në zgjedhje, duke krijuar mundësi për një cikël të zgjedhjeve të dështuara.

*Ligji duhet të përcaktojë një afat kohor të qartë për mbajtjen e zgjedhjeve të përsëritura në rastet kur kërkesa për pjesëmarrje nuk plotësohet në rrethin e parë të zgjedhjeve për kryetar komune. Për të zvogëluar rrezikun e zgjedhjeve të dështuara, kërkesa për pjesëmarrjen e votuesve për zgjedhjet e përsëritura mund të rishyrtohet.*

<sup>9</sup> Megjithëse Kuvendi njoftoi se ndryshimet e shtatorit të vitit 2021 rrjedhin nga rekomandimet e mëparshme të ODIHR-it, MVZ-ja e ODIHR-it u informua se një reformë zgjedhore gjithëpërfshirëse është planifikuar për periudhën pas zgjedhjeve lokale të vitit 2021 për t'i implementuar, ndër të tjera, rekomandimet e ODIHR-it të cilat mbeten të patrajtuara.

<sup>10</sup> Ndryshimet u parashtruan nda deputetët e gjashtë grupeve parlamentare, që përfaqësonin edhe pushtetin edhe opozitën, dhe u miratuan pothuajse unanimisht (78 vota për, 2 kundër dhe 1 abstenim).

<sup>11</sup> Grupi i punës u krijua në vitin 2015 dhe u riformua pas një marrëveshjeje të korrikut të vitit 2016 midis katër partive politike dhe i zhvilloi aktivitetet e tij nën koordinimin e Ministrisë së Drejtësisë.

<sup>12</sup> Këshilli i Qytetit të Shkupit ka 45 këshilltarë. Mandatet e këshillave shpërndahen duke përdorur formulën e d'Hondt-it.

<sup>13</sup> Zgjedhjet për kryetar komune u shpallën të pavlefshme në komunat e Qendrës së Zhupës dhe në Mavrovë dhe Rostushë, ku në rrethin e parë në votim dolën 25,78 dhe 32,00 për qind e votuesve, respektivisht.

## V. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE

Zgjedhjet lokale u administruan nga një strukturë me tre nivele, e udhëhequr nga KSHZ-ja dhe e përbërë nga 80 Komisione Zgjedhore Komunale (KZK) dhe Komisioni Zgjedhor i Qytetit të Shkupit (KZQK), 3,384 Këshilla Zgjedhorë (KZ), si dhe 88 Këshilla Zgjedhorë të veçanta, të krijuara për ta menaxhuar votimin e hershëm për votuesit pozitivë ndaj COVID-19 dhe ata që janë në vetizolim.<sup>14</sup> Garat për kryetar komune në rrethin e dytë u zhvilluan nën administrimin e 50 KZK-ve dhe KZQK-së, 2,394 KZ-ve dhe 42 KZ-ve të posaçme.

KSHZ-ja është organ i përhershëm dhe autoriteti më i lartë zgjedhor me kompetenca rregullatore, monitoruese dhe mbikëqyrëse. KSHZ-ja është e përbërë nga shtatë anëtarë të cilët zgjidhen nga Kuvendi.<sup>15</sup> KSHZ-ja në përbërjen e saj aktuale u emërua në janar të vitit 2021 për një mandat maksimal prej dy vjetësh. Amendamentet e 15 shtatorit e përcaktuan dhe zgjatën mandatin e KSHZ-së në pesë vjet, duke i trajtuar kështu rekomandimet e mëparshme të ODIHR-it. Për çështjet administrative dhe organizative, KSHZ-ja ndihmohet nga shërbimi profesional, i udhëhequr nga sekretari i përgjithshëm. Në të gjithë vendin, KSHZ-ja mbështetet nga 34 zyra të përhershme rajonale.<sup>16</sup>

Përkundër afatit kohor të ngushtë për t'u përshtatur me amendamentet e fundit dhe kohës së kufizuar në prag të rrethit të dytë, organet e administratës zgjedhore e respektuan shumicën e afateve ligjore në të dy rrethet. Megjithatë, kapaciteti operativ i administratës zgjedhore dhe aftësia e saj për ta përmbushur mandatin e saj në mënyrë të pavarur u kufizua për shkak të mungesës së personelit të përhershëm. ODIHR-i e ka kritikuar më parë kapacitetin e pamjaftueshëm të departamentit të saj të TI-së dhe atij juridik. Kapaciteti i përgjithshëm organizativ i KSHZ-së dhe i strukturave të tij administrative u përkeqësua edhe më shumë nga mungesa e stërzgatur e Sekretarit të përgjithshëm.<sup>17</sup> KSHZ-ja e informoi MVZ-në e ODIHR-it se kufizimet administrative dhe buxhetore që ndikojnë në punësimet në KSHZ, e kufizojnë aftësinë e komisionit për të siguruar nivele të duhura të personelit dhe në fund mund të rezultojnë me mbylljen e disa zyrave rajonale të KSHZ-së.

*Për të garantuar pavarësinë operative dhe efikasitetin e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, autoritetet duhet të garantojnë që ai të marrë një shumë adekuate dhe në kohë nga buxheti. Kapacitetet e personelit të Komisionit duhet të përputhen me përgjegjësitë që i janë dhënë Komisionit sipas Kodit Zgjedhor, me ç'rast personeli thelbësor duhet të jetë i punësuar në mënyrë të përhershme.*

KZK-të dhe KZQSh-ja aktuale, si dhe anëtarët jopartiakë të KZ-ve, u emëruan në qershor dhe korrik të vitit 2021, me mandate pesëvjeçare dhe katërvjeçare, respektivisht.<sup>18</sup> KZK-të e mbikëqyrën

<sup>14</sup> Më 30 shtator, KSHZ-ja miratoi një vendim në lidhje me 96 vendvotime të cilat kanë më pak se numri minimal prej 10 votuesve të regjistruar që kërkohet për krijimin e një vendvotimi dhe të cila, për këtë arsye, nuk u hapën në ditën e zgjedhjeve. Votuesit e caktuar në këto vendvotime mund të votonin në vendvotimin më të afërt.

<sup>15</sup> Pas një procesi të hapur të rekrutimit, katër anëtarë, duke përfshirë edhe nënkryetarin, nga partitë në pushtet, ndërsa tre anëtarë, duke përfshirë edhe kryetarin, nga partitë opozitare, nga një listë e aplikuesve. Ndryshimet e shtatorit të vitit 2021 përcaktojnë se në rast të ndryshimit të qeverisë, përbërja e KSHZ-së duhet të përshtatet dhe duhet të emërohet sekretar i përgjithshëm i ri.

<sup>16</sup> Kompetencat kryesore të zyrave rajonale të KSHZ-së kanë të bëjnë me identifikimin dhe inspektimin e objekteve të vendvotimeve, përditësimin e listave të votuesve dhe administrimin e mbledhjes së nënshkrimeve mbështetëse për emërimin e kandidatëve.

<sup>17</sup> Mandati i sekretarit të përgjithshëm të mëparshëm skadoi në janar të vitit 2021 dhe që atëherë pozita është e paplotësuar.

<sup>18</sup> KZK-të dhe KZQSh-ja përbëhen nga pesë anëtarë dhe zëvendësit e tyre, të zgjedhur në mënyrë të rastësishme nga KSHZ-ja nga radhët e punonjësve të administratës shtetërore dhe komunale. KZ-të përbëhen nga tre anëtarë dhe zëvendësit e tyre, të përzgjedhur në mënyrë të rastësishme nga radhët e nëpunësve publikë dhe shtetërorë, dhe dy anëtarë të përkohshëm dhe zëvendësit e tyre, të emëruar nga partitë parlamentare për çdo zgjedhje. KZ-të e posaçme përfshinin tre punonjës shëndetësorë dhe dy përfaqësues të partive politike. Secila nga dy partitë në pushtet dhe dy partitë opozitare, që kanë fituar numrin më të madh të votave në zgjedhjet e fundit parlamentare, emërojnë nga një anëtar dhe një zëvendës.

administrimin e zgjedhjeve në komunën përkatëse, i regjistruan kandidatët, i emëruan KZ-të, dhe menaxhuan me përgatitjet e tjera teknike. Që nga emërimi i tyre fillestar, përbërja e KZK-ve dhe KZ-ve u ndikua nga një largim i konsiderueshëm midis anëtarëve të përzgjedhur, gjë që, në disa raste, e pengoi funksionimin e KZK-ve gjatë përgatitjeve zgjedhore. Një numër i konsiderueshëm i zëvendësimeve u bë pak para ditës së zgjedhjeve të rrethit të parë, gjatë trajnimeve që ishin duke u zhvilluar ose pas përfundimit të tyre, gjë që e zvogëloi vlerën dhe ndikimin e trajnimeve. Përderisa përbërja e shumicës së organeve zgjedhore të niveleve më të ulëta mbeti kryesisht e pandryshuar për rrethin e dytë, KSHZ-ja shkarkoi në tërësi dy KZ, si dhe disa anëtarë të KZK-së në Dibër, për shkak të mangësive procedurale që çuan në anulimin e rezultateve të vendotimeve përkatëse.<sup>19</sup> Procesi i përzgjedhjes së zëvendësve u vështirësua për shkak të bazës së vjetruar të të dhënave të punonjësve të sektorit publik, e cila mirëmbahet nga Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës mbi bazën e të dhënave të ofruara nga institucione të tjera shtetërore dhe publike, e cila përmban të dhëna të kategorive të papërshtatshme të nëpunësve shtetërorë dhe publikë, si dhe të dhënat e individëve që nuk janë më të punësuar në sektorin publik.

*Siç është rekomanduar më parë, baza e të dhënave e nëpunësve shtetërorë dhe publikë që përdoret për përzgjedhjen e zyrtarëve zgjedhorë duhet të përditësohet, në mënyrë që të sigurohet një proces pa pengesa dhe efikas i përzgjedhjes. Mund të rishikohet grupi i institucioneve nga të cilat angazhohen nëpunësit për të shërbyer në organet zgjedhore.*

Përbërja e organeve për menaxhimin e zgjedhjeve ishte në përputhje me kërkesat ligjore për përfaqësimin gjinor dhe etnik.<sup>20</sup> Megjithëse gratë ishin të përfaqësuara mirë në organet zgjedhore të nivelit më të ulët, me ç'rast 49 për qind e anëtarëve të KZK-ve dhe të KZQSh-së ishin gra, dhe ato kryesonin mbi 39 komisione të nivelit të mesëm, vetëm 2 nga 7 anëtarët e KSHZ-së, duke përfshirë edhe nënkryetarin, janë gra, që është më pak se kuota e kërkuar. KSHZ-ja nuk publikoi të dhëna të ndara sipas gjinisë për përbërjen e KZ-ve. Në ditën e zgjedhjeve të rrethit të parë, gratë kryesuan mbi 55 për qind të KZ-ve në vendvotimet e vizituara nga vëzhguesit e MVZ-së së ODIHR-it.

KSHZ-ja në përgjithësi i kreu detyrat e saj në mënyrë kolegjinale. Megjithatë, kolegjaliteti i punës së Komisionit herë pas herë u minua për shkak të mungesës së koordinimit të brendshëm dhe shkëmbimit të informatave, që u shfaq kryesisht në prag të rrethit të dytë. Në kundërshtim me kërkesat e parapara në Kodin Zgjedhor, kërkesat e dorëzuara nga një anëtar i KSHZ-së pas rrethit të parë për të shqyrtuar të gjithë materialin zgjedhor të një vendvotimi ku votimi ishte anuluar dhe për të bërë një krahasim të plotë të gjurmëve të mbledhura të gishtave të votuesve në listat e shtypura e po ashtu edhe në listat elektronike të votuesve nuk u morën parasysh.

Gjatë periudhës zgjedhore, KSHZ mbajti mbledhje të rregullta publike, të cilat ishin të hapura për mediat, vëzhguesit dhe përfaqësuesit e autorizuar të kandidatëve dhe të cilat u transmetuan drejtpërdrejt në internet, me ç'rast incizimet ishin në dispozicion edhe në kanalën e KSHZ-së në YouTube.<sup>21</sup> Mbledhjet u lajmëruan vetëm përmes listës zyrtare të e-mail-eve, shpesh pak para se të mbahen mbledhjet. Pas rrethit të parë, disa mbledhje, duke i përfshirë edhe ato për shpalljen e rezultateve përfundimtare të rrethit të parë dhe për modifikimet e disa procedurave zgjedhore përpara rrethit të dytë,

<sup>19</sup> Në vendvotimin 0543 në Dibër, ku 172 votues (rreth 22 për qind e numrit të përgjithshëm të votuesve të regjistruar në këtë vendvotim) nuk u njohën nga pajisja për identifikimin biometrik të votuesve, as anëtarët e KZ-së, përveç zëvendëskryetarit, e as anëtarët e KZK-së nuk e nënshkruan protokollin, duke e bërë kështu protokollin e rezultateve të pavlefshëm. Në vendvotimin 2957/1 në komunën Shuto Orizare të Shkupit, një numër i konsiderueshëm i fletëvotimeve u shpallën të pavlefshme për shkak se nuk ishin të vulosura me vulën zyrtare të KZ-së para se t'u jepen votuesve.

<sup>20</sup> Çdo gjini duhet të përfaqësohet nga të paktën 30 për qind e anëtarëve, e po ashtu duhet të përfaqësohen edhe të gjitha bashkësitë etnike që përbëjnë të paktën 20 për qind të popullsisë në komunën përkatëse.

<sup>21</sup> Për shkak të problemeve teknike me transmetimin e drejtpërdrejtë në KSHZ pas rrethit të parë, incizimet e dy nga gjashtë mbledhjet e KSHZ-së ishin në dispozicion vetëm në ueb-faqen e Agjencisë shtetërore të lajmeve (MIA).

nuk u shpallën publikisht. Megjithëse për shumicën e mbledhjeve u publikuan informacione të shkurtra në ueb-faqen e KSHZ-së, jo të gjitha vendimet dhe udhëzimet u publikuan në internet në mënyrë konsekuente dhe në kohë, duke përfshirë buxhetin e KSHZ-së dhe planin e furnizimeve, informacionin zyrtar për buxhetin e ndarë për fushatën në media, dhe informacionin adekuat për vendimet e marra duke filluar nga fundi i shtatorit e deri në fund të periudhës zgjedhore, duke e zvogëluar kështu transparencën e punës së KSHZ-së dhe llogaridhënien e saj për menaxhimin e procesit zgjedhor.

Shfaqja publike e vendimeve të KZK-ve nuk ishte konsekuente, me ç'rast disa komisione i përdorën mjetet e komunikimit të komunës, ndërsa të tjerat vetëm ia dorëzonin vendimet KSHZ-së, e cila, megjithatë, nuk i publikoi ato. Gjithashtu, mungesa e transparencës së procesit të furnizimit të sistemit të integruar të identifikimit biometrik të votuesve është në kundërshtim me parimet e Ligjit për Furnizimet Publike dhe nuk mundësoi vlerësimin e integritetit të procesit.<sup>22</sup> Disa bashkëbisedues, duke përfshirë edhe brenda KSHZ-së, shprehën shqetësime lidhur me këtë.

*Për të rritur transparencën dhe besimin e publikut në punën e tyre dhe në procesin zgjedhor, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve dhe Komisionet Zgjedhore Komunale duhet ta publikojnë të gjithë dokumentacionin përkatës, duke përfshirë buxhetet, planet e furnizimit dhe të gjitha rregulloret dhe vendimet, në mënyrë konsekuente dhe në kohë.*

Ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor, si dhe dorëzimi i vonshëm i pajisjeve të reja për identifikimin biometrik të votuesve (PIBV) i vonuan përgatitjet teknike dhe administrative të rrethit të parë të zgjedhjeve dhe kërkonin përshtatje në momentin e fundit të udhëzimeve, programeve të trajnimit dhe edukimit, të KSHZ-së, si dhe të materialeve dhe procedurave të ditës së zgjedhjeve. Ndryshimet e miratuara gjatë periudhës zgjedhore paraqitën sfida serioze për përgatitjet zgjedhore dhe, herë pas herë, rezultuan me udhëzime jokonsekuente dhe të vonuara që u jepeshin organeve zgjedhore të niveleve më të ulëta.

Disa procedura dhe materiale zgjedhore u modifikuan më tej pas rrethit të parë, për shkak të mangësive procedurale mjaft të përhapura dhe incidencës së lartë të protokolleve të rezultateve që kërkonin korigjim në rrethin e parë, gjë që ishte tregues i mosnjohjes së mjaftueshme të procedurave nga ana e zyrtarëve të zgjedhjeve.<sup>23</sup> Duke iu referuar vendimit të Gjykatës Administrative për anulimin e votimit në rrethin e parë në një vendvotim në Shuto Orizare, KSHZ-ja më 26 tetor vendosi të ndryshojë udhëzimin e saj në lidhje me vlefshmërinë e fletëvotimeve me qëllim që fletëvotimet pa vulë zyrtare të mos konsiderohen të pavlefshme në rrethin e dytë, duke hequr kështu një mjet mbrojtës të rëndësishëm procedural për ta garantuar integritetin e fletëvotimit. Vendimi u anulua të nesërmen, edhe pse KSHZ-ja theksoi se kërkesa për vulosjen e fletëvotimeve nuk ishte kundërshtuar asnjëherë.

Në shumicën e KZK-ve të vëzhguara nga MVZ-ja e ODIHR-it dhe në KZQK, përgatitjet teknike dhe administrative për të dy rrethet zgjedhore u menaxhuan në mënyrë adekuate. Disa KZK e informuan MVZ-në e ODIHR-it për burimet joadekuate materiale dhe financiare para rrethit të parë zgjedhor, për shkak të mosshpërndarjes së mjeteve financiare nga buxheti ose për shkak të transferimit të vonshëm të mjeteve financiare nga komunat. Burimet financiare për dymbëdhjetë KZK-të në komunat me llogari

<sup>22</sup> KSHZ-ja nuk e publikoi listën dhe detajet e ofertave të pranuar për dy tenderët, katër ndryshimet e bëra në tenderin e dytë, vendimin për përzgjedhjen e operatorit dhe informacionin për dy kompanitë e nënkontraktuara në kuadër të kontratës. Vendimet dhe plani i përgjithshëm i furnizimit është dashur të publikohen nga KSHZ-ja në përputhje me parimet e transparencës të nenit 6 të Ligjit për Furnizimet Publike.

<sup>23</sup> Për balotazhin, KSHZ-ja i modifikoi shabllonet e protokolleve të rezultateve, duke e hequr një formulë të gabuar për kontrollim dhe duke shtuar shpjegime për disa pika. Megjithatë, ky rregullim nuk i trajtoi plotësisht çështjet me të cilat u përballën KZK-të në ditën e zgjedhjeve të rrethit të parë. Kjo, kryesisht, ishte rezultat i asaj se aplikacioni i KSHZ-së për transmetimin elektronik të rezultateve nuk ishte përshtatur për t'u lejuar KZK-ve ta përditësojnë numrin e përgjithshëm të votuesve të regjistruar nëse kishte persona që ishin shtuar në Listën Zgjedhore në ditën e zgjedhjeve në bazë të ankesës së pranuar. Për më tepër, procedurat e aplikueshme për identifikimin e votuesve dhe për paketimin e materialeve zgjedhore u përditësuan përpara ditës së zgjedhjeve të rrethit të dytë.

të ngrira komunale u siguruan nga KSHZ-ja vetëm pak para ditës së parë të zgjedhjeve.<sup>24</sup> Duke pasur parasysh rolin e spikatur të KZK-ve dhe KZQK-së në zgjedhjet lokale, KSHZ-ja caktoi disa punonjës të shërbimit të saj profesional për të koordinuar punën e tyre dhe për shkëmbimin e informacionit. Megjithatë, disa KZK ishin të mendimit se komunikimi nga ana e KSHZ-së herë pas here nuk ishte i kënaqshëm, siç ishte rasti me udhëzimet që shpesh dërgoheshin me vonesë gjatë procesit dhe se jo gjithmonë u ofronin udhëzime të mjaftueshme. KZK-të që i administrojnë komunat më të mëdha me numër të konsiderueshëm të votuesve dhe të vendvotimeve theksuan ngarkesën joproportionale të punës që u ishte ngarkuar, duke pasur parasysh se ato kishin të njëjtat burime njerëzore si edhe KZK-të në komunat e vogla me më pak votues dhe më pak vendvotime.

*Autoritetet duhet të sigurojnë alokimin dhe shpërndarjen adekuate dhe me kohë të mbështetjes financiare dhe operative për Komisionet Zgjedhore Komunale shumë përpara ditës së zgjedhjeve. Komunikimi dhe udhëzimet nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve për organet zgjedhore të niveleve më të ulëta duhet të jenë të plota dhe në kohë, në mënyrë që të sigurohet koordinimi i duhur dhe zbatimi i unifikuar i procedurave.*

KSHZ-ja zhvilloi dhe lansoi shumë përpara ditës së zgjedhjeve një program trajnimi gjithëpërfshirës për organet zgjedhore të nivelit më të ulët dhe trajnerët e certifikuar nga KSHZ-ja. Megjithatë, ndryshimet në programet mësimore të trajnimeve që ishin të nevojshme me qëllim që të përfshihen procedurat e rishikuara dhe ato të reja, si dhe që të reflektohen përshtatjet e vazhdueshme të softuerit për PIBV, ndikuan negativisht në gjithëpërfshirjen dhe qartësinë e trajnimeve initiale.<sup>25</sup> Doracakët e trajnimit ishin në dispozicion vetëm pak para ditës së zgjedhjeve të rrethit të parë. Në prag të ditës së rrethit të dytë të zgjedhjeve, u organizuan trajnime për rifreskim të njohurive për KKZ-të dhe për kryetarët e KZ-ve dhe për zëvendësit e tyre, për t'i trajtuar mangësitë procedurale të vërejtura në rrethin e parë. Trajnimet u fokusuan në procedurat e votimit, udhëzimet operative për PIBV-të dhe plotësimin e protokolleve të rezultateve. Sesionet e trajnimit që u vëzhguan nga MVZ-ja e ODIHR-it para të dy rrethëve zgjedhore ishin ndërvepruese, informuese dhe të organizuara mirë, duke u dhënë zyrtarëve të zgjedhjeve mundësinë për të parashtruar pyetje dhe për t'i sqaruar dyshimet në lidhje me procedurat zgjedhore.<sup>26</sup>

Edukimi i votuesve i kryer nga KSHZ-ja për të dy rrethet zgjedhore ishte modest dhe filloi vonë, rreth dy javë para ditës së zgjedhjeve. Ai u mbështet kryesisht në platformat e rrjeteve sociale të KSHZ-së dhe, me afrimin e ditës së zgjedhjeve, në spotet e shkurtra në mediat transmetuese dhe ato online. Megjithatë, shtrirja e fushatës informuese mbeti e kufizuar dhe nuk kishte informacion të mjaftueshëm për disa aspekte kritike, si për shembull për procedurat e identifikimit dhe regjistrimit të votuesve të ri, dhe përpunimin e të dhënave personale të votuesve.<sup>27</sup>

Bashkëbiseduesit e MVZ-së së ODIHR-it nga organizatat që i përfaqësojnë interesat e personave me aftësi të kufizuara vunë në dukje çështjen shumëvjeçare të mungesës së qasjes në procesin zgjedhor për personat me lloje të ndryshme të aftësisë së kufizuar, përkundër disa iniciativave të ndërmarra nga

<sup>24</sup> Sipas informatave të ofruara nga KSHZ-ja, ato ishin KZK-të në Çeshinovë-Obleshevë, Dellçevë, Demir Kapi, Karposh, Krivogashani, Ohër, Pehçevë, Resnjë, Strugë, Tetovë, Vasilevë dhe Zërnovc.

<sup>25</sup> Trajnime shtesë mbi mënyrën e funksionimit të PIBV-ve u mbajtën prej 12 deri më 15 tetor. Metodologjia e këtyre trajnimeve në përgjithësi u vlerësua negativisht nga vëzhguesit e MVZ-së së ODIHR-it, me ç'rast shumë anëtarë të KZ-ve dukej se kishin mungesë besimi për mënyrën e përdorimit të pajisjeve. Trajnimet e rrethit të dytë u mundësuan trajnuesve të KSHZ-së që në mënyrë efektive t'i përparojnë përvojat me procedurat e reja të identifikimit të votuesve, gjë që e përmirësoi qartësinë e trajnimeve të ofruara.

<sup>26</sup> Disa KZK dhe KZQSh-ja u thanë vëzhguesve të MVZ-së së ODIHR-it se do të kishin përfutuar sikur të kishte edhe trajnime shtesë, duke pasur parasysh mungesën e përvojës të disa prej anëtarëve të tyre, futjen e procedurave të reja dhe ndërlikueshmërinë e procesit të regjistrimit të kandidatëve.

<sup>27</sup> Materialet për edukimin e votuesve ishin në dispozicion në gjuhën maqedonase dhe shqipe, të shoqëruara me gjuhën e shenjave, e nganjëherë edhe me titra në gjuhë të tjera. Fushata mediatike u plotësua me turne informative me një minibus anëmbanë vendit.

administrata zgjedhore në bashkëpunim me organizatat e tilla, për shkak të barrierave për qasjen fizike në shumicën e objekteve të administratës zgjedhore dhe në vendvotime, si dhe pengesave shoqërore. Përmirësimet e rëndësishme që do të ishin në dobi të pjesëmarrjes së pavarur të personave me aftësi të kufizuara do të kërkonin përpjekje të koordinuara të hollësishme nga autoritetet e ndryshme shtetërore dhe komunale.

*Në një përpjekje të koordinuar, autoritetet shtetërore dhe lokale si dhe aktorët e tjerë të përfshirë në procesin zgjedhor duhet të ndërmarrin masa të mëtejshme për të siguruar qasje të pavarur të personave me lloje të ndryshme të aftësisë së kufizuar në të gjithë procesin zgjedhor.*

## VI. REGJISTRIMI I VOTUESVE

Kushtetutën u jep të drejtën e votës të gjithë qytetarëve që kanë mbushur 18 vjet në ditën e zgjedhjeve, përveç atyre që u është marrë e drejta e votës me vendim të gjykatës.<sup>28</sup> Për shkak të miratimit të tyre me vonesë, ndryshimet në Kodin Zgjedhor të shtatorit të vitit 2021, me të cilat u hoq kufizimi i përgjithshëm mbi të drejtat e votës në bazë të paaftësisë ligjore për shkak të paaftësisë intelektuale ose psiko-sociale, nuk patën efekt në këto zgjedhje. Dispozitat e reja nuk i trajtojnë rekomandimet e mëparshme të ODIHR-it që të hiqen të gjitha kufizimet mbi të drejtat zgjedhore në bazë të aftësisë së kufizuar dhe mbetet në kundërshtim me detyrimet dhe standardet ndërkombëtare.<sup>29</sup>

*Siç është rekomanduar më parë, korniza ligjore duhet të harmonizohet me qëllimet e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, duke i hequr të gjitha kufizimet e të drejtës zgjedhore në bazë të aftësisë së kufizuar intelektuale ose psiko-sociale.*

Nuk ka një kornizë të konsoliduar ligjore për regjistrimin e votuesve, ndërsa zbrazëtitrat në Kodin Zgjedhor janë trajtuar përmes dy rregulloreve dhe disa udhëzimeve të KSHZ-së. Për t'u përfshirë në regjistrin e votuesve, qytetarët duhet të kenë adresë të regjistruar në vend dhe letërnjoftim ose pasaportë të vlefshme. Megjithëse ligji lejon që qytetarët të cilëve u ka skaduar afati i letërnjoftimit pas shpalljes së zgjedhjeve, të përfshihen në regjistrin e votuesve, përfshirja në Listat zgjedhore varet nga parashtrimi i kërkesës për letërnjoftim të ri gjatë periudhës së këqyrjes publike.<sup>30</sup> Qytetarët të cilëve u ka skaduar afati i letërnjoftimit para shpalljes së zgjedhjeve mbeten të përjashtuar.<sup>31</sup> KSHZ-ja zhvilloi një procedurë sipas së cilës votuesit me të drejtë vote mund të shtoheshin manualisht në Listat zgjedhore në ditën e zgjedhjeve në bazë të një ankese të pranuar, por nuk publikoi informacione për shtrirjen dhe vendndodhjen e ndryshimeve në Listat zgjedhore, në kundërshtim me praktikën e mirë ndërkombëtare.<sup>32</sup> Duke qenë se ligji e ndalon përditësimin e Listave zgjedhore ndërmjet dy rretheve zgjedhore, kjo procedurë e re u mundësoi atyre që kanë mbushur 18 vjet gjatë kësaj periudhe dhe që

<sup>28</sup> Sipas KSHZ-së, rreth 450 persona janë të privuar nga e drejta e votës mbi këtë bazë.

<sup>29</sup> Shih nenet 12 dhe 29 të [KDKPAK-së të vitit 2006](#). Shih gjithashtu paragrafin 9.4 të [Komunikatës. 4/2011 të Komisionit të KDKPAK të vitit 2013](#), ku thuhet se “Neni 29 nuk parasheh asnjë kufizim të arsyeshëm, e as që lejon ndonjë përjashtim për cilin do grup personash me aftësi të kufizuara. Prandaj, përjashtimi i të drejtës për të votuar në bazë të paaftësisë së perceptuar ose aktuale psiko-sociale ose intelektuale, duke përfshirë kufizimin në bazë të një vlerësimi të individualizuar, përbën diskriminim në bazë të aftësisë së kufizuar, në kuptim të nenit 2 të Konventës”.

<sup>30</sup> Sipas Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), vetëm 5 nga 3,456 shtetas të moshës madhore, të cilëve u kishte skaduar afati i letërnjoftimit pas shpalljes së zgjedhjeve, kishin kërkuar me kohë letërnjoftim të ri për t'u përfshirë në Listat zgjedhore.

<sup>31</sup> Sipas MPB-së, 103,868 shtetasve të moshës madhore u kishte skaduar afati i letërnjoftimit para shpalljes së zgjedhjeve dhe për pasojë këta shtetas ishin përjashtuar nga regjistri i votuesve.

<sup>32</sup> Në ditën e zgjedhjeve ndërkohë që votimi është duke vazhduar, votuesit me të drejtë vote mund të dorëzojnë në KZ një vendim nga KZK-ja përkatëse ose nga Gjykata Administrative për përfshirje në Listën zgjedhore. Ky vendim mund të merret në bazë të një letërnjoftimi të vlefshëm. Seksioni I.1.2.iii i [Kodit të Praktikës së Mirë](#) thotë se “regjistrat zgjedhorë duhet të publikohen”.

kanë letërnjoftim të vlefshëm të regjistruhen në mënyrë aktive. Mospërfshirja në regjistrin e votuesve dhe në Listat zgjedhore për shkak të mungesës së letërnjoftimit të vlefshëm krijon një barrë të panevojshme për administratën zgjedhore dhe për qytetarët që përndryshe kanë të drejtë të votojnë.

*Korniza rregullatore për procedurat e regjistrimit të votuesve duhet të konsolidohet dhe harmonizohet për t'i eliminuar mospërputhjet.*

*Autoritetet duhet t'i marrin masat e duhura të nevojshme për të siguruar që të gjithë votuesit me të drejtë vote të përfshihen në regjistrin e votuesve dhe në Listat zgjedhore. Kodi Zgjedhor duhet të ndryshohet në mënyrë përkatëse, duke përfshirë heqjen e kufizimeve të bazuara në dokumentet e identifikimit me afat të skaduar dhe duke i sqaruar procedurat për përfshirjen në Listat zgjedhore të personave që mbushin 18 vjet ndërmjet rretheve zgjedhore.*

Megjithëse sipas ligjit KSHZ-ja është përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe përditësimin e regjistrit të votuesve duke u bazuar në të dhënat e nxjerra nga Regjistri Kombëtar i Popullsisë, në praktikë, Enti Shtetëror Statistikor (ESHS) siguron përpunimin teknik dhe metodologjik të të dhënave të regjistrit të votuesve në bazë të përditësimeve të siguruara nga institucionet shtetërore.<sup>33</sup> Sipas Planit të Veprimit për TI të KSHZ-së, finalizimi i Sistemit Informatik të Menaxhimit të Votuesve (SIMV), i cili është i nevojshëm për marrjen e përgjegjësive nga ESHS-ja, pritej të bëhej në vitin 2021, kurse integrimi me Regjistrin Kombëtar të Popullsisë deri në vitin 2022.<sup>34</sup>

Qytetarët kishin mundësi t'i kontrollojnë të dhënat e tyre në internet dhe në zyrat rajonale të KSHZ-së gjatë gjithë vitit, si dhe gjatë periudhës së këqyrjes publike, nga 21 gushti deri më 9 shtator.<sup>35</sup> Nuk u morën masa për të lehtësuar qasjen e personave me aftësi të kufizuara në të dhënat e tyre të regjistrimit të votuesve, qoftë online apo personalisht. Mundësia për t'i kontrolluar të dhënat e votuesve duke kërkuar përmes emrit ose adresës së vendbanimit të tyre, si dhe mungesa e masave mbrojtëse teknike për të parandaluar keqpërdorimin e të dhënave që gjenden në kopjen elektronike të regjistrit të votuesve dhe në Listat Zgjedhore përfundimtare që iu dhanë partive që garojnë në zgjedhje, janë në kundërshtim me legjislacionin kombëtar dhe standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të dhënave.<sup>36</sup> Më 24 shtator, KSHZ-ja e mbylli regjistrin e votuesve, me gjithsej 1,824,864 votues, duke përfshirë 82,461 votues të regjistruar se banojnë përkohësisht jashtë vendit, të cilët mund të votojnë në vend, por paraqiten në Lista

<sup>33</sup> Duke përfshirë MPB-në, Drejtorinë për Udhëheqjen e Librave Amë dhe gjykatat themelore, të cilat ofrojnë përditësime në baza tremujore. Megjithëse Kodi Zgjedhor përcakton që të dhënat e votuesve të nxirren nga Regjistri Kombëtar i Popullsisë, institucione të ndryshme që ofrojnë përditësime ditore të Regjistrit Kombëtar të Popullsisë duhet gjithashtu t'i dorëzojnë të dhënat drejtpërdrejt në KSHZ.

<sup>34</sup> KSHZ-ja planifikon t'i krahasojë bazat e të dhënave të MPB-së dhe të Regjistrit Kombëtar të Popullsisë për të vlerësuar ndikimin e tyre përkatës në shpërndarjen e votuesve nëpër vendvotime nga SIMV-ja, por ky afat kohor nuk është i specifikuar në Planin e Veprimit për TI të KSHZ-së. Aktualisht, KSHZ-ja dhe MPB-ja nuk janë përdorues të regjistruar të të dhënave në Regjistrin Kombëtar të Popullsisë. KSHZ-ja mbajti një takim në mars të vitit 2022 me Ministrinë e Drejtësisë lidhur me bashkëpunimin e mëtuajtshëm në sigurimin e ndërveprimit të të dhënave me organet gjyqësore dhe institucionet shtetërore.

<sup>35</sup> Qytetarët mund të kërkojnë korrigjime në Zyrat rajonale të KSHZ-së, si dhe online gjatë periudhës së këqyrjes publike.

<sup>36</sup> Të dhënat e ofruara përfshijnë emrin, mbiemrin, datëlindjen, adresën dhe vendvotimin e votuesit. Neni 9.1 i [Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të vitit 2020](#) thotë se të dhënat personale do të "përpunohen në mënyrë që siguron nivel përkatës të sigurisë së të dhënave personale, duke përfshirë mbrojtjen nga përpunimi i paautorizuar ose i paligjshëm, si dhe nga humbja, shkatërrimi ose dëmtimi i rastësishëm, duke i përdorur masat përkatëse teknike ose organizative ("integriteti dhe konfidencialiteti")." Shih po ashtu paragrafin 10 të [Komentit të Përgjithshëm Nr. 16 të KDDPAK-së të vitit 1988](#), i cili thotë se "[S]htetet duhet të marrin masa efektive për të siguruar që informacioni në lidhje me jetën private të një personi të mos arrijë në duart e personave që nuk janë të autorizuar me ligj ta marrin' ta përpunojnë dhe ta përdorin atë[...]."

Zgjedhore të veçanta.<sup>37</sup> KSHZ-ja i publikoi të dhënat e regjistrimit të votuesve vetëm pas mbylljes së regjistrit të votuesve, të ndara sipas komunave, por jo edhe sipas vendvotimit ose gjinisë.

*Për të siguruar qasje kuptimplotë dhe transparencë të regjistrit të votuesve dhe të Listave Zgjedhore, KSHZ-ja duhet t'i publikojë të dhënat e regjistrimit të votuesve të ndara sipas vendvotimeve, në mënyrë periodike dhe para dhe pas çdo zgjedhjeje, duke e kufizuar llojin e të dhënave personale të votuesve që janë në dispozicion publik dhe të prezantojë masa mbrojtëse teknike për të parandaluar përpunimin e tyre të paautorizuar.*

Shumica e bashkëbiseduesve të MVZ-së së ODIHR-it shprehën besim në saktësinë dhe besueshmërinë e regjistrit të votuesve, megjithëse disa pranuan se një numër i konsiderueshëm i qytetarëve që banojnë jashtë vendit mbeten në regjister pasi mbajnë një vendbanim zyrtar në vend. Edhe pse kontrollat e fundit të rastësishme të KSHZ-së për saktësinë e regjistrit të votuesve u kryen në vitin 2016, asnjë nga bashkëbiseduesit e MVZ-së së ODIHR-it nuk sugjeroi se revizioni ishte i nevojshëm. Përfaqësuesit institucionalë me të cilët u takua MVZ-ja e ODIHR-it vunë në dukje mungesën e raportimit sistematik për vdekjet nga spitalet dhe për ndryshimet e emrave nga gjykatat, si dhe mungesën e një regjistri qendror të adresave dhe mungesën e bashkëpunimit të komunave në adresimin e mospërputhjeve të adresave të qytetarëve. Mospërputhjet shumëvjeçare dhe transferimi i të dhënave në letër ndërmjet bazave të ndryshme të të dhënave mbeten për t'u adresuar.<sup>38</sup> ODIHR-i ka rekomanduar më parë që baza e të dhënave të ndërveprimit të Regjistrit Kombëtar të Popullsisë mund të kontribuojë në përditësimin dhe harmonizimin e të dhënave të dorëzuara në regjistrin e votuesve, siç parashikohet nga Kodi Zgjedhor.

*Saktësia e regjistrit të votuesve duhet të përforcohet nëpërmjet përditësimeve sistematike dhe elektronike të të dhënave, duke përfshirë edhe të dhënat për vdekjet dhe ndryshimet e emrave, dhe duke zbatuar një sistem të koordinuar mbarëkombëtar për standardizimin e adresave.*

Identifikimi biometrik i votuesve, u fut në Kodin Zgjedhor në shkurt të vitit 2020, në bazë të një marrëveshje politike që synon mbrojtjen dhe modernizimin e procesit të identifikimit të votuesve. Ai u zbatua për herë të parë në këto zgjedhje, në të gjitha vendvotimet e rregullta. Ndryshimet shtesë në prill të vitit 2021 i sqaruan procedurat e identifikimit, të cilat, së bashku me emërimin e KSHZ-së së re dhe proceset e vonuara të furnizimit dhe zhvillimit të softuerit, rezultuan me një afat kohor të ngjeshur për zbatim dhe e penguan aftësinë e KSHZ-së për t'i miratuar në kohë aktet përkatëse nënligjore, procedurat, trajnimet dhe edukimin e votuesve.<sup>39</sup> Pavarësisht mungesës së një projekti pilot, i cili mund t'i kishte lejuar KSHZ-së të vlerësonte cilësinë e bazës së të dhënave kombëtare të gjurmëve të gishtave dhe t'i trajtonte problemet e mundshme që lidhen me harduerin ose softuerin, nuk u krye asnjë testim gjithëpërfshirës ose vlerësim i cilësisë së sistemit të integruar të identifikimit të votuesve para se të dërgoheshin pajisjet në të gjitha vendvotimet.<sup>40</sup> Gjithashtu, mungesa e specifikimeve teknike për infrastrukturën, veçanërisht për serverët, si në tender ashtu edhe në kontratë, e zvogëloi transparencën e zhvillimit dhe zbatimit të sistemit, duke përfshirë edhe mbrojtjen e të dhënave personale të votuesve.

PIBV-të, u përdorën nga kryetari ose zëvendës-kryetari i KZ-së për të verifikuar identitetin e votuesve duke i përputhur gjurmët e gishtërinjve të skenuar me ato që gjenden në Listat Zgjedhore elektronike,

<sup>37</sup> Numri i përgjithshëm përfshinte 2,250 votues në institucionet ndëshkuese-përmirësuese dhe në institucionet e kujdesit, të regjistruar për të votuar një ditë më herët, më 16 tetor.

<sup>38</sup> Format i shumicës së bazave të të dhënave nuk është kompatibil dhe disa transferime kyçe të të dhënave, veçanërisht nga Drejtoria për Udhëheqjen e Librave Amë në MPB, ende bëhet përmes transmetimit ditor të bazuar në dokumente në letër.

<sup>39</sup> Gjithsej 4,000 PIBV të lëvizshme u furnizuan në gusht të vitit 2021 nga kompania gjermane DERMALOG dhe u dorëzuan midis 3 shtatorit dhe 9 tetorit.

<sup>40</sup> Në kundërshtim me nenin 3 të kontratës midis KSHZ-së dhe DERMALOG, i cili thotë se testimi duhet të kryhet deri më 11 tetor, vetëm gjashtë ditë para rrethit të parë.



që ishin ngarkuar në pajisje.<sup>41</sup> Shumica e bashkëbiseduesve të MVZ-së së ODIHR-it, duke përfshirë partitë politike, e mirëpritën futjen në përdorim të identifikimit biometrik të votuesve, si një mjet efektiv për të parandaluar mashtrimin, duke përfshirë votimin e shumëfishtë dhe prezantimin e rrejshëm në emër të ndonjë votuesi tjetër. Disa KZK shprehën keqardhje që nuk ishin zbatuar masa për të verifikuar se votuesit, gjurmë e gishtave të të cilëve nuk mund të përputheshin në sistem, nuk kishin votuar më shumë se një herë.<sup>42</sup>

Në rast të problemeve teknike me PIBV-të në ditët e zgjedhjeve, KZK-të e koordinuan mbështetjen për TI për KZ-të, duke përfshirë edhe zëvendësimin e mundshëm të pajisjeve.<sup>43</sup> Si mënyrë zëvendësuese, identiteti i votuesve mund të përcaktohet edhe duke përdorur Listat Zgjedhore të shtypura dhe skanimi i letërnjoftimit të votuesve. Të dhënat e përfshira në PIBV, duke përfshirë të dhënat e gjurmëve të gishtave të votuesve, janë fshirë nga KSHZ-ja brenda 10 ditëve nga shpallja e rezultateve përfundimtare, në përputhje me ligjin. KSHZ-ja nuk publikoi informacion mbi cilësinë e bazës së të dhënave të gjurmëve të gishtërinjve sipas komunave, ose për numrin e votuesve që u identifikuan me sukses me anë të PIBV-ve, por i shprehu MVZ-së së ODIHR-it synimin e saj për të identifikuar masat për të përmirësuar procesin e identifikimit biometrik të votuesve në zgjedhjet e ardhshme.

*Për të garantuar integritetin dhe besimin e publikut në procesin zgjedhor, përdorimi i teknologjive të reja, duke përfshirë edhe pajisjet e identifikimit biometrik, duhet të futet pas një kohe të mjaftueshme dhe me dispozita të detajuara për të siguruar testimin e duhur dhe që të gjithë palët e interesuara të njihen me mënyrën e funksionimit të pajisjeve të tilla.*

## VII. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE

Qytetarët që janë të paktën 18 vjeç në ditën e zgjedhjeve dhe kanë të drejtë vote, kanë të drejtë të kandidojnë për postin e kryetarit të komunës ose për këshilltar në komunën e vendbanimit të tyre të regjistruar. Korniza ligjore i ndalon të kandidojnë në zgjedhje ata që aktualisht vuajnë ose presin të vuajnë dënim të plotfuqishëm prej më shumë se gjashtë muaj burgim. Në kundërshtim me obligimet ndërkombëtare, personave të cilëve u është hequr e drejta e votës për shkak të aftësisë së kufizuar intelektuale ose psiko-sociale u mohohet e drejta për të kandiduar.

Kandidatët për kryetar komune dhe këshilltarë mund të emërohen nga partitë e regjistruara politike ose nga koalicionet, ose mund të garojnë në mënyrë të pavarur, të mbështetur nga grupe votuesish. Megjithatë kandidatët për kryetarë komune mund të kandidojnë individualisht, Kodi Zgjedhor kërkon që numri i kandidatëve në listat e parashtruara të këshilltarëve të jetë i barabartë me numrin e përgjithshëm të mandateve në Këshillin e komunës përkatëse, gjë që i pamundëson kandidatët për këshilltarë të konkurrojnë individualisht, që është në kundërshtim me përkushtimet e OSBE-së.<sup>44</sup>

*Korniza ligjore duhet të ndryshohet për të ofruar mundësi që kandidatët e pavarur të konkurrojnë individualisht në zgjedhjet për këshilltarë.*

<sup>41</sup> Nëse gjurma e gishtit të një votuesi nuk mund të gjendej në listën elektronike të gjurmëve të gishtërinjve të votuesve, identiteti i votuesit mund të kontrollohej duke e skenuar letërnjoftimin e votuesit ose duke e futur numrin unik amë të qytetarit. PIBV-të nuk ishin të lidhura në rrjet ose të lidhura në internet.

<sup>42</sup> Verifikimi i ngjyrës së padukshme dhe me llambën UV nuk u zbatua vazhdimisht për votuesit, gjurmët e gishtave të të cilëve nuk mund të identifikoheshin me sukses me pajisjet, dhe një krahasim mbarëkombëtar i gjurmëve të gishtave të mbledhura nga PIBV-të, i cili lejohet me ligj, nuk u kërkua nga anëtarët e KSHZ-së pas zgjedhjeve.

<sup>43</sup> Një qendër thirrjesh për të koordinuar mbështetjen e TI-së u menaxhua nga Alphazet, ndërsa mbështetja e TI-së u sigurua në bashkëpunim me kompaninë Simboliko; të dyja kompanitë janë nënkontraktorë të DERMALOG.

<sup>44</sup> Paragrafi 7.5 i [Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së i vitit 1990](#) i obligon Shtetet pjesëmarrëse të "respektojnë të drejtën e qytetarëve për të kërkuar poste shtetërore dhe politike, individualisht ose si përfaqësues të partive politike apo organizatave, pa diskriminim".

Për të mbështetur kandidaturat për kandidatë të pavarur për kryetarë të komunave dhe listat e këshilltarëve të pavarura, grupet e votuesve duhet të mbledhin nga 100 deri në 1,000 nënshkrime mbështetëse të votuesve me të drejtë vote që banojnë në komunën përkatëse, varësisht nga numri i përgjithshëm i popullsisë së komunës.<sup>45</sup> Numri më i vogël i nënshkrimeve të nevojshme ishte përcaktuar për komunat me deri në 10.000 banorë. Megjithatë, në shumicën e komunave që i përkasin kësaj kategorie, numri aktual i votuesve të regjistruar sillet ndërmjet 2.000 dhe 7.000. Prandaj, në praktikë, numri i kërkuar i nënshkrimeve mbështetëse ndryshonte midis 0.4 dhe 5 për qind të votuesve të regjistruar në komunën përkatëse, në kundërshtim me praktikat e mira ndërkombëtare dhe parimin e mundësive të barabarta për t'u kandiduar në zgjedhje.<sup>46</sup> Nënshkrimet mbështetëse mund të mblidhen në zyrat e noterëve të caktuar, si dhe në Zyrat rajonale të KSHZ-së, në prani të zyrtarëve të KSHZ-së.

*Për të siguruar mundësi të barabarta në të drejtën për t'u kandiduar për të gjithë kandidatët, numri i kërkuar i nënshkrimeve mbështetëse për kandidatët e pavarur duhet të jetë proporcional me numrin aktual të votuesve të regjistruar për njësi zgjedhore. Duhet t'i kushtohet vëmendje standardizimit të numrit të kërkuar të nënshkrimeve deri në një për qind të votuesve të regjistruar, në përputhje me praktikën e mirë ndërkombëtare.*

Procesi i regjistrimit të kandidatëve, në përgjithësi, ishte gjithëpërfshirës. Vëzhguesit e MVZ-së së ODIHR-it vunë re një konfuzion dhe respektim jokonsekuent të procedurave të regjistrimit në disa KZK, në lidhje me korrigjimet e mangësive në dokumentet e dorëzuara për emërim dhe futjen e të dhënave në aplikacionin online të KSHZ-së për përpunimin dhe publikimin e listave të kandidatëve. Kjo nganjëherë rezultoi me informacione kontradiktore ose jo të plota për regjistrimin e kandidatëve që ishin në dispozicion të publikut.<sup>47</sup>

Deri në fund të afatit më 18 shtator, KZK-të dhe KZQSh-ja regjistruan gjithsej 10,649 kandidatë në 571 lista të kandidatëve për këshillat komunalë, të parashtruara nga 28 parti politike, 6 koalicione dhe 58 grupe votuesish. Gratë përbënin rreth 45 për qind të të gjithë kandidatëve për këshilltarë dhe ishin bartëse në 111 lista të kandidatëve (19 për qind). Të gjitha listat e regjistruara të kandidatëve i plotësuan kërkesat për përfaqësim gjinor.<sup>48</sup> Në garat për kryetarë komune garuan gjithsej 299 kandidatë të emëruar nga 22 parti politike, 5 koalicione dhe 25 grupe votuesish; vetëm 25 (8 për qind) kandidate për kryetar komune ishin gra. MVZ-ja e ODIHR-it është në dijeni të refuzimit të 3 kandidatëve për kryetarë të komunave dhe 9 listave të kandidatëve për këshilltarë komunalë nga KZK-të për shkak të dorëzimit të vonuar ose mangësive në dokumentet për emërim; për të gjitha 12 refuzimet u parashtruan ankesa, por të gjitha u hodhën poshtë nga Gjykata Administrative.

<sup>45</sup> Për këto zgjedhje, nënshkrimet mbështetëse u mblodhën midis 16 dhe 30 gushtit. Nga 69 grupe votuesish që kishin shpallur synimin e tyre të propozonin lista të kandidatëve për këshillat komunalë, 67 e mblodhën numrin e kërkuar të nënshkrimeve. Për emërimin e kandidatëve për kryetarë të komunave, 30 nga 38 kandidatë të pavarur të mundshëm mblodhën numrin e nënshkrimeve të nevojshme për regjistrim.

<sup>46</sup> Seksioni I.1.3.ii i [Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore](#) i Komisionit të Venedikut thotë se "ligji nuk duhet të kërkojë mbledhjen e nënshkrimeve të më shumë se 1% të votuesve në njësinë përkatëse zgjedhore". Në gjithsej 42 komuna, numri i kërkuar i nënshkrimeve tejkaloi 1 për qind. Në 6 nga këto komuna, ky numër tejkaloi 2 për qind, ndërsa në 9 komuna ishte mbi 3 për qind. Në komunën e Vevçanit dhe të Llozovës arriti në 4,8 për qind dhe 5 për qind, respektivisht. Shih gjithashtu seksionin I.2.3.ii të [Kodit të Praktikës së Mirë](#).

<sup>47</sup> Përveç kësaj, disa KZK e informuan MVZ-në e ODIHR-it se ata nuk ishin gjithmonë në gjendje t'i respektonin të gjitha afatet, për shkak të dorëzimit të vonshëm të të dhënave në lidhje me dosjet penale të kandidatëve nga gjykatat.

<sup>48</sup> Çdo gjini duhet të përbëjë të paktën 40 për qind të kandidatëve në listat për këshillat komunalë, me kërkesë që kandidati i gjinisë më pak të përfaqësuar të përfshihet në secilin grup prej tre vendeve të njëpasnjëshme, me një vend shtesë brenda çdo grupi prej dhjetë kandidatësh të rezervuar për kandidatin e gjinisë më pak të përfaqësuar.

## VIII. FUSHATA

Fushata zyrtare për rrethin e parë filloi më 27 shtator dhe përfundoi më 15 tetor në mesnatë. Fushata e rrethit të dytë filloi më 18 tetor dhe përfundoi më 29 tetor në mesnatë. Disa garues filluan t'i përfshijnë votuesit në aktivitete para fillimit zyrtar të fushatës. Fushata ishte aktive dhe në përgjithësi paqësore në të gjithë vendin, përkundër incidenteve të izoluara.<sup>49</sup>

Pandemia e KOVID-19 ndikoi në fushatë, me ç'rast garuesit duhej t'i respektonin protokollet e sigurisë të Qeverisë për tubimet publike.<sup>50</sup> Megjithatë, të drejtat dhe liritë themelore, si për shembull ato për tubime dhe lëvizje, u respektuan gjatë gjithë fushatës, dhe garuesit mund ta zhvillonin fushatën lirshëm, duke ua përcjellë mesazhet e tyre votuesve.<sup>51</sup> Megjithatë, u vunë re raste të shumta të retorikës negative, të drejtuara shpesh herë ndaj kandidatëve, ndërsa partitë kryesore u përfshinë në sulme të ndërsjella.<sup>52</sup> Më 27 tetor, kryeministri dhe kryetar i LSDM-së, në një intervistë për media bëri pretendime të pabazuara se Danella Arsovska, kandidatja e pavarur për kryetare të Qytetit të Shkupit e mbështetur nga Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase - Partia Demokratike për Unitetin Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE), kishte shtetësi bullgare dhe i bëri thirrje asaj të tërhiqej. Përdorimi i një retorike të tillë e tërhoqi vëmendjen nga debatet e fokusuar në probleme konkrete, përkundër zotimeve nga garuesit se do t'i përmbahen Kodit për Zgjedhje të Drejta dhe Demokratike, të nënshkruar nën patronazhin e KSHZ-së më 23 shtator.<sup>53</sup>

Metodat tradicionale të fushatës përfshinin tubime dhe bilborde, me fokus të shtuar në takimet e vogla dhe aktivitetet derë-më-derë në rrethin e dytë. Dispozitat në Kodin Zgjedhor që e rregullojnë shpërndarjen e hapësirave publike për posterë dhe bilborde në mënyrë disproporcionale janë në favor të partive të caktuara parlamentare në kurriz të partive më të vogla dhe kandidatëve të pavarur.<sup>54</sup> Megjithatë, ndarja e këtyre hapësirave nuk ishte kontestuese në këto zgjedhje.

*Në përputhje me parimin e barazisë së mundësive, rregullat e fushatës duhet të rishikohen për të siguruar qasje më të barabartë në media dhe ndarje të hapësirave për posterë dhe bilborde për partitë e vogla dhe kandidatët e pavarur.*

Garuesit gjithashtu u mbështetën në reklamat e subvencionuara në mediat e transmetuara dhe mediat online për lajme dhe zhvilluan një aktivitet të gjerë në platformat e rrjeteve sociale (shih seksionin *Mediat*). MVZ-ja e ODIHR-it vuri re se shumë funksionarë aktualë i përdorën llogaritë e tyre

<sup>49</sup> Për shembull, kandidati për kryetar komune i "Era e Tretë Maqedonase" (Makedonska Era Treta) nga Mogilla mori kërcënime përmes mesazheve SMS nga një udhëheqës lokal i VMRO-DPMNE-së, i cili më vonë kërkoi falje, ndërsa policia hetoi një incident me armë zjarri që kishte në shënjestër shtëpinë e kandidatit për kryetar komune të LSDM-së nga e njëjta komunë.

<sup>50</sup> Vëzhguesit e MVZ-së së ODIHR-it raportuan se interpretimi dhe respektimi i udhëzimeve në lidhje me KOVID-in ndryshonte midis partive politike; për shembull, certifikatat e vaksinimit nuk kontrolloheshin gjithmonë nëpër tubime në ambiente të mbyllura dhe pajisjet mbrojtëse personale, si maskat për fytyrën nuk mbaheshin gjithmonë nga pjesëmarrësit.

<sup>51</sup> MVZ-ja e ODIHR-it vëzhgoi gjithsej 61 tubime në 33 komuna.

<sup>52</sup> Në një [deklaratë publike](#) pas mbylljes së vendvotimeve më 17 tetor, z. Zaev la të kuptohej se VMRO-DPMNE-ja përfaqëson "të keqen"; Kryetari i VMRO-DPMNE-së, Hristijan Mickoski, gjatë një takimi të fushatës në Shkup më 20 tetor [deklaroi](#) se "qeveria nuk ka kuptuar asgjë, por vazhdon me shantazhe, kërcënime, keqpërdorim të policisë në zgjedhje (dhe) blerje votash".

<sup>53</sup> Kodi përcakton se fushatat duhet të zhvillohen në mënyrë transparente dhe të drejtë, duke e respektuar lirinë e të gjithë garuesve për të zhvilluar fushatë, pa detyrim, ryshfet apo frikësim.

<sup>54</sup> Sipas Kodit, dy partitë më të mëdha në pushtet dhe dy partitë më të mëdha parlamentare të opozitës "që kanë fituar më shumë vota në zgjedhjet e fundit parlamentare" kanë të drejtën e 40 për qind të hapësirës së disponueshme për bilborde, respektivisht, ndërsa partitë e tjera parlamentare kanë të drejtë të ndajnë 10 për qind, kurse kandidatët e pavarur mund të ndajnë 10 për qind të hapësirës. Seksioni 1.2.3 i [Kodit të Praktikës së Mirë](#) parashikon që mundësitë e barabarta për garuesit në zgjedhje duhet të garantohen dhe "duhet të vlejnjë për përdorimin e objekteve publike për qëllime zgjedhore (për shembull vendosjen e bilbordeve)".

institucionale në rrjetet sociale për fushatë, duke përfitur nga funksioni i tyre publik. Në mungesë të rregulloreve të qarta për zhvillim të fushatës në rrjetet sociale dhe për moderim efektiv të komenteve nga partitë dhe kandidatët në faqet e tyre në rrjetet sociale, shumë kandidatë, shpesh herë gratë, ishin në shënjestër të gjuhës fyese. Reklamimi politik në mjetet online jo-medatike, si për shembull në Google Ads dhe në rrjetet sociale nuk subvencionohen dhe nuk janë të rregulluara në mënyrë të veçantë me legjislacionin kombëtar. Përderisa partitë politike i përdorën gjerësisht rrjetet sociale në fushatat e tyre, mungesa e transparencës së mjeteve të tilla e bën të pamundur revizionin thelbësor.

Gratë ishin më pak të përfaqësuara në fushatat e partive dhe temat që lidhen me barazinë gjinore dhe të drejtat e grave kryesisht mungonin në platformat dhe fjalimet e garuesve, pavarësisht nga përpjekjet e kufizuara nga disa parti për t'i prezantuar këto politika para votuesve.<sup>55</sup> Sipas bashkëbiseduesve të MVZ-së së ODIHR-it, gratë përballen me sfida të shumta kur përpiqen të kenë qasje në pozicione vendimmarrëse politike. Shumica e partive politike me të cilat u takua MVZ-ja e ODIHR-it nuk kanë mekanizma efektivë të promovimit të brendshëm dhe nuk i angazhojnë anëtarët e tyre në zhvillimin e tyre.

*Partitë politike duhet të ndërmarrin hapa të mëtejshëm për të inkurajuar pjesëmarrjen e grave në procesin zgjedhor dhe në vendimmarrjen e brendshme politike.*

Kryetarët e partive politike kombëtare dhe funksionarët e qeverisë qendrore kishin prezencë të dalluar në ngjarjet e fushatës, duke i prezantuar kandidatët lokalë dhe duke dhënë mesazhe në lidhje me punësimin, shëndetësinë, infrastrukturën lokale, mjedisin jetësor dhe arsimin. Megjithëse këto aktivitete janë të ligjshme dhe në përgjithësi u zhvilluan kryesisht jashtë orarit të punës, Kodi Zgjedhor nuk e rregullon qartë sjelljen e funksionarëve shtetërorë në fushatë.<sup>56</sup>

*Korniza ligjore për zhvillimin e fushatës duhet të ndryshohet më tej për të përfshirë rregulla të qarta për pjesëmarrjen e zyrtarëve publikë, duke përfshirë edhe në rrjetet sociale.*

Pozitivisht, Kodi Zgjedhor përmban dispozita që e ndalojnë përdorimin e burimeve administrative në fushatë, duke përfshirë moratorium për publikimin e projekteve të reja të financuara me mjete publike nga dita e shpalljes së zgjedhjeve, si dhe ndalesë për përdorimin e zyrave, pajisjeve apo punonjësve shtetërorë për qëllime të fushatës, dhe për presionin ndaj nëpunësve publikë. Pas shpalljes së zgjedhjeve, nuk mund të bëhen pagesa të jashtëzakonshme/të paplanifikuara të rrogave, pensioneve dhe ndihmave sociale nga mjetet buxhetore. Ndryshimet e shtatorit të vitit 2021 përfshinin dispozita për ta rritur transparencën e përdorimit të automjeteve në pronësi shtetërore gjatë fushatës zgjedhore. Megjithatë, në mungesë të monitorimit sistematik nga institucionet përkatëse, efektiviteti i këtyre masave mbeti i paqartë.

Disa bashkëbisedues të MVZ-së të ODIHR-it pretenduan se ka pasur presion ndaj votuesve, duke përfshirë ndaj punonjësve të policisë dhe punonjësve të tjerë publikë, për të votuar për garues të caktuar. Për më tepër, MVZ-ja e ODIHR-it pranoi pretendime se nëpunësve publikë u është bërë presion të siguronin lista të votuesve që do të votonin për kandidatin e caktuar. MVZ-ja e ODIHR-it gjithashtu pranoi pretendime të vazhdueshme për frikësim dhe presion mbi disa kandidatë, duke përfshirë edhe

<sup>55</sup> Rreth 14 për qind e folësve në tubimet e vëzhguara nga MVZ-ja e ODIHR-it ishin gra, dhe gratë, mesatarisht përbënin rreth 30 për qind të publikut në tubimet e vëzhguara.

<sup>56</sup> Sipas [Kodit të Etikës për anëtarët e qeverisë dhe menaxhmentin ekzekutiv të institucioneve](#), drejtuesit e institucioneve publike mund të marrin pjesë në aktivitetet e partive politike jashtë orarit të punës, por nuk duhet të rrezikojnë profesionalizmin e tyre. Më 30 tetor, ditën e heshtjes zgjedhore para ditës së zgjedhjeve të rrethit të dytë, zëdhënësi i BDI-së dhe ministri i Ekonomisë, Kreshnik Bekteshi, postoi në faqen e tij në Facebook një [video](#), ku ai i mirëpret votuesit që vinin nga jashtë dhe prisnin të udhëtonin me autobus për në Kërçovë. Të njëjtën ditë, kandidati për kryetar komune i BDI-së, Fatmir Dehari postoi [video](#), ku ai i mirëpret të njëjtët votues në Kërçovë, në autobusë ku ishin vendosur posterët e fushatës së tij.

nga zyrtarët e policisë.<sup>57</sup> Sindikata e Policisë së Maqedonisë lëshoi një deklaratë më 27 tetor, duke u bërë thirrje partive politike që të përmbahen nga presioni ndaj policëve dhe anëtarëve të njësisve policore që të mos u shërbejnë interesave të partive politike. Veprimet që i pengojnë votuesit të votojnë lirisht pa u frikësuar nga hakmarrja janë në kundërshtim me angazhimet ndërkombëtare të Maqedonisë së Veriut.<sup>58</sup> MVZ-së së ODIHR-it, gjithashtu, iu bënë me dije pretendime të vazhdueshme për blerje votash nga partitë kryesore. Megjithatë, u ndërmorën veprime të kufizuara nga udhëheqësit politikë për të reaguar ndaj akuzave të tilla.<sup>59</sup>

*Duhet të bëhen përpjekje të vazhdueshme energjike nga autoritetet për t'iu kundërvënë çdo forme të presionit mbi votuesit dhe mbi punonjësit e sektorit publik dhe privat, duke përfshirë edhe blerjen e votave. Në përputhje me legjislacionin ekzistues, raportet për presion dhe blerje të votave duhet të hetohen plotësisht dhe të ndiqen penalisht, duke i mbrojtur ata që kanë raportuar.*

*Institucionet publike duhet të jenë proaktive në informimin e nëpunësve publikë dhe shtetërorë për mekanizmat e pavarur ku mund të raportojnë presionet në lidhje me zgjedhjet, dhe zyrtarët e lartë shtetëror duhet të japin deklaratatë të qarta publike dhe udhëzime me shkrim se veprimet e tilla nuk do të tolerohen dhe se asnjë qytetar nuk duhet të frikësohet se mund të ketë ndonjë pasojë negative si rezultat i mbështetjes ose mosmbështetjes së ndonjë kandidati apo partie.*

Disa garues, në rrethin e dytë kërkuan në mënyrë aktive të fitojnë mbështetje nga bashkësitë më të vogla etnike ose jashtë bazës së tyre tradicionale mbështetëse. Për shembull, në një tubim në Shkup më 23 tetor, një kandidat i LSDM-së iu drejtua votuesve me mesazhe në gjuhën maqedonase, shqipe dhe rome gjuhë, ndërsa kandidati për kryetar komune të Tetovës dhe kryetar i Lëvizja etnike-shqiptare BESA, publikoi materiale të fushatës online në gjuhën maqedonase. Partitë politike që i përfaqësojnë bashkësitë më të vogla etnike, duke përfshirë romët, serbët dhe turqit, në përgjithësi u bashkuan me forcat politike kombëtare në koalicionet parazgjedhore. Megjithatë, disa aktorë politikë lokalë e informuan MVZ-në e ODIHR-it se jo gjithmonë kjo nënkupton edhe përfaqësim efektiv të nevojave të komuniteteve të tyre dhe se partitë parlamentare nuk bashkëpunojnë në mënyrë kuptimplotë me këto sektorë të elektoratit. Bashkimi Demokratik Boshnjak (BDB) për herë të parë garoi në mënyrë të pavarur, duke përfshirë edhe për postin e kryetarit të Qytetit të Shkupit.

## IX. FINANCIMI I FUSHATËS

Financimi i fushatës është i rregulluar kryesisht me Kodin Zgjedhor, Ligjin për Financimin e Partive Politike dhe Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktin e Interesave. Më 21 shtator, Ministria e Financave i publikoi rregullat, procedurat dhe shabllonet për raportimin e donacioneve dhe shpenzimeve nga garuesit. Përkundër kornizës ligjore, në përgjithësi gjithëpërfshirëse për financimin e fushatës, mbeten disa zbrazëtira dhe mospërputhje, ndërsa rekomandimet e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) dhe Entit Shtetëror të Revizionit (ESHR), si dhe të KSHZ-së nuk janë futur në legjislacion. Mbikëqyrja e pamjaftueshme dhe publikimi i vonshëm i informatave për të hyrat e fushatës e zvogëloi transparencën dhe e minoi zbulimin e shkeljeve të mundshme.

<sup>57</sup> Kandidati i pavarur për kryetar të komunës së Kumanovës, kryetari aktual Maksim Dimitrievski, pretendoi publikisht se është bërë presion dhe frikësim ndaj fushatës së tij nga Ministri i Punëve të Brendshme, Oliver Spasovski, dhe nga Kryeshefi i Policisë së Kumanovës. Kandidati i pavarur dhe kryetari aktual i Komunës së Debarcës, Zoran Nogaçeski, në një postim në rrjetet sociale, pretendoi se kundërshtari i tij nga LSDM-ja ka bërë presion ndaj votuesve.

<sup>58</sup> Paragrafi 7.7 i [Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së i vitit 1990](#) u bën thirrje Shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së që "të sigurojnë që [...] as veprimi administrativ, dhuna apo kërcënimi, nuk i pengon votuesit [...] që ta japin votën e tyre pa frikë nga hakmarrja".

<sup>59</sup> Dy ditë para ditës së zgjedhjeve të rrethit të parë, ministri i brendshëm u bëri thirrje palëve të interesuara zgjedhore t'u lejojnë votuesve të vendosin vetë se për kë do të votojnë dhe i inkurajoi qytetarët t'i raportojnë parregullsitë zgjedhore.



Fushatat zgjedhore mund të financohen nga fondet vetanake të partive politike dhe kreditë bankare, si dhe nga donacionet. Shuma e kredive bankare mbetet e parregulluar, që është në kundërshtim me një rekomandim të mëparshëm të ODIHR-it. Partitë politike që fituan më shumë se një për qind të votave në zgjedhjet e fundit parlamentare ose lokale marrin financim publik për aktivitetet e tyre të rregullta.<sup>60</sup> Donacionet, qoftë monetare apo në natyrë, janë të kufizuara në 3,000 euro për individët dhe 30,000 euro për personat juridikë (në kundërvlerë prej 183,000 denarë dhe 1,830,000 denarë, respektivisht).<sup>61</sup> Donacionet në natyrë vlerësohen sipas çmimit të tregut. Me ligj nuk është rregulluar nëse kandidatët e pavarur mund t'i financojnë fushatat e tyre vetëm brenda kufizimeve për donacione për personat fizik. Asnjë dispozitë nuk i ndalon donacionet pas ditës së zgjedhjeve dhe disa bashkëbisedues ngritën shqetësime për rreziqet e lidhura me korrupsionin.<sup>62</sup> Kufiri i shpenzimeve të fushatës është 110 denarë (afërsisht 1.8 euro) për votues të regjistruar në një komunë.<sup>63</sup> Ligji nuk arrin t'i harmonizojë kufizimet për donacione me kufizimet për shpenzime, që rezulton me mundësinë që në komunat më të vogla një individ i vetëm të mund të financojë tërësisht fushatën e një garuesi.<sup>64</sup> Financimi i fushatës nga palët e treta nuk është i rregulluar me ligj.<sup>65</sup>

*Korniza ligjore për financimin e fushatës duhet të rishikohet për të trajtuar zbrazëtitat ekzistuese, duke përfshirë edhe ato në lidhje me shumën e kredive bankare dhe mundësinë për donacione pas zgjedhjeve, si dhe financimin nga palët e treta. Për të parandaluar ndikimin e panevojshëm të donatorëve privatë dhe korrupsionin e mundshëm politik, kufijtë e donacioneve dhe shpenzimeve për zgjedhjet lokale mund të përafrohen në mënyrë që fondi i fushatës së një garuesi të mos mbushet nga një donacion i vetëm.*

Ligji kërkon që garuesit të dorëzojnë dy raporte të përkohshme për financimin e fushatës përpara rrethit të parë dhe një përpara rrethit të dytë.<sup>66</sup> Raportet e përkohshme të garuesve duhet të përfshijnë informacion mbi donacionet, por jo edhe për burimet e tjera të të ardhurave ose për shpenzimet, që është në kundërshtim me praktikën e mira ndërkombëtare.<sup>67</sup> Si rezultat i kësaj, shumë raporte të përkohshme, duke i përfshirë edhe ato të partive kryesore parlamentare me shpenzime të dukshme të fushatës, përmbanin shumë pak ose aspak informata për burimet e mjeteve të fushatës. Megjithatë ligji kërkon që KSHZ-ja, KSHPK-ja dhe ESHR-ja t'i publikojnë raportet në ueb-faqet e tyre, ai nuk përcakton një

<sup>60</sup> Sipas Ligjit për Financimin e Partive Politike, 0.15 për qind e burimit të përgjithshëm të të ardhurave të buxhetit duhet t'u jepet partive politike. Nga kjo, 70 për qind duhet t'i ndahen partive parlamentare në proporcion me numrin e deputetëve të fituar, kurse 30 për qind duhet t'u ndahen në mënyrë të barabartë të gjitha partive që kanë marrë të paktën një për qind të votave në zgjedhjet e fundit parlamentare dhe lokale. Në vitin 2021, rreth 58 parti politike morën financim shtetëror; nga këto, LSDM-ja mori 49,956,552 denarë, kurse VMRO-DPMNE 44,039,448 denarë (afërsisht 818,000 dhe 722,000 euro, respektivisht).

<sup>61</sup> 1 euro është përafërsisht 61 denarë të Maqedonisë (MKD). Ligji i përcakton kufijtë e donacioneve në euro dhe kufijtë e shpenzimeve në denarë.

<sup>62</sup> ESHR-ja dhe KSHPK-ja e informuan MVZ-në e ODIHR-it se kishin vërejtur donacione të tilla në zgjedhjet e mëparshme.

<sup>63</sup> Varësisht nga popullsia e komunës, kufijtë e shpenzimeve ishin nga 3,571 EUR (përafërsisht 217,831 denarë) deri në 169,174 euro (10,319,614 denarë) nëpër komuna, dhe 841,271 euro (51,317,531 denarë) në qytetin e Shkupit. Kufijtë e njëjtë të shpenzimeve vlejné si për rrethin e parë ashtu edhe për rrethin e dytë.

<sup>64</sup> Paragrafi 213 i [Udhëzimeve të Përbashkëta për Rregulloren për Partitë Politike](#) i ODIHR-it dhe Komisionit të Venedikut i vitit 2020 (botimi i dytë) parashikon që "kufizimet e arsyeshme për donacionet private mund të përfshijnë përcaktimin e një shume maksimale që mund të dhurohet si kontribut nga një donator i vetëm. Kufizimet e tilla janë treguar efektive në reduktimin e mundësisë së korrupsionit ose blerjes së ndikimit politik".

<sup>65</sup> Paragrafi 256 i [Udhëzimeve të Përbashkëta për Rregulloren për Partitë Politike](#) thekson: "Palët e treta duhet t'i nënshtrohen rregullave të ngjashme për donacionet dhe shpenzimet si edhe partitë politike për t'i shmangur situatat kur palët e treta mund të përdoren për të anashkaluar rregulloret e financimit të fushatës".

<sup>66</sup> Raportet e përkohshme për financimin e fushatës duhej të dorëzoheshin më 7 dhe 16 tetor, dhe 30 tetor, respektivisht. Të gjitha raportet për financimin e fushatës duhet t'i dorëzohen ESHR-së, KSHPK-së dhe KSHZ-së në të njëjtën kohë.

<sup>67</sup> Paragrafi 261 i [Udhëzimeve të Përbashkëta për Rregulloren për Partitë Politike](#) thekson se është praktikë e mirë të kërkojnë raporte që u japin organeve mbikëqyrëse dhe publikut informacion paraprak mbi të ardhurat dhe shpenzimet e fushatave të partive dhe të kandidatëve disa ditë para ditës së zgjedhjeve.

afat kohor, dhe raportet e para të përkohshme për rrethin e parë u publikuan më 14 tetor, duke e kufizuar kohën për shqyrtim publik para ditës së zgjedhjeve. Raporti i dytë i përkohshëm për rrethin e parë dhe raporti i përkohshëm për rrethin e dytë nuk u publikuan para ditëve përkatëse të zgjedhjeve, gjë që e dëmtoi transparencën.<sup>68</sup> KSHPK-ja konfirmoi se disa garues, kryesisht kandidatë të pavarur, nuk arritën të dorëzojnë raporte të përkohshme. Pavarësisht kësaj, nuk u shqiptua asnjë sanksion.<sup>69</sup>

Raporti financiar paszgjedhor duhet të dorëzohet në afat prej 19 ditëve nga dita e zgjedhjeve, ndërsa raporti përfundimtar duhet të dorëzohet në afat prej 75 ditëve nga shpallja e rezultateve përfundimtare. Afati i fundit për dorëzimin e raporteve përfundimtare mbetet në kundërshtim me praktikën e mirë ndërkombëtare.<sup>70</sup> Shablloni për raportet financiare nuk kërkon ndarje të shpenzimeve të garuesve sipas komunës, duke e penguar kështu një shqyrtim domethënës të pajtueshmërisë së tyre me kërkesat e shpenzimeve. Shumica e palëve të interesuara e vunë në dyshim nevojën për të dorëzuar raporte të shumta dhe ngritën shqetësime në lidhje me ndërlikueshmërinë e dokumentacionit raportues, veçanërisht për partitë më të vogla dhe kandidatët e pavarur.<sup>71</sup> Pavarësisht një rekomandimi të mëparshëm të ODIHR-it, nuk u krijua asnjë mekanizëm për dorëzimin elektronik të raporteve për financimin e fushatës, gjë që e përkeqësoi kompleksitetin e raportimit financiar për garuesit dhe e pengoi publikimin në kohë të raporteve.

*Për të rritur transparencën, Kodi Zgjedhor duhet të kërkojë zbulimin e plotë të të gjitha llojeve të të ardhurave dhe shpenzimeve të fushatës nga garuesit, disa ditë përpara ditës së zgjedhjeve. Raportet e financimit të fushatës duhet të përfshijnë një ndarje të shpenzimeve sipas njësive zgjedhore dhe afati për dorëzimin e raporteve përfundimtare duhet të shkurtohet për të qenë në përputhje me praktikën e mira ndërkombëtare. Në përputhje me një rekomandim paraprak, mund të krijohet një mekanizëm për dorëzimin elektronik të raporteve financiare, duke përfshirë zbulimin e të dhënave të të ardhurave.*

Sipas ligjit, KSHPK-ja e mbikëqyr respektimin e rregullave të financimit të fushatës gjatë gjithë procesit zgjedhor. KSHPK-ja shpërndau 16 monitorues *ad hoc* për ta ndjekur fushatën, përveç katër ekspertëve përgjegjës për analizimin e raporteve të monitoruesve dhe për shqyrtimin e llogarive bankare të garuesve.<sup>72</sup> KSHPK-ja e informoi MVZ-në e ODIHR-it se nuk kishte zbuluar asnjë shkelje të madhe të rregullave për financimin e fushatës në rrethin e parë apo të dytë, dhe se nuk ishte shqiptuar asnjë sanksion.<sup>73</sup> Në përgjithësi, MVZ-ja e ODIHR-it vërejti se KSHPK-së i mungonte metodologji për të ndjekur parregullsitë e mundshme të financimit të fushatës para dorëzimit të raporteve përfundimtare financiare, gjë që ngre dyshime në lidhje me efektivitetin e mbikëqyrjes. ESHR-ja është e autorizuar të bëjë revizion të raporteve përfundimtare të financimit të fushatës së garuesve, por nuk bën mbikëqyrje të vazhdueshme gjatë fushatës.

<sup>68</sup> Neni 7.3 i [KKBKK-së](#) rekomandon që shtetet të ndërmarrin masa për ta rritur transparencën në financimin e kandidaturave për funksionet e zgjedhura publike”. Paragrafi 247 i [Udhëzimeve të Përbashkëta për Rregulloren për Partitë Politike](#) thekson se "votuesit duhet të kenë informata përkatëse për sa i përket mbështetjes financiare që u është dhënë partive politike, pasi kjo ndikon në marrjen e vendimeve dhe është një mjet për të kërkuar llogari nga partitë”.

<sup>69</sup> Kodi Zgjedhor parashikon sanksion prej 9,000 eurosh për mosdorëzimin e raporteve për financimin e fushatës.

<sup>70</sup> Paragrafi 200 i [Udhëzimeve të Përbashkëta për Rregulloren për Partitë Politike](#) rekomandon që “[r]aportet për financimin e fushatës duhet t’u dorëzohen autoriteteve kompetente brenda një periudhe jo më shumë se 30 ditë pas zgjedhjeve”.

<sup>71</sup> Paragrafi 260 i Udhëzimeve të Përbashkëta për Rregulloren për Partitë Politike rekomandon që “[r]aportet duhet të bëjnë dallimin e qartë ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve. Më tej, formatet e raportimit duhet të përfshijnë ndarjen e donacioneve në kategori të standardizuara siç përcaktohen nga rregulloret përkatëse dhe duhet të jenë lehtësisht të qasshme dhe të përshtatshme për përdoruesit dhe jo tepër të rënda, duke mundësuar gjithashtu që të dhënat përkatëse të përpunohen në mënyrë elektronike më pas”.

<sup>72</sup> MVZ-ja e ODIHR-it vërejti se monitoruesve të KSHPK-së u mungonte trajnimi gjithëpërfshirës për të ndjekur financimin e fushatës.

<sup>73</sup> Kodi Zgjedhor parashikon gjoba deri në 9.000 euro për shkelje të rregullave të financimit të fushatës. Sanksionet penale për shumicën e shkeljeve të rënda dhe të qëllimshme të rregullave të financimit të fushatës përfshijnë gjoba dhe dënim me burg deri në pesë vjet.

*Agjencitë përgjegjëse për mbikëqyrjen e financimit të fushatës duhet të kryejnë një shqyrtim efektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve të fushatës gjatë gjithë procesit zgjedhor dhe duhet t'i marrin parasysh siç duhet dhe në kohë të gjitha raportet dhe ankesat në lidhje me parregullsitë e supozuara.*

## X. MEDIAT

### A. AMBIENTI MEDIATIK

Një numër i madh i mediave, të ndara përgjatë vijave politike, funksionojnë në një treg të vogël për reklamim. Televizioni dhe mediat online janë burimet kryesore të informimit politik. Bashkëbiseduesit e MVZ-së së ODIHR-it nënvizuan se ka përmirësim për sa i përket mbulimit pluralist të lajmeve por theksuan se ka nevojë për reforma të mëtejshme sistimore në sektorin e mediave. Stagnimi i vazhdueshëm në tregun e reklamave i shkaktuar nga pandemia e KOVID-19 ka rritur më tej varësinë e mediave, veçanërisht të mediave lokale, nga subvencionet shtetërore. Transmetuesi publik, Radio Televizioni i Maqedonisë (*RTM*), financohet nga buxheti i shtetit, mirëpo nuk i është ndarë asnjëherë shuma e plotë e përcaktuar me ligj.<sup>74</sup> Fusha e mediave online, me një numër të madh të mediave, është kryesisht e parregulluar. Bashkëbiseduesit e MVZ-së së ODIHR-it ngritën shqetësime në lidhje me auto-censurën dhe kushtet e këqija të punës në mediat tradicionale, nivelin e ulët të profesionalizmit dhe ngacmimin online, veçanërisht kundër gazetareve. Gjatë periudhës së vëzhgimit, disa gazetarë ishin në shënjestër të politikanëve dhe zyrtarëve publikë.<sup>75</sup>

### B. KORNIZA LIGJORE

Kodi Zgjedhor parashikon rregullore të hollësishme për sjelljen e mediave, duke filluar nga shpallja e zgjedhjeve e deri në përfundimin e fushatës. Nga të gjitha mediat, duke përfshirë edhe mediat online, kërkohet t'i mbulojnë zgjedhjet në mënyrë të drejtë, të balancuar dhe të paanshme. Përkundër rekomandimeve të mëparshme të ODIHR-it, emisionet e lajmeve të *RTM-së* publike edhe më tej i nënshtrohen rregulloreve të rrepta gjatë periudhës së fushatës, gjë që e minon pavarësinë redaktuese të transmetuesit.<sup>76</sup>

<sup>74</sup> Neni 105 i Ligjit për Shërbimet Audio dhe Audio-Vizuale Mediatike përcakton se mjetet për financimin e aktivitetit transmetues, funksionimin dhe zhvillimin e *RTM-së* dhe të Agjencisë për Shërbimet Audio dhe Audio-Vizuale Mediatike (ASHAAM) do të sigurohen nga buxheti i shtetit, në shumën prej 0.8 deri në 1 për qind të buxhetit të përgjithshëm të shtetit. Sipas *RTM-së*, shpërndarja reale e buxhetit u ul nga 0,66 në 0,59 për qind nga viti 2018 deri në vitin 2021. [Rekomandimi Nr. R \(96\) 10](#) i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për Shtetet Anëtare për Garancinë e Pavarësisë së Transmetimeve Publike përcakton se “pagesa e kontributit duhet të bëhet në një mënyrë që garanton vazhdimësinë e aktiviteteve të organizatës së transmetimit publik dhe i mundëson të bëjë planifikim afatgjatë”.

<sup>75</sup> Për shembull, ASHAAM-i e dënoi [sulmin verbal](#) të një kandidati të pavarur për kryetar komune për komunën e Kërçovës ndaj një gazetaresje të *TV21* që e mbulonte periudhën zgjedhore, dhe [përpjekjen për të diskredituar një gazetar](#) nga kandidati i AA-së për kryetar komune në Tetovë. [ASHAAM-i](#) dhe [Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë \(SHGM\)](#) e dënuan publikisht sjelljen e pretenduar të papërshtatshme ndaj gazetarëve nga Ministri i Punëve të Jashtme dhe kryetari i KSHZ-së. Ministria e Punëve të Jashtme e informoi MVZ-në e ODIHR-it se i refuzon pretendimet dhe i dërgoi një letër SHGM-së. Kryetari i KSHZ-së kërkoi falje publike. Më 21 tetor 2021 në një [Deklaratë të përbashkët](#) nga Përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Mediave, Raportuesi Special i OKB-së për Mbrojtjen e Promovimin e Lirisë së Mendimit dhe të Shprehjes, Raportuesi Special i Organizatës së Shteteve Amerikane për Lirinë e Shprehjes, dhe Raportuesi Special për Lirinë e Shprehjes dhe Qasjen në Informata i Komisionit Afrikan për të Drejtat e Njeriut dhe të Popullit, u denoncuan deklaratat publike të politikanëve dhe të zyrtarëve publikë që “kërcënojnë ose inkurajojnë sulme ndaj gazetarëve, mbrojtësve të të drejtave të njeriut dhe i vendosin pakicat në rrezik”.

<sup>76</sup> Gjatë periudhës zyrtare të fushatës, *RTM-ja* është e obliguar t'i kushtojë 30 për qind të lajmeve ngjarjeve të përgjithshme, 30 për qind partive në pushtet, 30 për qind opozitës parlamentare dhe 10 për qind partive joparlamentare dhe kandidatëve të pavarur.



*Dispozitat që i rregullojnë lajmet e transmetuesit publik gjatë periudhës së fushatës duhet të rishikohen, me qëllim që të sigurohet liria redaktuese dhe të sigurohet qasje dhe mbulim i barabartë i lajmeve për partitë më të vogla dhe kandidatët e pavarur. Reformat e mëtejshme të duhet të synojnë forcimin e cilësisë së përmbajtjes së prodhuar nga transmetuesi publik, duke përfshirë gazetarinë hulumtuese dhe atë analitike.*

Respektimi i kërkesave ligjore nga ana e mediave në lidhje me mbulimin e zgjedhjeve, nga dita e shpalljes së zgjedhjeve deri në fund të votimit, u mbikëqyr nga Agjencia për Shërbime Audio dhe Audio-Vizuale Mediatike (ASHAAM), e cila publikoi disa raporte për mbulimin mediatik gjatë periudhës zgjedhore. ASHAAM-i konstatoi se për shkak të numrit të madh të kandidatëve, si dhe për shkak të intensitetit të ndryshëm të aktiviteteve të tyre parazgjedhore, transmetuesit nuk kishin mundësi ta respektojnë parimin e barazisë. Raportet ditore të cilat ASHAAM-i ia dërgonte KSHZ-së gjatë periudhës zyrtare të fushatës nuk u shqyrtuan publikisht nga KSHZ-ja dhe nuk kontribuan në efikasitetin apo transparencën e mbikëqyrjes së mediave.

*Kërkesa ligjore për raportimin ditor nga organi rregullator i medias tek administrata zgjedhore mund të zëvendësohet me raporte ad hoc që trajtojnë shqetësime specifike të lidhura me zgjedhjet.*

Megjithëse nuk u raportuan shkelje, ASHAAM-i lëshoi deklarata në lidhje me një sërë rastesh të përdorimit të të miturve në reklamat politike, si dhe për detyrimin ligjor të transmetuesve për të bërë të qasshëm mbulimin e tyre zgjedhor, duke përfshirë përdorimin e gjuhës së shenjave, i cili u përmbush vetëm nga një kanal televiziv kabllor privat.

*Transmetuesit kombëtarë duhet të përpiqen t'i bëjnë programet e tyre të qasshme për personat me dëmtime shqisore. Duhet konsideruar mundësia për ndryshimin e Kodit Zgjedhor për të dhënë udhëzime më të qarta dhe më specifike për sa i përket transmetimit të informacionit të qasshëm për elektoratin.*

Reklamat e paguara në media gjatë periudhës së fushatës financohen drejtpërdrejt dhe ekskluzivisht nga buxheti i shtetit.<sup>77</sup> Ligji nuk përcakton kritere objektive dhe të arsyeshme për shpërndarjen e mjeteve publike për reklamat e paguara, që u jep një përparësi të konsiderueshme partive më të mëdha parlamentare, ndërsa ua mohon në mënyrë efektive mundësinë partive më të vogla dhe kandidatëve të pavarur për të zhvilluar fushatë në media. Në formën e tij aktuale, ligji e shtrembëron ndjeshëm terrenin për garë, veçanërisht në kontekstin e balotazheve për kryetarë të komunave, në kundërshtim me angazhimet e OSBE-së dhe praktikatat e mira ndërkombëtare.<sup>78</sup> E majta ("Levica") dhe Partia Liberal Demokratike (PLD) e kontestuan listën e ASHAAM-it të partive më të vogla që ndajnë një minutë të

<sup>77</sup> Buxheti për zhvillim të fushatës në media nuk mund të kalojë 2 euro për votues në rrethin e parë, dhe 1 euro për votues në komunat ku mbahet rrethi i dytë. Çmimi mesatar për reklamat e paguara në televizion, në bazë të llogaritjeve të KSHZ-së në përputhje me ligjin, nuk mund të kalojë 1,97 euro për sekondë. Për të ofruar kohë të paguar transmetimi për garuesit, mediat duhej të regjistroheshin në KSHZ. Megjithëse KSHZ-ja regjistroi rreth 300 media, aplikimet e të paktën 27 mediave u refuzuan, kryesisht për arsye të mosrespektimit të afateve dhe mos dorëzimit të të gjitha dokumenteve të kërkuara.

<sup>78</sup> Koalicioni i kryesuar nga LSDM-ja "Më e mira për komunën time", BDI-ja, koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE-ja "Rindërtimi i Maqedonisë" dhe AA dhe AlternAtivA morën 90 për qind të mjeteve të ndara, ndërsa partitë më të vogla parlamentare ndanë 7 për qind, kurse të gjitha partitë joparlamentare dhe kandidatët e pavarur duhej të ndanin 3 për qindëshin e mbetur të mjeteve. Paragrafi 7.8 i [Dokumentit të OSBE Kopenhagës i vitit 1990](#) i obligon Shtetet pjesëmarrëse të garantojnë se "asnjë pengesë ligjore ose administrative nuk duhet ta pengojë qasjen e papenguar në media, duke mos diskriminuar mbi asnjë bazë, për të gjitha grupet politike dhe individët që dëshirojnë të marrin pjesë në procesin zgjedhor". Seksioni I.2.3 i [Kodit të Praktikës së Mirë në Cështjet Zgjedhore](#) parashikon që mundësitë e barabarta duhet të garantohet si për partitë ashtu edhe për kandidatët, ndër të tjera, edhe në lidhje me transmetim të mediave dhe mjetet publike, dhe se varësisht nga tema, barazia mund të jetë e rreptë ose proporcionale. Paragrafi 233 i [Udhëzimeve të Përbashkëta për Rregulloren për Partitë Politike](#) parashikon që mjetet publike duhet të ndahen në mënyrë jopartiake, në bazë të kriterëve të drejta dhe të arsyeshme", ndërsa paragrafi 235 parashikon se "sistemi për përcaktimin e shpërndarjes proporcionale (ose të drejtë) të mbështetjes shtetërore financiare ose në natyrë duhet të jetë objektiv, i drejtë dhe e arsyeshëm".

kohës së transmetimit me pagesë në orë, duke theksuar se disa parti më të vogla garuan në koalicione ose ishin pjesë e grupeve parlamentare të partive më të mëdha dhe për këtë arsye duhej t'u ishte ndarë më shumë kohë transmetimi. Si rezultat i kësaj, ASHAAM-i e hoqi listën pa sqarime të mëtejshme për ndarjen e kohës së transmetimit. Në media nuk u publikua asnjë informacion zyrtar për buxhetin aktual të ndarë për fushatën, gjë që bëri që garuesit të planifikonin aktivitetet e tyre duke u bazuar në shumën maksimale të përcaktuar me ligj, ndërsa transmetuesit rrezikonin të mos kompensoheshin për shërbimet e ofruara. ASHAAM-i lëshoi udhëzim ku thekson se garuesit mund ta ndajnë ose ta shpërndajnë kohën e transmetimit të subvencionuar nga shteti me kandidatët e pavarur, përtej ndarjeve të parashikuara me ligj.<sup>79</sup>

*Rregulloret për reklamat e paguara politike në media duhet të rishikohen, në mënyrë që të mundësohet qasje e papenguar në media në bazë të kriterëve të arsyeshme dhe objektive dhe të shmanget një avantazh joproporcional për partitë më të mëdha parlamentare. Duhet të ketë një vendim të qartë, përpara fillimit të periudhës zyrtare të fushatës, për ndarjen e buxhetit dhe kohën e transmetimit ndërmjet partive më të vogla dhe kandidatëve të pavarur.*

### C. MONITORIMI I MEDIAVE NGA MVZ-JA E ODIHR-IT

Sipas monitorimit të mediave nga MVZ-ja e ODIHR-it, mbulimi në lidhje me zgjedhjet në mediat elektronike, në përgjithësi, ishte me ton neutral në të dy rrethet zgjedhore.<sup>80</sup> Gjatë periudhës së fushatës zyrtare, dy partitë më të mëdha dominuan në lajmet e transmetuesve kombëtarë të monitoruar.<sup>81</sup> Mediat e monitoruara nga MVZ-ja e ODIHR-it e pasqyruan ndarjen e partive politike dhe të mediave përgjatë vijave etnike, si në aspekt të mediave që u zgjodhën nga partitë politike për të publikuar reklama, ashtu edhe në aspekt të zgjedhjes së të ftuarve në debate dhe programe për çështje aktuale nga ana e transmetuesve.<sup>82</sup> Në të dy rrethet, BDI-ja dominoi në mbulimin e mediave online në gjuhën shqipe që u monitoruan, me ç'rast edhe *Lajmpress.org* kishte një mbulim pozitiv të partisë. Portali në gjuhën maqedonase *Kurir.mk* e mbuloi gjerësisht VMRO-DPME-në, kryesisht me ton neutral.

Vetëm disa kandidatë shprehën interes për ta shfrytëzuar kohën e transmetimit falas në dy kanalet televizive publike të monitoruara. Përzgjedhja e kandidatëve për debatet e shumta televizive dhe emisionet debative në mediat private mbeti nën diskrecionin e redaksive. Shumica e partive joparlamentare dhe kandidatët e pavarur patën mbulim të kufizuar nga redaksitë në rrethin e parë, pjesërisht për shkak të aktiviteteve të tyre modeste të fushatës, dhe gjithashtu publikuan shumë pak reklama të paguara politike për shkak të buxhetit të tyre të kufizuar.<sup>83</sup> Danella Arsovska (Shkup) dhe Maksim Dimitrievski (Kumanovë) morën pothuajse të gjithë mbulimin kombëtar të dedikuar për kandidatët e pavarur në programet e lajmeve të kanaleve të monitoruara në rrethin e dytë. Pasi që kishte

<sup>79</sup> Për shembull, VMRO-DPMNE-ja e mbështeti kandidaten e pavarur për kryetare të komunës, Danella Arsovska në Shkup; pasi një mundësi e tillë nuk është e rregulluar me ligj, këtë e kontestoi "Levica" (E Majta) në KSHPK. KSHPK-ja konstatoi se kishte një zbrazëtim në Kodin Zgjedhor dhe e hodhi poshtë ankesën.

<sup>80</sup> Më 22 shtator, MVZ-ja e ODIHR-it filloi monitorimin sasior dhe cilësor të transmetimeve me shikueshmëri më të madhe (ndërmjet orës 18:00 dhe 00:00) të transmetuesve publikë *RTM 1* dhe *RTM 2*, të transmetuesve privatë *Alsat-M*, *Kanal 5*, *Telma* dhe *Sitel*, dhe mbulimin e zgjedhjeve nga ueb-faqet [kurir.mk](http://kurir.mk), [plusinfo.mk](http://plusinfo.mk), [tetovasot.com](http://tetovasot.com), dhe [lajmpress.org](http://lajmpress.org).

<sup>81</sup> Në edicionet e lajmeve të kanaleve private, në rrethin e parë, LSDM-ja pati mbulim midis 18 dhe 31 për qind, kurse VMRO-DPMNE-ja midis 13 dhe 28 për qind, ndërsa në rrethin e dytë, ato patën mbulim midis 17 dhe 31 për qind dhe midis 13 dhe 21 për qind, respektivisht.

<sup>82</sup> Në kanalet gjuhën maqedonase, partitë shqiptare patën deri në 3 për qind të mbulimit në debatet dhe programet për çështjet aktuale në rrethin e parë dhe deri në 2 për qind në rrethin e dytë, ndërsa kanalet në gjuhën shqipe i mbuluan këto parti pothuajse ekskluzivisht. Përderisa reklamat me pagesë të partive etnike shqiptare pothuajse mungonin në kanalet në gjuhën maqedonase, rreth 86 dhe 81 për qind e reklamave me pagesë në *Alsat-M* gjatë periudhës së monitorimit ishin të porositura nga partitë shqiptare.

<sup>83</sup> Me përjashtim të Danella Arsovska, e cila në dy rrethet zgjedhore pati 7 dhe rreth 3 për qind, respektivisht, të pjesës së reklamës së paguar të VMRO-DPMNE-së gjatë periudhës së monitoruar dhe ishte e dukshme gjatë gjithë periudhës së fushatës.

më pak kandidatë, transmetuesit e monitoruar, në rrethin e dytë u ofruan votuesve informata të mjaftueshme për garuesit.

## XI. KUNDËRSHTIMET DHE ANKESAT

### A. KORNIZA LIGJORE

Legjislacioni për zgjidhjen e kontesteve zgjedhore përmban zbrazëtira dhe paqartësi të shumta, të cilat e pengojnë procesin, ku bëjnë pjesë edhe afatet e shkurta kohore, kërkesa për seancë publike dhe shqyrtimi e ankesave në komisionet zgjedhore të nivelit më të ulët.<sup>84</sup> Formulimi i paqartë i afateve të reja kohore, të futura me ndryshimet në Kodin Zgjedhor të bëra në shtator të vitit 2021 krijuan një pasiguri shtesë.<sup>85</sup> Përkundër rishikimeve të shpeshta të ligjit, rekomandimet e mëparshme të ODIHR-it në lidhje me shqyrtimin e kontesteve zgjedhore mbeten të patrajuara. Baza ligjore e votuesve për të parashtruar kundërshtime mbetet e kufizuar në rastet që kanë të bëjnë me Listat Zgjedhore dhe të drejtat e tyre individuale të votimit, në kundërshtim me praktikatat e mira ndërkombëtare.<sup>86</sup> Vëzhguesit qytetarë nuk kanë të drejtë të parashtrorjnë ankesa.<sup>87</sup>

*Baza ligjore për parashtrimin e kundërshtimeve duhet të zgjerohet që t'i përfshijë edhe votuesit dhe vëzhguesit qytetarë. Për të lejuar kohën e duhur për parashtrimin dhe trajtimin e kundërshtimeve, afatet mund të harmonizohen me praktikatat e mira ndërkombëtare.*

Sipas Kodit Zgjedhor, kundërshtimet në instancën e parë mund të parashtrohen te KZK-të, KSHZ-ja dhe gjykatat themelore. Gjykatat themelore dhe KSHZ-ja i shqyrtojnë kundërshtimet kundër shkeljeve të fushatës, por kompetencat e tyre mbi këto çështje nuk janë përcaktuar qartë. Kundërshtimet në lidhje me financimin e fushatës dhe keqpërdorimin e burimeve administrative mund të parashtrohen në KSHPK. Gjykata Administrative është shkalla e fundit e ankimit për shumicën e kundërshtimeve. Ndryshe nga vendimet e KSHZ-së për shkeljet e të drejtave individuale, rregulloret e KSHZ-së mund të kontestohen vetëm para Gjykatës Kushtetuese, pa parashikuar një procedurë të shkurtuar, gjë që e kufizon mundësinë për mjet efektiv ligjor.<sup>88</sup>

*Për të siguruar mjet efektiv ligjor, ligji duhet të parashikojë mundësinë e shqyrtimit gjyqësor në kohë të të gjitha vendimeve administrative që kanë të bëjnë me zgjedhjet, duke i përfshirë të gjitha rregulloret e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve.*

<sup>84</sup> Si rregull, ankuesit kanë deri në 2 ditë për të parashtruar një kundërshtim, me ç'rast janë paraparë 1-3 ditë për shqyrtimin e shumicës së kundërshtimeve. Pas ndryshimeve të fundit, kundërshtimet për ditën e zgjedhjeve nga votuesit duhet të parashtrohen brenda 12 orëve (më parë 24 orë) dhe duhet të shqyrtohen brenda 2 orësh. Seksioni h II.3.3(95) i [Raportit Shpjegues të Kodit të Praktikës së Mirë](#) thotë se afatet kohore duhet [...] të zgjasin aq sa për të garantuar ushtrimin e së drejtës për ankesë, si dhe marrjen e një vendimi të peshuar mirë. Një afat kohor prej tri deri në pesë ditë në instancën e parë (duke përfshirë parashtrimin e apelimit dhe marrjen e vendimit) duket se është i arsyeshëm”.

<sup>85</sup> Kjo bëri që Gjykata Administrative të kërkojë shpjegim zyrtar nga Ministria e Drejtësisë. Gjykata e njoftoi MVZ-në e ODIHR-it se deri më 15 tetor nuk kishin marrë përgjigje dhe vendosi të zbatonte afatin më të gjatë të parashikuar nga ligji (3 ditë) për të gjitha ankesat në lidhje me parregullsitë e ditës së zgjedhjeve.

<sup>86</sup> Seksioni II.3.3.f i [Kodit të praktikës së mirë](#) rekomandon se "të gjithë kandidatët dhe të gjithë votuesit e regjistruar në zonën përkatëse zgjedhore duhet ta kenë të drejtën e ankimit Në rastin e ankimit nga votuesit për rezultatet e zgjedhjeve mund të aplikohet një kuorum i arsyeshëm”.

<sup>87</sup> Vërejtjet e vëzhguesve në lidhje me parregullsitë e pretenduara mund të vetëm të regjistrohen në Ditarët për evidencën e ngjarjeve të KZ-ve.

<sup>88</sup> Paragrafi 5.10 i [Dokumentit të Kopenhagës i OSBE-së i vitit 1990](#) parashikon se "çdokush do të ketë mjete efektive juridike ndaj vendimeve administrative, për ta garantuar respektimin e të drejtave themelore dhe për ta siguruar integritetin ligjor”.

## B. KUNDËRSHTIMET PARAZGJEDHORE

Deri më 15 tetor, KSHZ-ja pranoi dhe shqyrtoi në seanca publike 23 kundërshtime, shumica në lidhje me të drejtën e votës, duke përfshirë edhe votimin në shtëpi. 17 prej tyre u miratuan. Në shumicën e rasteve, KSHZ-ja nuk iu përmbajt afateve për shqyrtimin e kundërshtimeve dhe shumë vendime nuk u publikuan, duke e minuar transparencën. Udhëzimet e KSHZ-së për shqyrtimin e ankesave u miratuan vonë dhe përmbanin mospërputhje për sa i përket afateve kohore, gjë që ndikoi në kuptimin adekuat të procedurave të kërkuara, veçanërisht në nivelin e KZK-ve.<sup>89</sup> Në përputhje me ligjin, KSHZ-ja e mirëmbajti një sistem elektronik për parashtrimin dhe ndjekjen e kundërshtimeve, por nuk e lëshoi në përdorim deri në më 6 tetor dhe nuk e përditësoi atë në mënyrë të vazhdueshme, gjë që rezultoi në informacion të kufizuar publik lidhur me kundërshtimet dhe vendimet përkatëse. As ligji e as udhëzimet e KSHZ-së nuk kërkojnë që komisionet zgjedhore t'i njoftojnë partitë për seancën në lidhje me rastin e tyre; KSHZ-ja konfirmoi se vetëm garuesit e regjistruar ishin të ftuar të merrnin pjesë në seanca, në kundërshtim me praktikën e mirë ndërkombëtare.<sup>90</sup>

KSHPK-ja shqyrtoi dy kundërshtime në seancë publike, edhe atë duke i respektuar të drejtat procedurale të palëve në rast. Megjithatë, 30 raporte të parashtruara në KSHPK që nga shpallja e zgjedhjeve, shumica prej të cilave pretendonin keqpërdorimin e burimeve shtetërore, nuk u trajtuan si kundërshtime dhe për këtë arsye nuk u shqyrtuan në mënyrë të përshpejtuar, duke e minuar kështu mjetin efektiv ligjor.

Gjykata Administrative pranoi dhe shqyrtoi 14 kundërshtime para ditës së zgjedhjeve të rrethit të parë, 12 në lidhje me regjistrimin e kandidatëve dhe 2 në lidhje me përshtatshmërinë e mediave të caktuara për të marrë financim shtetëror për reklama të paguara politike. Të gjitha u refuzuan ose u hodhën poshtë. Ashtu siç kërkohet me ligj, Gjykata Administrative i publikoi vendimet e saj në lidhje me kundërshtimet në kohë. Përkundër kërkesës kushtetuese për të mbajtur seancë publike, Gjykata Administrative e shqyrtoi shumicën e ankesave pa seancë, në kundërshtim me detyrimet ndërkombëtare.<sup>91</sup>

*Për të rritur transparencën dhe për të siguruar një proces të rregullt, e drejta për një seancë publike ku do të përfshihen të dyja palët duhet të mbrohet si në gjykata ashtu edhe në komisionet zgjedhore.*

## C. KUNDËRSHTIMET NË DITËN E ZGJEDHJEVE DHE PAS ZGJEDHJEVE

Në ditën e zgjedhjeve të rrethit të parë, u parashtruan 699 kundërshtime nga votuesit, në lidhje me të drejtën e tyre për të votuar. 495 prej tyre u miratuan.<sup>92</sup> Në ditën e zgjedhjeve të rrethit të dytë, duke përfshirë edhe rrethin e dytë të zgjedhjeve për kryetar komune në Dibër më 14 nëntor, KSHZ-ja raportoi 794 kundërshtime në lidhje me të drejtën e votuesve për të votuar. 699 prej tyre u miratuan. Kundërshtimet lidhur me të drejtën e votës mund të parashtrohen personalisht në KZK ose në mënyrë elektronike. Përderisa në disa raste KZK-të vepruan në kohë në lidhje me këto kundërshtime, shumë prej tyre u trajtuan pas afatit, kryesisht për shkak të vonesave në komunikim me

<sup>89</sup> Një udhëzim në lidhje me shqyrtimin e ankesave nga KZK-të u miratua më 30 shtator dhe u publikua më 3 tetor, dhe një udhëzim për shqyrtim nga KSHZ-ja u miratua më 8 tetor dhe u publikua më 11 tetor.

<sup>90</sup> Seksioni II.3.3.h i [Kodit të Praktikës së Mirë](#) parashikon se duhet të mbrohet e “drejta e palës ankuese” për të marrë pjesë në seancë që i përfshin të dyja palët”.

<sup>91</sup> Neni 16 i [PNDCP-së](#) parashikon të drejtën themelore për një seancë të drejtë dhe publike nga një gjykatë kompetente.

<sup>92</sup> Deri më 30 tetor, KSHZ-ja nuk ishte në gjendje ta konfirmonte numrin e përgjithshëm të kundërshtimeve për rrethin e parë për shkak të një numri të dukshëm të kundërshtimeve të dyfishta, të parashtruara edhe personalisht edhe në mënyrë elektronike. Para rrethit të dytë, KSHZ-ja shqyrtoi edhe 122 kundërshtime të tjera nga votuesit në lidhje me të drejtën e tyre për të votuar dhe votimin në shtëpi. 82 prej tyre u miratuan.



KSHZ-në.<sup>93</sup> Përveç kësaj, mungesa e njohjes së procedurave për trajtimin e kundërshtimeve në radhët e KZK-ve, çoi në zbatimin jokonsekuent të tyre; megjithëse KZK-të, në përgjithësi, ishin të përfshira në përpunimin e kundërshtimeve, shumë prej tyre u përmbajtën nga shqyrtimin i tyre dhe ia përcollën këto kundërshtime KSHZ-së për të marrë vendim. Si rezultat i kësaj, një numër kundërshtimesh në rrethin e parë në lidhje me të drejtën e votës nuk u trajtuan, duke i privuar ata votues nga mundësia për të votuar dhe duke i minuar mjetet efektive ligjore. MVZ-ja e ODIHR-it vërejti se në rastet ku KZK-të e morën përsipër t'i shqyrtonin ankesat, ato shpesh nuk u shqyrtuan në mbledhje publike e as në mënyrë kolegjiale.

*Duhet konsideruar mundësia për forcimin e kapaciteteve të Komisioneve Zgjedhore Komunale dhe procedurave përkatëse për trajtimin e kundërshtimeve. Sistemi elektronik për parashtrimin dhe ndjekjen e kundërshtimeve mund të përmirësohet për të ofruar përditësime në kohë në lidhje me kundërshtimet e parashtruara dhe për të rritur transparencën.*

Pas rrethit të parë, KSHZ-ja shqyrtoi 14 kundërshtime, 2 në lidhje me shkeljen e heshtjes zgjedhore dhe 12 në lidhje me rezultatet, të gjitha të parashtruara nga garuesit.<sup>94</sup> Të gjitha këto u refuzuan ose u hodhën poshtë, shpesh pa marrë parasysh thelbin e kundërshtimit dhe provat e ofruara në lidhje me shkeljen e pretenduar.<sup>95</sup> Tre kundërshtime u hodhën poshtë për shkak se u parashtruan nga përfaqësues të paautorizuar të garuesve, pa u dhënë mundësi garuesve që t'i ri-dorëzonin kundërshtimet përmes përfaqësuesve të tyre të autorizuar ligjorisht;<sup>96</sup> katër kundërshtime u hodhën poshtë për shkak se ishin dorëzuar menjëherë pas afatit.<sup>97</sup> Pas rrethit të dytë, KSHZ-ja shqyrtoi 15 kundërshtime lidhur me rezultatit. 14 prej tyre u refuzuan ose u hodhën poshtë.<sup>98</sup> Një kundërshtim u pranua dhe KSHZ-ja i anuloi rezultatet në një vendvotim në Zhelinë. Megjithëse të gjitha kundërshtimet u shqyrtuan në mbledhje publike, palët e përfshira në rast nuk u ftuan në mënyrë konsekuente të marrin pjesë në to, kurse disa mbledhje nuk u transmetuan online. Në përgjithësi, mangësitë e shumta në trajtimin e kundërshtimeve në KSHZ, e minuan të drejtën për mjet efektiv ligjor, që është në kundërshtim me angazhimet e OSBE-së.<sup>99</sup>

*Për të garantuar mjet efektiv ligjor, rregullat për pranueshmërinë e kundërshtimeve duhet të përcaktojnë kërkesa të arsyeshme dhe diapazoni i provave të pranueshme nuk duhet të kufizohet në mënyrë të panevojshme. Vendimet e administratës zgjedhore duhet të jenë të arsyetuara, duke siguruar shqyrtimin efektiv të bazueshmërisë së të gjitha kundërshtimeve.*

<sup>93</sup> KZK-të nuk kishin qasje në regjistrin e votuesve dhe atyre iu kërkua që t'i verifikojnë të dhënat e votuesve përmes KSHZ-së. Numri i madh i kërkesave të tilla në ditën e zgjedhjeve të rrethit të parë çoi në grumbullim të konsiderueshëm të tyre, e që u përkeqësua edhe më tej për shkak të problemeve teknike. Disa KZK e informuan MVZ-në e ODIHR-it se kishin pranuar informacionin e nevojshëm vetëm pak para përfundimit të votimit.

<sup>94</sup> Pesëmbëdhjetë 15 kundërshtime në lidhje me rezultatet rrethit të parë u tërhoqën, duke i përfshirë edhe kundërshtimet e dorëzuara nga AA-ja, BDI-ja, LSDM-ja dhe VMRO-DPMNE-ja. Disa garues e informuan MVZ-në e ODIHR-it se kundërshtimet e tyre u tërhoqën në pritje të refuzimit për mungesë provash për shkak të kriterëve të rrepta ligjore për pranueshmërinë e provave, si dhe për shkak të mungesës së besimit në sistemin për zgjidhjen e kontesteve zgjedhore.

<sup>95</sup> Në disa raste, KSHZ-ja refuzoi t'i merrte në konsideratë provat e ofruara për shkak të mungesës së vërejtjes në protokollet e rezultateve ose i refuzoi kundërshtimet për shkak të mungesës së provave, pa u përpjekur të shqyrtonte siç duhet provat e ofruara nga aplikuesi, pavarësisht nga një rekomandim i mëparshëm i ODIHR-it.

<sup>96</sup> Seksioni II.3.3b i [Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore](#) rekomandon se "procedura duhet të jetë e thjeshtë dhe pa formalitete, veçanërisht për sa i përket pranueshmërisë së ankesave."

<sup>97</sup> Megjithëse dy kundërshtimet e hedhura poshtë kontestonin çështje që kishin të bëjnë me nxjerrjen e rezultateve, dhe rrjedhimisht, sipas ligjit, ato mund të parashtrohen brenda 48 orëve nga shpallja e rezultateve, KSHZ-ja në vendimet përkatëse ka theksuar se këto kundërshtime është dashur të dorëzohen brenda 48 orëve nga mbyllja e votimit.

<sup>98</sup> Tetë kundërshtime u tërhoqën, 7 nga LSDM-ja dhe 1 nga VMRO-DPMNE-ja.

<sup>99</sup> Paragrafi 5.10 i [Dokumentit të Kopenhagës i OSBE-së i vitit 1990](#) parashikon se "çdokush do të ketë mjete efektive juridike ndaj vendimeve administrative, për ta garantuar respektimin e të drejtave themelore dhe për ta siguruar integritetin ligjor".

Për dy vendime të KSHZ-së për rezultatet e rrethit të parë u parashtruan ankesa në Gjykatën Administrative; të dy vendimet u anuluan, dhe rezultatet në dy vendvotime në Dibër dhe në Shuto Orizare u anuluan. Për pesë vendime të KSHZ-së për rezultatet u parashtruan ankesa në Gjykatën Administrative pas rrethit të dytë. Një vendim i KSHZ-së lidhur me anulimin e rezultateve në një vendvotim në Zhelinë u anulua, ndërsa të gjitha vendimet tjera të KSHZ-së u miratuan.

Prokuroria Publike e Shtetit njoftoi se kishte pranuar një sërë denoncimesh për sjellje të mundshme kriminale gjatë periudhës zgjedhore, duke përfshirë lidhur me blerjen e supozuar të votave dhe presionin ndaj votuesve, si dhe për incidente të dhunshme gjatë një ngjarjeje të fushatës dhe në shtëpinë e një kandidati.<sup>100</sup> Deri në mbylljen e MVZ-së së ODIHR-it, këto mbetën nën hetim.

## XII. VËZHguesIT QYTETARË DHE NDËRKOMBËTARË

Kodi Zgjedhor parashikon vëzhgimin qytetar dhe ndërkombëtar, e gjithashtu u jep të drejtë garuesve të regjistruar të caktojnë përfaqësuesit e tyre të autorizuar për ta ndjekur të gjithë procesin zgjedhor, gjë që kontribuoi për transparencën e procesit. Shoqatat e qytetarëve dhe organizatat e huaja të regjistruara të paktën një vit para ditës së zgjedhjeve dhe statutet e të cilave e përfshijnë parimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut mund të aplikojnë në KSHZ deri në 10 ditë para ditës së zgjedhjeve për akreditimin e vëzhguesve.<sup>101</sup> Përfaqësuesit e kandidatëve në organet zgjedhore të nivelit më të ulët mund të regjistrohen në KZK deri në dy ditë para ditës së zgjedhjeve. Kodi Zgjedhor nuk e rregullon në mënyrë eksplicite procesin e akreditimit për zgjedhjet e balotazhit. KSHZ-ja i publikoi të dhënat për vëzhguesit e akredituar vetëm pak para ditës së zgjedhjeve të rrethit të dytë. Megjithatë, numrat e shënuar në ueb-faqen e KSHZ-së nuk përputheshin plotësisht me numrat e shpallur gjatë mbledhjeve përkatëse. Nuk kishte asnjë informacion mbi përfaqësuesit e autorizuar të garuesve të regjistruar.

Në mënyrë gjithëpërfshirëse, KSHZ-ja e zgjati periudhën e akreditimit të vëzhguesve për të gjitha organizatat që dëshironin të vëzhgonin para çdo rrethi të zgjedhjeve, pa caktuar afate kohore. Përkundër ftesës nga KSHZ-ja drejtuar të gjitha organizatave që kanë të drejtë t'i vëzhgojnë zgjedhjet, kapaciteti dhe interesi i OSHC-ve ishte i kufizuar. Akreditimet e lëshuara në rrethin e parë për vëzhguesit dhe gazetarët e huaj, si dhe për përfaqësuesit e garuesve në zgjedhje që garuan në rrethin e dytë, mbetën të vlefshme edhe për balotazhin. Gjithsej, për të dy rrethet zgjedhore, KSHZ-ja akreditoi 7 organizata vëzhguese qytetare me gjithsej 1,210 vëzhgues, si dhe 2 organizata ndërkombëtare dhe 19 delegacione diplomatike dhe të huaja.<sup>102</sup> Nga organizatat vëzhguese qytetare, CIVIL – Qendra për Liri ishte i vetmi grup që zhvilloi aktivitete afatgjata të vëzhgimit në të gjithë vendin, duke filluar nga mesi i gushtit. Në të dyja ditët e zgjedhjeve, CIVIL shpërndau rreth 280 vëzhgues afatshkurtër. Organizata i prezantoi gjetjet nga monitorimi i saj i mediave dhe i fushatës para zgjedhjeve në disa konferenca për shtyp dhe në ueb-faqen e saj para të dy ditëve të zgjedhjeve dhe raportoi për vëzhgimet e saj gjatë gjithë të dy ditëve të zgjedhjeve, duke kontribuar kështu për transparencën e procesit.

Pas rrethit të parë, CIVIL e informoi MVZ-në e ODIHR-it se disa nga vëzhguesit e tyre ishin penguar në punën e tyre gjatë ditës së zgjedhjeve të rrethit të parë, duke vënë në dukje mungesën e njohjes së procedurave nga anëtarët e KZ-ve, por gjithashtu duke përmendur edhe faktin se distinktivët e tyre si

<sup>100</sup> Një komision u krijua në kuadër të Prokurorisë Publike të Shtetit për ta koordinuar hetimin e parregullsive në lidhje me zgjedhjet.

<sup>101</sup> Megjithëse Kodi Zgjedhor dhe kalendari i KSHZ-së e caktojnë afatin prej 10 ditësh para ditës së zgjedhjeve si datë të fundit për parashtrimin e kërkesave për akreditim, Kodi i Sjelljes së KSHZ-së për zgjedhjet lokale të vitit 2021 parashihnin 5 ditë para ditës së zgjedhjeve.

<sup>102</sup> Grupi më i madh i vëzhguesve qytetarë u shpërnda nga AKSIOS 2017 Shkup, me 512 vëzhgues të akredituar në rrethin e parë, siç njoftoi KSHZ-ja gjatë mbledhjeve të saj. Megjithatë, të dhënat e publikuara nga KSHZ-ja tregonin se kishte 529 vëzhgues. 221 vëzhgues të tjerë u akredituan për rrethin e dytë.

vëzhgues të lëshuara nga KSHZ-ja nuk i përmbanin të dhënat e kërkuara personale për identifikim. Për më tepër, nuk kërkohet tregues se kë e përfaqësojnë për akreditimin e vëzhguesve ose për distinktivët e përfaqësuesve të garuesve. Përkundër apeleve të vazhdueshme të KSHZ-së pas rrethit të parë drejtuar të gjithë zyrtarëve zgjedhorë që të respektojnë obligimin e tyre ligjor për ta lehtësuar qasjen për të gjithë personat e akredituar në të gjitha fazat e procesit zgjedhor dhe për t'u mundësuar mediave të kryejnë punën e tyre brenda vendvotimeve, vazhduan pengesat për disa vëzhgues dhe gazetarë në disa vendvotime.<sup>103</sup>

*Organet e administratës zgjedhore në të gjitha nivelet duhet të sigurojnë qasje të papenguar për të gjithë vëzhguesit e akredituar në të gjithë procesin zgjedhor. Për ta rritur transparencën, administrata zgjedhore duhet të mbajë shënime për të gjithë vëzhguesit dhe përfaqësuesit e garuesve që janë të akredituar për të vëzhguar, t'i bëjë ato të disponueshme për publikun në kohë dhe t'u sigurojë të akredituarve identifikimin e duhur, duke i shënuar qartë emrat e tyre dhe kë e përfaqësojnë.*

### XIII. DITËT E ZGJEDHJEVE

#### A. RRETHI I PARË

Dita e zgjedhjeve e rrethit të parë më 17 tetor ishte në përgjithësi paqësore, me një pjesëmarrje prej 51.44 për qind të votuesve, të shpallur nga KSHZ-ja.<sup>104</sup> KSHZ-ja ndau informacione të përditësuara në lidhje me procesin e votimit gjatë gjithë ditës së zgjedhjeve dhe në natën e zgjedhjeve filloi t'i postojë në ueb-faqen e saj rezultatet e hollësishme paraprake të zgjedhjeve nga vendvotimet, gjë që e rriti transparencën. Kryetarët e 55 për qind të KZ-ve të vëzhguara nga vëzhguesit e MVZ-së të ODIHR-it ishin gra dhe në përgjithësi, 47 për qind e anëtarëve të KZ-ve në vendvotimet e vëzhguara ishin gra.

Hapja e vendvotimeve u vlerësua pozitivisht në 58 nga 64 vendvotimet ku u vëzhgua ky proces nga vëzhguesit e MVZ-së së ODIHR-it. Megjithatë, në 8 vendvotime ku u vëzhgua hapja, PIBV-të nuk ishin funksionale, dhe në 31 vendvotime KZ-ja kishte vështirësi me përdorimin e pajisjeve. Në përgjithësi, procedurat e hapjes u respektuan, megjithëse 10 KZ nuk demonstuan para të gjithë të pranishmëve se kutitë e votimit ishin të zbrazëta ose nuk i mbyllën ato siç duhet, ndërsa 5 KZ nuk e futën numrin serik të vulave në Ditarin e KZ-së. Në njëzet e shtatë vendvotime të vëzhguara pati kryesisht vonesa të vogla në hapjen e votimit.

Vëzhguesit e MVZ-së së ODIHR-it e vlerësuan votimin pozitivisht në 97 për qind të 625 vendvotimeve ku u vëzhgua ky proces, duke e karakterizuar procesin si transparent, të qetë dhe të organizuar mirë. Masat mbrojtëse për KOVID-19 në përgjithësi u respektuan, megjithëse distanca fizike nuk u mbajt vazhdimisht. Shumë vëzhgues të MVZ-së së ODIHR-it raportuan probleme me PIBV-të dhe në 14 për qind të vendvotimeve të vëzhguara procesi i votimit kishte vështirësi për shkak të këtyre problemeve. Në 4 për qind të vendvotimeve ku u vëzhgua votimi, PIBV-të nuk ishin funksionale, ndërsa në shumë vendvotime të tjera, pajisjet kishin probleme të ndryshme teknike. Një problem i përsëritur dhe i përhapur ishte dështimi i PIBV-ve për t'i përputhur gjurmët e gishtërinjve të votuesve me ato në Listën Zgjedhore. Në 75 për qind të vendvotimeve të vëzhguara, jo çdo votues në Listën Zgjedhore mund të identifikohet në mënyrë pozitive përmes skenimit të gjurmëve të gishtërinjve. Kjo duket se i preku veçanërisht votuesit e moshuar dhe votuesit në zonat rurale. Shumica e KZ-ve në vendvotimet e vëzhguara i trajtuan këto probleme në mënyrë profesionale. KSHZ-ja ia atribuoi këto probleme cilësisë së dobët të të dhënave të gjurmëve të gishtërinjve në bazën e të dhënave të ofruar nga Ministria e Punëve

<sup>103</sup> Pas rrethit të parë, KSHZ-ja mori njoftime të tilla nga CIVIL dhe nga Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë. [Ankesa](#) e KSHZ-së u publikua nga një sërë mediash. Në ditën e zgjedhjeve të rrethit të dytë, kryetari i KSHZ-së e përsëriti apelin në një konferencë për shtyp, si përgjigje ndaj një raportimi se gazetarët ishin penguar të hyjnë në një vendvotim.

<sup>104</sup> KSHZ-ja në natën e zgjedhjeve e shpalli pjesëmarrjen preliminare prej 48,99 për qind, deri në orën 18:30.

të Brendshme, duke theksuar se të paktën një e katërta e këtyre të dhënave ishin identifikuar nga KSHZ-ja si joadekuate. Pas asnjërës prej ditëve të zgjedhjeve, KSHZ-ja nuk publikoi ndonjë informacion zyrtar për të dhënat e mbledhura nga PIBV-të apo për numrin e votuesve që u shtuan në Listat Zgjedhore në ditën e zgjedhjeve.

*Për të rritur besueshmërinë dhe për të siguruar integritetin e sistemit të identifikimit biometrik të votuesve, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve duhet ta publikojë numrin e votuesve, gjurmët e gishtërinjve të të cilëve janë identifikuar nga pajisjet, sipas njësisë zgjedhore dhe vendvotimeve, si pjesë e shpalljes së rezultateve paraprake.*

KSHZ-ja njoftoi se kishte autorizuar shtatë KZ për të vazhduar votimin pa përdorur PIBV, dhe tërhoqi vërejtjen se aty ku KZ-të kishin kaluar në sistemin e mëparshëm pa autorizimin e KSHZ-së, votimi do të anulohet. Pas ditës së zgjedhjeve, KSHZ-ja pohoi se asnjë rast i tillë nuk ishte konfirmuar pas verifikimit të protokolleve të rezultateve. KSHZ-ja gjithashtu e zgjati votimin për 30 minuta dhe njoftoi se votuesve që ishin brenda objektit të vendvotimit në kohën e mbylljes do t'u lejohej të votonin. Në 11 vendvotime, votimi u zgjat për më shumë se një orë si rezultat i ndërprerjeve të stërzgjatura për shkak të problemeve teknike me PIBV-të.

*Për të rritur integritetin dhe besimin në procesin e votimit, autoritetet duhet të ndërmarrin përpjekje gjithëpërfshirëse për të përmirësuar cilësinë e bazave të të dhënave të përdorura për identifikimin e votuesve në ditën e zgjedhjeve dhe funksionalitetin e sistemit të identifikimit biometrik të votuesve.*

Përkundër problemeve me PIBV-të, në përgjithësi, procedurat e identifikimit të votuesve u respektuan në vendvotimet e vëzhguara. Në 14 për qind të vendvotimeve të vëzhguara, një ose më shumë votuesve iu mohua mundësia për të votuar, shumica sepse nuk ishin në gjendje të tregojnë letërnjoftim të vlefshëm ose nuk mund të gjendeshin në Listën Zgjedhore të atij vendvotimi. Procedurat e votimit u respektuan në përgjithësi, megjithëse vëzhguesit e MVZ-së së ODIHR-it vunë re se jo të gjithë votuesit i plotësuan fletëvotimet e tyre në fshehtësi (6 për qind e vendvotimeve të vëzhguara). Vëzhguesit e MVZ-së së ODIHR-it raportuan raste të përhapura të votimit në grup (8 për qind e vendvotimeve të vëzhguara), gjë që ndikon negativisht në pjesëmarrjen e grave. Në 3 për qind të vendvotimeve të vëzhguara, kutitë e votimit nuk ishin mbyllur siç duhet.

U vërejtën materiale të fushatës dhe aktivitete të fushatës në afërsi të 4 për qind të vendvotimeve të vëzhguara nga vëzhguesit e MVZ-së së ODIHR-it. Vëzhguesit e MVZ-së së ODIHR-it raportuan gjithashtu disa indikacione të izoluar të frikësimit të votuesve në dhe rreth vendvotimeve. Në 6 për qind të vendvotimeve të vëzhguara, persona të tjerë përveç anëtarëve të KZ-ve mbanin shënime se kush votonte, edhe pse kjo duket se bëhej kryesisht për ta ndjekur pjesëmarrjen e votuesve.

Vëzhguesit e MVZ-së së ODIHR-it raportuan se në 5 për qind të vendvotimeve të vëzhguara kishte numër tepër të madh të njerëzve. Në rreth 53 për qind të vendvotimeve personat me aftësi të kufizuara fizike nuk mund të hynin në mënyrë të pavarur, ndërsa në 26 për qind të vendvotimeve, organizimi i hapësirës nuk ishte i përshtatshëm për votuesit e tillë. Nëntë për qind e vendvotimeve të vëzhguara nuk kishin shabllon të Bregit për votim, për t'u përdorur nga votuesit me shikim të dëmtuar.

Përfaqësuesit e autorizuar të kandidatëve ishin të pranishëm në 89 për qind të vendvotimeve të vëzhguara: në 4 për qind, persona të ndryshëm nga anëtarët e KZ-ve, kryesisht përfaqësues të kandidatëve, ndërhyjnë ose e drejtonin procesin e votimit. Vëzhguesit qytetarë ishin të pranishëm vetëm në 10 për qind të vendvotimeve dhe nganjëherë dukej se, në fakt, ishin vëzhgues partiakë.

Numërimi i votave u vlerësua pozitivisht në 49 nga 61 vendvotimet ku u vëzhgua ky proces, por vëzhguesit e MVZ-së së ODIHR-it raportuan se shumë KZ nuk i ndoqën procedurat e përcaktuara. Përfaqësuesit e autorizuar të kandidatëve ishin të pranishëm në 48 numërimet të vëzhguara të votave



ndërsa vëzhguesit qytetarë ishin të praninë në vetëm 5 numërime. Vëzhguesit e MVZ-së së ODIHR-it raportuan dhjetë raste të ndërhyrjes së panevojshme në numërim, të gjitha nga përfaqësuesit e kandidatëve. Vëzhguesit e MVZ-së së ODIHR-it raportuan raste të shpeshta në të cilat KZ-të nuk i ndoqën procedurat themelore të barazimit para hapjes së kutive të votimit, ose kur nuk përputhej numri i nënshkrimeve të votuesve në Listën Zgjedhore, të dhënat për pjesëmarrjen nga PIBV-të dhe numri i fletëvotimeve të papërdorura. Vëzhguesit e MVZ-së së ODIHR-it raportuan nga 8 numërime se numrat nuk ishin futur me saktësi në protokollet e rezultateve. Persona të ndryshëm nga anëtarët e KZ-ve morën pjesë në 14 numërime, dhe në 9 vendvotime, anëtarët e KZ-ve e kishin nënshkruar paraprakisht protokollin e rezultateve. Tridhjetë e një KZ të vëzhguara kishin probleme me kompletimin e protokolleve të rezultateve, kryesisht për shkak të mosnjohjes së procedurave. Në 25 vendvotime, KZ-të nuk postuan kopje të protokolleve për t'i shfaqur publikisht.

Megjithëse vëzhguesit e MVZ-së të ODIHR-it vlerësuan se përcaktimi i vlefshmërisë së fletëvotimeve ishte në përgjithësi i arsyeshëm dhe konsekuent, një numër i konsiderueshëm e fletëvotimeve të pavlefshme u vunë re në të gjithë vendin.<sup>105</sup> Bashkëbiseduesit e MVZ-së së ODIHR ia atribuuan numrin e lartë të fletëvotimeve të pavlefshme arsyeve të ndryshme, disa duke vënë në dukje mosnjohjen e mjaftueshme të procedurës për shënimin e fletëvotimeve nga votuesit si rezultat i edukimit të dobët të votuesve, ndërsa të tjerët ia atribuuan atë pjesërisht prishjes së qëllimshme të fletëvotimeve si votim protestues kundër të gjithë garuesve. Kodi Zgjedhor parasheh se rrethimi i numrit rendor të garuesit në fletëvotim është mënyra e vetme e vlefshme për ta shënuar fletëvotimin, ndërsa në të njëjtë kohë thekson se fletëvotimi duhet të konsiderohet i vlefshëm nëse vullneti i votuesit mund të përcaktohet në mënyrë të qartë dhe të padyshimtë. Vëzhguesit e MVZ-së të ODIHR-it raportuan për disa raste kur fletëvotimet me qëllim të qartë të votuesit (një shenjë tjetër në vend të rrethit, ose rrethimi i diçkaje tjetër në vend të numrit rendor) u shpallën të pavlefshme. Kodi Zgjedhor nuk parashikon zëvendësimin e fletëvotimeve në rast se votuesit i prishin fletëvotimet e tyre pa dashje.

*Siç është rekomanduar më parë, duhet konsideruar mundësia e qartësimit të rregullave për ta ruajtur vlefshmërinë e fletëvotimeve në të cilat vullneti i votuesit është shprehur qartë. Po ashtu duhet konsideruar mundësia që të lejohet zëvendësimi i fletëvotimeve të prishura rastësisht.*

Procesi i nxjerrjes së rezultateve u vlerësua negativisht në 13 nga 57 raportet e dorëzuara nga vëzhguesit e MVZ-së së ODIHR-it, nga gjithsej 53 KZK. Në rreth gjysmën e KZK-ve të vëzhguara, kushtet nuk ishin të përshtatshme për dorëzimin e materialeve zgjedhore dhe për nxjerrjen e rezultateve (32 raporte). Në shumë KZK procesi u ndikua negativisht nga organizimi i dobët (16 raporte), hapësira e pamjaftueshme (22 raporte), dhe numri tepër i madh i njerëzve (26 raporte). Respektimi i masave parandaluese për KOVID-19 ishte dukshëm më i ulët se sa gjatë votimit. Procedurat e nxjerrjes së rezultateve u ndoqën kryesisht, megjithëse lëshime ose shkelje procedurale u raportuan nga nëntë KZK. Në më shumë se tre të katërtat e vëzhgimeve të nxjerrjes së rezultateve, e gjet se protokollet e rezultateve të vendvotimeve përmbajnë mospërputhje të vogla. Vëzhguesit e MVZ-së së ODIHR-it raportuan një rast të ndërhyrjes në procesin e nxjerrjes së rezultateve, ndërsa kishte shtatë raporte për tensione ose trazira, në ose rreth KZK-së.

*Për të siguruar konsekuencë dhe transparencë në procesin e nxjerrjes së rezultateve, duhet të vendosen dhe të ndiqen procedura të qarta për korrigjimin e gabimeve dhe mospërputhjeve në protokollet e rezultateve, duke përfshirë edhe kritere për rinumërimin e fletëvotimeve. Të gjitha të dhënat relevante të mbledhura gjatë ditës së zgjedhjeve, duke përfshirë edhe numrin e votuesve të shtuar në Listat zgjedhore, duhet të publikohen në kohë nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve.*

<sup>105</sup> Në rrethin e parë të zgjedhjeve për kryetar komune, gjithsej 5.2 për qind e fletëvotimeve të hedhura u vlerësuan të pavlefshme. Përqindjet më të larta u shënuan në komunat Shuto Orizare me gati 9,9 për qind, Jegunovcë me 8,3 për qind dhe Butel me 7,2 për qind.

## B. SHPALLJA E REZULTATEVE PËRFUNDIMTARE TË RRETHIT TË PARË

Rezultatet përfundimtare të rrethit të parë të zgjedhjeve lokale të 17 tetorit u konfirmuan dhe u shpallën nga KSHZ-ja më 23 dhe 26 tetor.<sup>106</sup> Pas shpalljes nga KSHZ-ja, KZK-të dhe KZQSh-ja duhet t'i shpallin rezultatet përfundimtare të detajuara në nivel të komunave ose Qytetit të Shkupit në afat prej 24 orëve. Në rrethin e parë u zgjodhën tridhjetë e katër kryetarë të komunave.<sup>107</sup> Në komunat e Qendrës së Zhupës dhe të Mavrovës dhe Rostushës, nuk u përmbush kërkesa ligjore që një e treta e votuesve të regjistruar të dalin në zgjedhje, në mënyrë që zgjedhjet për kryetar komune të jenë të vlefshme; zgjedhjet për kryetar komune në këto dy komuna do të përsëriten më 17 prill të vitit 2022.

Në përputhje me ligjin, KSHZ-ja e caktoi rrethin e dytë të zgjedhjeve për kryetar të komunave për më 31 tetor në qytetin e Shkupit dhe në 43 komuna.<sup>108</sup> Nga 88 kandidatët për kryetar komune që garuan në rrethin e dytë, 6 ishin të pavarur. Nga 25 femra candidate për kryetare komune, asnjëra nuk u zgjodh në rrethin e parë dhe vetëm 6 kaluan në rrethin e dytë. Në komunën e Dibrës, zgjedhjet për kryetar komune u përsëritën më 31 tetor në një vendvotim, në të cilin ishte anuluar rrethi i parë.

## C. RRETHI I DYTË

Në përputhje me metodologjinë e ODIHR-it, në mungesë të vëzhguesve afatshkurtër për rrethin e dytë, MVZ-ja e ODIHR-it nuk i vëzhgoi procedurat e ditës së zgjedhjeve më 31 tetor në mënyrë sistematike ose gjithëpërfshirëse, por anëtarët e misionit vizituan një numër të kufizuar vendvotimesh në Qytetin e Shkupit dhe në 17 komuna. Në numrin e kufizuar të vendvotimeve të vizituara, procesi i votimit në përgjithësi u vlerësua se ishte i organizuar mirë, transparent dhe i qetë. Procedurat e përcaktuara u respektuan në masë të madhe, por në disa raste të pakta, fshehtësia e votës nuk u respektua plotësisht. Vazhduan disa probleme të vëzhguara në rrethin e parë në vendvotimet e vizituara, duke përfshirë rastet e shpeshta kur pajisjet biometrike të identifikimit nuk arritën të bëjnë skanimin e suksesshëm të gjurmëve të gishtave të votuesve. Sipas KSHZ-së, votimi është zgjatur për më shumë se një orë në 12 vendvotime për shkak të pezullimit të procesit të votimit si rezultat i mosfunksionimit të PIBV-ve. Janë vërejtur disa raste të shkeljes së heshtjes zgjedhore. Masat mbrojtëse kundër KOVID-19 ishin vendosur, por distanca fizike nuk respektohej gjithmonë dhe pajisjet mbrojtëse personale nuk përdorshin vazhdimisht. Numërimet e pakta të votave që u vëzhguan ishin kryesisht transparente, por respektimi i procedurave të përcaktuara ndryshonte ndjeshëm ndërmjet vendvotimeve të vizituara, dhe disa KZ kishin probleme me plotësimin e protokollit të rezultateve.

KSHZ-ja njoftoi se pjesëmarrja e votuesve ishte 49,65 për qind.<sup>109</sup> Ashtu si në rrethin e parë, KSHZ-ja ndau informacione të përditësuara në lidhje me procesin e votimit gjatë gjithë ditës së zgjedhjeve dhe filloi t'i postojë rezultatet preliminare sipas vendvotimeve në ueb-faqen e saj menjëherë pas mbylljes së votimit, gjë që e rriti transparencën.

KSHZ-ja dhe Ministria e Punëve të Brendshme raportuan për incidente të izoluara gjatë ditës së zgjedhjeve të rrethit të dytë.<sup>110</sup> Prokurorisë Publike e Shtetit njoftoi se kishte pranuar disa denoncime për sjellje të mundshme kriminale gjatë ditës së zgjedhjeve, më së shumti në lidhje me blerjen e

<sup>106</sup> KSHZ-ja e shpalli shumicën e rezultateve më 23 tetor; rezultatet e katër zgjedhjeve për kryetar komune dhe shtatë zgjedhjeve për Këshillat komunalë u shpallën pas skadimit të afateve përkatëse për shqyrtim të kontesteve.

<sup>107</sup> Prej tyre, 22 ishin kandidatë të VMRO-DPMNE-së, 9 të LSDM-së dhe 3 të BDI-së. Ndër komunat më të mëdha, vetëm Prilepi, Shtipi, Velesi dhe komunat e Gazi Babës dhe Aerodromit në Shkup i zgjodhën kryetarët e tyre në rrethin e parë.

<sup>108</sup> Në Shuto Orizare, rrethi i dytë i zgjedhjeve për kryetar komune u mbajt më 31 tetor, dhe në një vendvotim ku rrethi i parë i votimit u shpall i pavlefshëm, votuesit votuan edhe për Këshillin e komunës dhe për Këshillin e Qytetit të Shkupit.

<sup>109</sup> KSHZ-ja në natën e zgjedhjeve e shpalli pjesëmarrjen preliminare prej 48,61 për qind, deri në orën 18:30.

<sup>110</sup> Në ditën e zgjedhjeve të rrethit të dytë, MPB-ja njoftoi se e kishte shtuar praninë e policisë pas disa raportimeve për pengimin e procesit zgjedhor.

supozuar të votave dhe presionin ndaj votuesve, si dhe kërcënimet drejtuar vëzhguesve qytetarë në mediat sociale, me ç'rast për të gjitha rastet është urdhëruar të bëhet hetim penal. KSHZ-ja dhe Zyra e Avokatit të Popullit kishin në funksion linja të posaçme telefonike ku votuesit mund të raportnin shkeljet dhe pengesat e mundshme të të drejtave të tyre të votimit.

#### **D. ZHVILLIMET PAS ZGJEDHJEVE**

Rezultatet përfundimtare të balotazheve dhe të rretheve të para të përsëritura u konfirmuan dhe u shpallën në mënyrë progresive nga KSHZ-ja gjatë mbledhjeve të mbajtura më 3, 4 dhe 9 nëntor. Ashtu si edhe pas rrethit të parë, KZK-të dhe KZQSH-ja kishin 24 orë nga shpallja e rezultateve nga KSHZ-ja për t'i shpallur rezultatet përfundimtare të detajuara në nivel të komunave ose Qytetit të Shkupit. Rrethi i dytë për zgjedhjet për kryetar komune në komunën e Dibrës, ku përsëritja e rrethit të parë në një vendvotim nuk rezultoi me zgjedhjen e kryetarit të ri, ishte caktuar për më 14 nëntor. Rezultatet përfundimtare për zgjedhjet për kryetar të komunës së Dibrës, KSHZ-ja i shpalli më 24 nëntor.

Pas shpalljes së rezultateve paraprake të rrethit të dytë, në një konferencë për shtyp në natën e zgjedhjeve, Zoran Zaevi njoftoi dorëheqjen e tij si kryeministër dhe kryetar i LSDM-së. Më 4 nëntor, udhëheqja e VMRO-DPMNE-së bëri thirrje për zgjedhje të parakohshme parlamentare dhe për formimin e shumicës së re parlamentare dhe një qeverie të re, duke deklaruar se autoritetet aktuale ishin delegjitimuar nga rezultati i zgjedhjeve lokale. Nga ana tjetër, shumica e partive në koalicionin qeverisës e përforcuan stabilitetin e saj dhe e kundërshtuan mundësinë për zgjedhje të parakohshme, duke përmendur samitin e BE-së në dhjetor dhe nevojën për vazhdimësi duke pasur parasysh fillimin e mundshëm të bisedimeve për anëtarësim. Më 10 nëntor, z. Zaev tha se do të qëndrojë si kryeministër dhe kryetar partie derisa të stabilizohet situata politike.<sup>111</sup> Votimi i mosbesimit ndaj qeverisë, i parashtruar nga VMRO-DPMNE-ja, nuk u hodh në votim nga parlamenti më 11 nëntor siç ishte planifikuar, për shkak të mungesës së kuorumit.

---

<sup>111</sup> Më 10 nëntor, z. Zaev [deklaroi](#) se do të qëndrojë në funksionet e tij “për të ndihmuar në stabilizimin e shumicës parlamentare dhe mundësisht për rritjen e saj” (linku në maqedonisht). Më 12 dhjetor, Zëvendësministri i Financave, Dimitar Kovačevski, me votën e anëtarëve u zgjodh për kryetar të ri të LSDM-së dhe u bë kryeministër më 16 janar të vitit 2022.

#### XIV. REKOMANDIME

Këto rekomandime ashtu siç janë paraqitur përgjatë gjithë raportit, ofrohen me qëllim që të përmirësohet zhvillimi i zgjedhjeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe që të mbështeten përpjekjet për t'i sjellë ato në përputhje të plotë me përkushtimet e OSBE-së dhe obligimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike. Këto rekomandime duhen lexuar së bashku me rekomandimet e mëparshme të ODIHR-it, të cilat mbeten për t'u trajtuar.<sup>112</sup> OSBE/ODIHR-i është i gatshëm që t'u ndihmojë autoriteteve të Maqedonisë së Veriut të ta përmirësuar edhe më shumë procesin zgjedhor dhe për t'i trajtuar rekomandimet që gjenden në këtë raport dhe në raportet e mëparshme.

##### A. REKOMANDIMET PRIORITARE

1. Korniza ligjore duhet të rishikohet në mënyrë gjithëpërfshirëse për t'i trajtuar të gjitha rekomandimet e patrajuara të ODIHR-it dhe për të eliminuar zbrazëtitat dhe mospërputhjet e shumta ekzistuese. Kuvendi duhet ta bëjë këtë rishikim shumë përpara zgjedhjeve të ardhshme, pas një procesi konsultimi të hapur dhe gjithëpërfshirës, në të cilin propozimet nga të gjitha palët e interesuara do të merren parasysh me seriozitet.
2. Duhet të bëhen përpjekje të vazhdueshme energjike nga autoritetet për t'iu kundërvënë çdo formë të presionit mbi votuesit dhe mbi punonjësit e sektorit publik dhe privat, duke përfshirë edhe blerjen e votave. Në përputhje me legjislacionin ekzistues, raportet për presion dhe blerje të votave duhet të hetohen plotësisht dhe të ndiqen penalisht, duke i mbrojtur ata që kanë raportuar. Institucionet publike duhet të jenë proaktive në informimin e nëpunësve publikë dhe shtetërorë për mekanizmat e pavarur ku mund të raportojnë presionet në lidhje me zgjedhjet, dhe zyrtarët e lartë shtetëror duhet të japin deklaratatë qarta publike dhe udhëzime me shkrim se veprimet e tilla nuk do të tolerohen dhe se asnjë qytetar nuk duhet të frikësohet se mund të ketë ndonjë pasojë negative si rezultat i mbështetjes ose mosmbështetjes së ndonjë kandidati apo partie.
3. Për të garantuar pavarësinë operative dhe efikasitetin e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, autoritetet duhet të garantojnë që ai të marrë një shumë adekuate dhe në kohë nga buxheti. Kapacitetet e personelit të Komisionit duhet të përputhen me përgjegjësitë që i janë dhënë Komisionit sipas Kodit Zgjedhor, me ç'rast personeli thelbësor duhet të jetë i punësuar në mënyrë të përhershme.

<sup>112</sup> Sipas paragrafit 25 të [Dokumentit të Stambollit të OSBE-së të vitit 1999](#), vendet pjesëmarrëse të OSBE-së u angazhuan "t'i ndjekin menjëherë vlerësimet dhe rekomandimet e ODIHR-it për zgjedhjet". Ndjekja e rekomandimeve të mëparshme nga ODIHR-i është vlerësuar si më poshtë: Rekomandimet 14 dhe 19 nga raporti përfundimtar për zgjedhjet lokale të vitit 2017 janë zbatuar plotësisht. Rekomandimet 11, 13 dhe 21 nga raporti përfundimtar për zgjedhjet lokale të vitit 2017 janë zbatuar kryesisht. Rekomandimet 3, 4, 5, 12, 15, 17, 18, 22, 23, 24, 25, 28, 29, 30, 31 dhe 32 nga raporti përfundimtar për zgjedhjet lokale të vitit 2017 janë zbatuar pjesërisht. Rekomandimi 9 nga raporti përfundimtar për referendumin e vitit 2018 është zbatuar plotësisht. Asnjë rekomandim nga raporti përfundimtar për referendumin e vitit 2018 nuk është zbatuar kryesisht. Rekomandimet 3, 6, 10, 11 dhe 17 nga raporti përfundimtar për referendumin e vitit 2018 janë zbatuar pjesërisht. Rekomandimi 22 nga raporti përfundimtar për zgjedhjet presidenciale të vitit 2019 është zbatuar plotësisht. Asnjë rekomandim nga raporti përfundimtar për zgjedhjet presidenciale të vitit 2019 nuk është zbatuar kryesisht. Rekomandimet 3, 4, 5, 6, 8, 10, 12, 13, 14, 15, 18, 21, 24 dhe 27 nga raporti përfundimtar për zgjedhjet presidenciale të vitit 2019 janë zbatuar pjesërisht. Rekomandimi 23 nga Raporti përfundimtar për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2020 është zbatuar plotësisht. Rekomandimi 2 nga raporti përfundimtar për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2020 është zbatuar plotësisht. Rekomandimet 11, 12, 17 dhe 28 nga raporti përfundimtar për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2020 janë zbatuar pjesërisht. Shih gjithashtu [bazën e të dhënave të rekomandimeve zgjedhore të ODIHR-it](#).

4. Siç është rekomanduar më parë, korniza ligjore duhet të harmonizohet me standardet ndërkombëtare, duke i hequr të gjitha kufizimet mbi të drejtat zgjedhore në bazë të paaftësisë intelektuale ose psiko-sociale.
5. Saktësia e regjistrimit të votuesve duhet të përforcohet nëpërmjet përditësimeve sistematike dhe elektronike të të dhënave, veçanërisht të dhënat për vdekjet dhe ndryshimet e emrave, dhe duke zbatuar një sistem të koordinuar mbarëkombëtar për standardizimin e adresave.
6. Për të rritur transparencën, Kodi Zgjedhor duhet të kërkojë zbulimin e plotë të të gjitha llojeve të të ardhurave, si dhe të shpenzimeve të fushatës nga garuesit, disa ditë përpara ditës së zgjedhjeve. Raportet e financimit të fushatës duhet të përfshijnë një ndarje të shpenzimeve sipas njësive zgjedhore dhe afati për dorëzimin e raporteve përfundimtare duhet të shkurtrohet për të qenë në përputhje me praktikën e mira ndërkombëtare. Në përputhje me një rekomandim paraprak, mund të krijohet një mekanizëm për dorëzimin elektronik të raporteve financiare.
7. Dispozitat që i rregullojnë lajmet e transmetuesit publik gjatë periudhës së fushatës duhet të rishikohen, me qëllim që të sigurohet liria redaktuese dhe të sigurohet qasje dhe mbulim i barabartë i lajmeve për partitë më të vogla dhe kandidatët e pavarur. Reformat e mëtejshme të duhet të synojnë forcimin e cilësisë së përmbajtjes së prodhuar nga transmetuesi publik, duke përfshirë gazetarinë hulumtuese dhe atë analitike.
8. Rregulloret për reklamat e paguara politike në media duhet të rishikohen, në mënyrë që të lejohet qasja e papenguar në media në bazë të kriterëve të arsyeshme dhe objektive. Duhet të krijohet një mekanizëm i qartë për ndarjen e buxhetit ndërmjet partive më të vogla dhe kandidatëve të pavarur. Vendimi zyrtar për ndarjen e buxhetit për reklamat e fushatës në media duhet të publikohet me kohë.
9. Baza ligjore për parashtrimin e kundërshtimeve duhet të zgjerohet që t'i përfshijë edhe votuesit dhe vëzhguesit qytetarë. Për të lejuar kohën e duhur për parashtrimin dhe trajtimin e kundërshtimeve, afatet mund të harmonizohen me praktikën e mira ndërkombëtare.

## **B. REKOMANDIME TË TJERA**

### **Korniza ligjore dhe sistemi zgjedhor**

10. Ligji duhet të përcaktojë një afat kohor të qartë për mbajtjen e zgjedhjeve të përsëritura në rastet kur kërkesa për pjesëmarrje nuk plotësohet në rrethin e parë të zgjedhjeve për kryetar komune. Për të zvogëluar rrezikun e zgjedhjeve të dështuara, kërkesa për pjesëmarrjen e votuesve për zgjedhjet e përsëritura mund të rishqyrtohet.

### **Administrimi i zgjedhjeve**

11. Për të rritur transparencën dhe besimin e publikut në punën e tyre, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve dhe Komisionet Zgjedhore Komunale duhet ta publikojnë të gjithë dokumentacionin përkatës, si për shembull buxheti, plani i furnizimit, si dhe të gjitha rregulloret dhe vendimet në mënyrë konsekuente dhe në kohë.
12. Autoritetet duhet të sigurojnë mbështetje adekuate dhe në kohë, financiare dhe operative, për Komisionet Zgjedhore Komunale shumë përpara ditës së zgjedhjeve. Komunikimi dhe udhëzimet nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve për organet zgjedhore të niveleve më të ulëta duhet të jenë të plota dhe në kohë, në mënyrë që të sigurohet koordinimi i duhur dhe zbatimi i unifikuar i procedurave.

13. Siç është rekomanduar më parë, baza e të dhënave e nëpunësve shtetërorë dhe publikë që përdoret për përzgjedhjen e zyrtarëve zgjedhorë duhet të përditësohet, në mënyrë që të sigurohet një proces pa pengesa dhe efikas i përzgjedhjes. Mund të rishikohet grupi i institucioneve nga të cilat angazhohen nëpunësit për të shërbyer në organet zgjedhore.
14. Në një përpjekje të koordinuar, autoritetet shtetërore dhe lokale si dhe aktorët e tjerë të përfshirë në procesin zgjedhor duhet të ndërmarrin masa të mëtejshme për të siguruar qasje të pavarur të personave me lloje të ndryshme të aftësisë së kufizuar në të gjithë procesin zgjedhor.

### **Regjistrimi i votuesve**

15. Korniza rregullatore për procedurat e regjistrimit të votuesve duhet të konsolidohet dhe harmonizohet për t'i eliminuar mospërputhjet.
16. Autoritetet duhet t'i marrin masat e duhura të nevojshme për të siguruar që të gjithë votuesit me të drejtë vote të përfshihen në regjistrin e votuesve dhe në Listat zgjedhore. Kodi Zgjedhor duhet të ndryshohet në mënyrë përkatëse, duke përfshirë heqjen e kufizimeve të bazuara në dokumentet e identifikimit me afat të skaduar dhe duke i sqaruar procedurat për përfshirjen në Listat zgjedhore të personave që mbushin 18 vjet ndërmjet rrethëve zgjedhore.
17. Për të siguruar qasje kuptimplote dhe transparencë të regjistrimit të votuesve dhe të Listave Zgjedhore, KSHZ-ja duhet t'i publikojë të dhënat e regjistrimit të votuesve të ndara sipas vendvotimeve, në mënyrë periodike dhe para dhe pas çdo zgjedhjeje, duke e kufizuar llojin e të dhënave personale të votuesve që janë në dispozicion publik dhe të prezantojë masa mbrojtëse teknike për të parandaluar përpunimin e tyre të paautorizuar.
18. Për të garantuar integritetin dhe besimin e publikut në procesin zgjedhor, përdorimi i teknologjive të reja, duke përfshirë edhe pajisjet e identifikimit biometrik, duhet të futet pas një kohe të mjaftueshme dhe me dispozita të detajuara për të siguruar testimin e duhur dhe që të gjithë palët e interesuara të njihen me mënyrën e funksionimit të pajisjeve të tilla.

### **Regjistrimi i kandidatëve**

19. Për të siguruar mundësi të barabarta në të drejtën për t'u kandiduar për të gjithë kandidatët, numri i kërkuar i nënshkrimeve mbështetëse për kandidatët e pavarur duhet të jetë proporcional me numrin aktual të votuesve të regjistruar për njësi zgjedhore. Duhet konsideruar mundësia për standardizimin e tyre deri në një për qind të votuesve të regjistruar, në përputhje me praktikën e mirë ndërkombëtare.
20. Korniza ligjore duhet të ndryshohet për të ofruar mundësi që kandidatët e pavarur për këshilltarë të konkurrojnë individualisht në zgjedhje.

### **Fushata**

21. Në përputhje me parimin e barazisë së mundësive, rregullat e fushatës duhet të rishikohen për të siguruar qasje më të barabartë në media dhe ndarje të hapësirave për posterë dhe bilborde për partitë e vogla dhe kandidatët e pavarur.
22. Partitë politike dhe institucionet përkatëse shtetërore dhe publike duhet të ndërmarrin hapa të mëtejshëm për të inkurajuar pjesëmarrjen e grave në procesin zgjedhor dhe në vendimmarrjen politike.

23. Korniza ligjore për zhvillimin e fushatës duhet të ndryshohet më tej për të përfshirë rregulla të qarta për pjesëmarrjen e zyrtarëve publikë, duke përfshirë edhe në rrjetet sociale.

### **Financimi i fushatës**

24. Korniza ligjore për financimin e fushatës duhet të rishikohet për të trajtuar zbrazëtitat ekzistuese, duke përfshirë edhe ato në lidhje me shumën e kredive bankare dhe mundësinë për donacione pas zgjedhjeve, si dhe financimin nga palët e treta. Për të parandaluar ndikimin e panevojshëm të donatorëve privatë dhe korrupsionin e mundshëm politik, kufijtë e donacioneve dhe shpenzimeve për zgjedhjet lokale mund të përafrohen në mënyrë që fondi i fushatës së një garuesi të mos mbushet nga një donacion i vetëm.
25. Agjencitë përgjegjëse për mbikëqyrjen e financimit të fushatës duhet të kryejnë një shqyrtim efektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve të fushatës gjatë gjithë procesit zgjedhor dhe duhet t'i marrin parasysh siç duhet dhe në kohë të gjitha raportet dhe ankesat në lidhje me parregullsitë e supozuara.

### **Mediat**

26. Transmetuesit kombëtarë duhet të përpiqen t'i bëjnë programet e tyre të qasshme për personat me dëmtime shqisore. Duhet konsideruar mundësia për ndryshimin e Kodit Zgjedhor për të dhënë udhëzime më të qarta dhe më specifike për sa i përket transmetimit të informacionit të qasshëm për elektoratin.
27. Kërkesa ligjore për raportimin ditor nga organi rregullator i medias tek administrata zgjedhore mund të zëvendësohet me raporte *ad hoc* që trajtojnë shqetësime specifike të lidhura me zgjedhjet.

### **Kundërshtimet dhe ankesat**

28. Për të siguruar mjet efektiv ligjor, ligji duhet të parashikojë shqyrtim gjyqësor në kohë të të gjitha vendimeve administrative që kanë të bëjnë me zgjedhjet, duke i përfshirë të gjitha rregulloret e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve.
29. Rregullat për pranueshmërinë e kundërshtimeve duhet të përcaktojnë kërkesa të arsyeshme dhe diapazoni i provave të pranueshme nuk duhet të kufizohet në mënyrë të panevojshme. Vendimet e administratës zgjedhore duhet të jenë të arsyetuara, duke siguruar shqyrtimin efektiv të bazueshmërisë së të gjitha kundërshtimeve.
30. Për të rritur transparencën dhe për të siguruar një proces të rregullt, e drejta për një seancë publike ku do të përfshihen të dyja palët duhet të mbrohet si në gjykata ashtu edhe në komisionet zgjedhore.
31. Duhet konsideruar mundësia për forcimin e kapaciteteve të Komisioneve Zgjedhore Komunale dhe procedurave përkatëse për trajtimin e kundërshtimeve. Sistemi elektronik për parashtrimin dhe ndjekjen e kundërshtimeve mund të përmirësohet për të ofruar përditësime në kohë në lidhje me kundërshtimet e parashtruara dhe për të rritur transparencën.

## Vëzhguesit qytetarë dhe ndërkombëtarë

32. Organet e administratës zgjedhore në të gjitha nivelet duhet të sigurojnë qasje të papenguar për të gjithë vëzhguesit e akredituar në të gjithë procesin zgjedhor. Për ta rritur transparencën, administrata zgjedhore duhet të mbajë shënime për të gjithë vëzhguesit dhe përfaqësuesit e garuesve që janë të akredituar për të vëzhguar, t'i bëjë ato të disponueshme për publikun në kohë dhe t'u sigurojë të akredituarve identifikimin e duhur, duke i shënuar qartë emrat e tyre dhe kë e përfaqësojnë.

## Dita e zgjedhjeve

33. Për të rritur integritetin dhe besimin në procesin e votimit, autoritetet duhet të ndërmarrin përpjekje gjithëpërfshirëse për të përmirësuar cilësinë e bazave të të dhënave të përdorura për identifikimin e votuesve në ditën e zgjedhjeve dhe funksionalitetin e sistemit të identifikimit biometrik të votuesve.
34. Për të rritur besueshmërinë dhe për të siguruar integritetin e sistemit të identifikimit biometrik të votuesve, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve duhet ta publikojë numrin e votuesve, të cilët janë identifikuar nga pajisjet, sipas njësive zgjedhore dhe vendvotimeve, si pjesë e shpalljes së rezultateve paraprake.
35. Siç është rekomanduar më parë, duhet konsideruar mundësia e qartësimit të rregullave për ta ruajtur vlefshmërinë e fletëvotimeve në të cilat vullneti i votuesit është shprehur qartë. Po ashtu duhet konsideruar mundësia që të lejohet zëvendësimi i fletëvotimeve të prishura rastësisht.
36. Për të siguruar konsekuencë dhe transparencë në procesin e nxjerrjes së rezultateve, duhet të vendosen procedura të qarta për korrigjimin e gabimeve dhe mospërputhjeve në protokollet e rezultateve, duke përfshirë edhe kritere për rinumërimin e fletëvotimeve. Të gjitha të dhënat relevante të mbledhura gjatë ditës së zgjedhjeve, duke përfshirë edhe numrin e votuesve të shtuar në Listat zgjedhore, duhet të publikohen në kohë nga KSHZ-ja.



## SHTOJCA I: REZULTATET E ZGJEDHJEVE

### RRETHI I PARË, 17 TETOR 2021

Të dhënat e përgjithshme të regjistrimit të votuesve	Numri
Votues të regjistruar në Listën zgjedhore	1.824.864
Votues të regjistruar në Listën zgjedhore për votim në vend	1.740.147
Votues të regjistruar në listën e votuesve që banojnë përkohësisht jashtë vendit	82.461
Votues të regjistruar për votim të hershëm	10.653
Votues të shtuar në Listat zgjedhore në ditën e zgjedhjeve	495

### ZGJEDHJET PËR KËSHILLAT KOMUNALË, 17 TETOR 2021<sup>113</sup>

Garuesi	Numri i përgjithshëm i votave të hedhura	Numri i këshillave komunalë me këshilltarë të zgjedhur	Këshilltarët	
			Numri i përgjithshëm	Këshilltaret femra
Opsioni Qytetar për Maqedoninë – GROM	2.689	1	2	1
Me Vendosmëri për Ndryshime – PLD/DOM	34.367	19	24	4
Bashkimi Demokratik për Integrim - BDI	130.003	31	167	60
Koalicioni “Të gjithë së bashku” – BDI/ASh/A	1.339	1	4	1
Aleanca për Shqiptarët dhe AlternAtivaA – ASH/A	65.605	24	80	23
VMRO-DPMNE dhe Koalicioni “Rindërtimi i Maqedonisë”	355.262	72	469	182
Partia Demokratike e Turqve në Maqedoni – PDTM	9.780	6	16	3
AlternAtivaA	370	1	1	-
Partia Demokratike e Shqiptarëve - PDSH	8.398	3	9	1
Koalicioni i udhëhequr nga LSDM-ja “Më e mira për komunën time”	233.443	78	396	171
Partia për Lëvizjen e Turqve në Maqedoni – PLT	1.591	2	2	-

<sup>113</sup> Duke përfshirë rezultatet e zgjedhjeve të përsëritura në dy vendvotime për këshillat komunalë të Dibrës dhe Shuto Orizares dhe për Këshillin e Qytetit të Shkupit, të mbajtura më 31 tetor.

Garuesi	Numri i përgjithshëm i votave të hedhura	Numri i këshillave komunalë me këshilltarë të zgjedhur	Këshilltarët	
			Numri i përgjithshëm	Këshilltaret femra
Levica (E Majta)	69.346	26	49	14
Lëvizja BESA	26.751	15	35	8
Maqedonia e Bashkuar	4.092	1	1	-
Lidhja e Romëve në Maqedoni – LRM	956	1	2	-
Bashkimi Demokratik Boshnjak - BDB	3.545	1	1	-
Lëvizja për Bashkim Kombëtar të Turqve – LBKT	1.422	1	2	-
ROM – Romeske	531	1	1	-
Bashkimi Radikal i Përhershëm Maqedonas – TMRO	3.317	2	3	1
Partia e Demokratëve të Bashkuar – PODEM	789	1	1	-
Forcat Demokratike të Romëve – FDR	865	1	1	-
Lëvizja për Demokraci, të Drejta dhe Liri – LDDL	436	1	1	-
Kandidatët e pavarur	65.908	34	67	21
<b>Të dhëna të përgjithshme</b>			<b>Numri</b>	<b>Për qind</b>
Numri i përgjithshëm i votave të hedhura <i>(duke përfshirë edhe për Këshillin e Qytetit të Shkupit)</i>			1.167.275	-
Gjithsej vota të pavlefshme			55.032	4,71

## ZGJEDHJET PËR KRYETARË TË KOMUNAVE, 17 TETOR 2021<sup>114</sup>

Komuna	Votues të regjistruar	Pjesëmarrja (%)	Koalicioni i LSDM-së		Koalicioni VMRO-DPMNE-së		BDI		Koalicioni i ASH/A		BESA		Të pavarur		Të tjera		Vota të pavlefshme	
			Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	Për qind	Gjithsej	Për qind
Aerodromi	66.905	51,14	8.973	26,22	18.857	55,11									4.974	14,54	1.413	4,13

<sup>114</sup> Duke përfshirë rezultatet e rrethit të parë të përsëritur të zgjedhjeve në një vendvotim në Dibër.

Raporti përfundimtar i Misionit të ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve

Komuna	Votues të regjistruar	Pjesëmarrja (%)	Koalicioni i LSDM-së		Koalicioni VMRO-DPMNE-së		BDI		Koalicioni i ASH/A		BESA		Të pavarur		Të tjera		Vota të pavlefshme	
			Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	Për qind	Gjithsej	Për qind
Haraçina	10.026	51,63	2.023	39,08			2.286	44,17	764	14,76							95	1,84
Berova	10.758	60,83	3.354	51,25	2.551	39,98								238	3,64		401	6,13
Manastir	80.882	56,64	17.926	39,23	19.571	42,83							1.082	2,37	4.454	9,75	2.659	5,82
Bogdanci	6.633	63,00	2.128	50,92	1.748	41,83							86	2,06			235	5,62
Bogovina	28.307	36,92					4.942	47,29	2.878	27,54	2.035	19,47			331	3,17	264	2,53
Bosillova	12.334	57,77	2.708	38,01	4.156	58,33											262	3,68
Bërvenica	15.732	43,97	1.051	15,19	2.052	29,67	1.065	15,40	876	12,66			1.319	19,07	320	4,63	234	3,38
Buteli	33.364	51,17	6.831	40,01	9.012	52,79											1.229	7,20
Komuna Qendër	43.951	51,04	9.026	40,24	7.462	33,27								4.689	20,90		1.254	5,59
Qendra e Zhupës	7.317	25,78	<i>Zgjedhjet janë shpallur të pavlefshme për shkak të pjesëmarrjes së pamjaftueshme të votuesve</i>															
Çairi	58.208	46,01					13.020	48,87	9.849	36,97	1.071	4,02			843	3,16	1.859	6,98
Çashka	6.171	69,37	1.688	39,43	1.088	25,41	1.436	33,54									76	1,78
Çeshinova - Oblesheva	5.390	67,66	1.386	38,00	1.511	41,43								625	17,14		125	3,43
Çuçer - Sandeva	7.936	58,59	1.929	41,48									2.485	53,44			236	5,08
Dibra*	19.211	42,11					3.747	46,32	4.021	49,70					35	0,43	287	3,55

<sup>115</sup> Gjithsej për tre kandidatë të pavarur që garuan, prej të cilëve Jovan Pejkovski kaloi në rrethin e dytë me 1.963 vota, përkatësisht 42,22 për qind.

Raporti përfundimtar i Misionit të ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve

Komuna	Votues të regjistruar	Pjesëmarrja (%)	Koalicioni i LSDM-së		Koalicioni VMRO-DPMNE-së		BDI		Koalicioni i ASH/A		BESA		Të pavarur		Të tjera		Vota të pavlefshme	
			Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	Për qind	Gjithsej	Për qind
Debarca	4.350	65,49	979	34,36	734	25,76							1.053	36,96			83	2,91
Dellçeva	14.757	58,30	4.389	51,14	3.635	42,35											559	6,51
Demir Hisari	6.965	73,71	2.432	47,37	2.409	46,92											293	5,71
Demir Kapija	3.250	77,26	1.219	48,59	1.194	47,59											98	3,91
Dojrani	2.677	74,41	1.060	53,21	802	40,26									51	2,56	79	3,97
Dollneni	11.840	60,53	1.521	21,22	1.347	18,79	2.047	28,56			198	2,76			1.822	25,42	232	3,24
Gazi Baba	61.413	48,68	8.804	29,45	17.910	59,91									1.118	3,74	2.020	6,76
Gjevgjelia	19.076	67,48	4.465	34,69	6.064	47,11							504	3,92	1.128	8,76	711	5,52
Gjorçe Petrovi	38.529	50,52	6.597	33,89	9.779	50,24									2.355	12,10	736	3,78
Gostivar	81.083	39,02					13.190	41,69	15.724	49,70	909	2,87			333	1,05	1.368	4,32
Gradsko	3.113	66,95	841	40,36	1.160	55,66											83	3,98
Ilindeni	14.312	63,58	1.815	19,95	4.861	53,42							2.081	20,87			346	3,80
Jegunovca	10.225	46,81	1.976	41,29	2.412	50,40											398	8,32
Karbinci	3.215	72,47	829	35,58	1.384	59,40											117	5,02
Karposhi	54.639	52,86	9.311	32,24	6.560	22,71									11.505	39,84	1.504	5,21

<sup>116</sup> Gjithsej për dy kandidatë të pavarur që garuan, prej të cilëve Zhika Stojanovski kaloi në rrethin e dytë me 1.821 vota, përkatësisht me 20,01 për qind.

<sup>117</sup> Gjithsej për dy kandidatë të pavarur që garuan, prej të cilëve kandidati i GROM-it kaloi në rrethin e dytë me 6.841 vota, përkatësisht me 23,69 për qind.

Raporti përfundimtar i Misionit të ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve

Komuna	Votues të regjistruar	Pjesëmarrja (%)	Koalicioni i LSDM-së		Koalicioni VMRO-DPMNE-së		BDI		Koalicioni i ASH/A		BESA		Të pavarur		Të tjera		Vota të pavlefshme	
			Votat e hedhura	Përqind	Votat e hedhura	Përqind	Votat e hedhura	Përqind	Votat e hedhura	Përqind	Votat e hedhura	Përqind	Votat e hedhura	Përqind	Votat e hedhura	Përqind	Gjithsej	Përqind
Kavadari	32.163	65,25	4.677	22,29	15.182	72,35											1.126	5,37
Kërçova	50.746	45,14			8.801	38,42	8.545	37,30					4.527	19,76	137	0,60	898	3,92
Kisella Voda	53.167	52,80	7.691	27,40	14.691	52,34									4.402	15,68	1.201	4,28
Koçani	32.972	50,15	8.028	48,55	7.425	44,90											1.082	6,54
Konçeja	2.769	74,65	968	46,83	859	41,56									172	8,32	67	3,24
Kratova	7.862	61,91	1.445	29,69	2.378	48,86							781	16,05			261	5,36
Kriva Pallanka	16.849	68,54	6.321	54,73	4.032	34,91									755	6,54	441	3,82
Krivogashtani	4.637	74,92	1.766	50,83	1.438	41,39									166	4,78	104	2,99
Krusheva	7.955	70,06	2.937	52,70	2.314	41,52											322	5,78
Kumanova	93.986	49,21	15.142	32,74	8.582	18,56			4.257	9,20			15.164	32,79			2.076	4,49
Likova	26.042	37,49					7.087	72,59	1.664	17,04	544	5,57			189	1,94	279	2,86
Llozova	1.984	78,23	695	44,78	428	27,58							268	17,27	87	5,60	74	4,77
Makedonska Kamenica	6.735	59,64	1.270	31,62	1.198	29,82							1.236	30,77			235	5,85
Makedonski Brodi	4.978	76,18	1.025	27,03	1.418	37,39							1.198	31,59			151	3,98
Mavrova dhe Rostusha	10.144	32,00	<i>Zgjedhjet janë shpallur të pavlefshme për shkak të pjesëmarrjes së pamjaftueshme të votuesve</i>															

Komuna	Votues të regjistruar	Pjesëmarrja (%)	Koalicioni i LSDM-së		Koalicioni VMRO-DPMNE-së		BDI		Koalicioni i ASH/A		BESA		Të pavarur		Të tjera		Vota të pavlefshme	
			Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	Për qind	Gjithsej	Për qind
Mogilla	5.195	71,01	1.358	36,81	2.113	57,28									72	1,95	146	3,96
Negotina	15.983	70,53	4.839	42,93	5.855	51,94											579	5,14
Novaci	2.868	74,37	943	44,21	1.094	51,29									30	1,41	66	3,09
Novo Sella	11.309	44,50	2.391	47,51	2.460	48,88											182	3,62
Ohri	52.477	56,54	12.460	42,00	14.380	48,47									1.376	4,64	1.412	4,76
Pehçeva	4.072	68,25	1.107	39,83	1.076	38,72							516	18,57			80	2,88
Petroveci	7.824	59,30	1.195	25,75	2.964	63,88									225	4,85	256	5,52
Pllasnica	5.122	34,65					1.359	76,56							366	20,62	48	2,70
Prilepi	63.436	63,80	14.655	36,21	22.196	54,84							1.071	2,65	901	2,23	1.649	4,07
Probishtipi	12.545	68,30	4.230	49,41	3.766	43,99											565	6,60
Radovishi	24.540	52,21	3.280	25,86	4.894	38,58							2.071	16,33	1.895	14,94	545	4,30
Rankovca	3.014	74,68	871	38,69	959	42,60							319	14,17	45	2,00	57	2,53
Resnja	16.378	52,17	3.533	41,35	3.342	39,11	800	9,36							402	4,70	468	5,48
Rosomani	3.343	75,68	1.148	45,38	947	37,43							313	12,37			122	4,82
Saraji	32.967	44,78					10.790	73,10	2.606	17,65	893	6,05			87	0,59	385	2,61
Shtipi	42.045	57,53	9.242	38,21	13.104	54,18									692	2,86	1.153	4,77

Komuna	Votues të regjistruar	Pjesëmarrja (%)	Koalicioni i LSDM-së		Koalicioni VMRO-DPMNE-së		BDI		Koalicioni i ASH/A		BESA		Të pavarur		Të tjera		Vota të pavlefshme		
			Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	Për qind	Gjithsej	Për qind	
Shuto Orizari*	24.230	36,52	3.280	37,07											4.663	119	53,15	878	9,92
Sopishteja	5.219	63,67	986	29,67	2.161	65,03												176	5,30
Staro Nagoričan	3.262	58,71	949	49,56	383	20,00									510	26,63		73	3,81
Struga	61.437	41,36	4.352	17,13			10.956	43,12	9.421	37,08	486	1,91			888	3,49		1.305	5,14
Strumica	49.800	51,46	13.760	53,70	10.291	40,16									346	1,35		1.228	4,79
Studenica	16.593	45,70					2.440	32,18	1.781	23,49					3.146	41,49		216	2,85
Sveti Nikole	14.567	62,95	2.964	32,32	4.766	51,97							987	10,76				453	4,94
Tearca	22.450	41,67					3.818	40,82	2.362	25,25	1.969	21,05			683	7,30		522	5,58
Tetova	85.577	44,81	2.373	6,19			11.138	29,04	6.165	16,08	10.496	27,37			6.207	16,19		1.971	5,14
Vallandova	9.992	65,92	3.798	57,73	2.455	37,32												326	4,96
Vasileva	10.688	59,23	3.035	47,94	3.090	48,81												206	3,25
Velesi	45.892	52,22	7.789	32,50	12.381	51,67									2.819	11,77		974	4,06
Vevçani	2.075	75,28	698	44,69	776	49,68												88	5,63
Vinica	17.244	52,64	3.592	39,56	4.970	54,74												519	5,72
Vrapçishti	26.383	36,15	267	2,80			3.298	34,58	3.946	41,38	309	3,24	115	1,21	1.354	14,19		248	2,60

<sup>119</sup> Gjithsej për dy kandidatë të pavarur që garuan, prej të cilëve kandidati i PLD/DOM-it kaloi në rrethin e dytë me 2.246 vota, përkatësisht me 25,38 për qind.

Komuna	Votues të regjistruar	Pjesëmarrja (%)	Koalicioni i LSDM-së		Koalicioni VMRO-DPMNE-së		BDI		Koalicioni i ASh/A		BESA		Të pavarur		Të tjera		Vota të pavlefshme	
			Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	Për qind	Gjithsej	Për qind
Zelenikova	3.738	61,29	1.015	44,30	1.040	45,40									154	6,72	82	3,58
Zhelina	24.485	37,62					4.296	46,63	785	8,52	3.877	42,09			119	1,29	135	1,47
Zërnovci	2.556	56,03	581	40,57	781	54,54											70	4,89
Qyteti i Shkupit	467.373	49,23	78.783	34,24									96.652	42,01	38.654	16,81	16.012	6,96
<b>Gjithsej</b>	<b>1.824.864</b>	<b>51,44</b>	<b>346.700</b>		<b>319.249</b>		<b>106.260</b>		<b>67.099</b>		<b>22.787</b>		<b>133.828</b>		<b>106.363</b>		<b>60.768</b>	<b>5,20</b>

<sup>120</sup> Gjithsej për dy kandidatë të pavarur që garuan, prej të cilëve Danella Arsovska kaloi në rrethin e dytë me 86.698 vota, përkatësisht me 37,68 për qind.

<sup>121</sup> Gjithsej për nëntë kandidatë të tjerë partiakë që garuan.



**RRETHI I DYTË, 31 TETOR 2021**

Të dhënat e përgjithshme të regjistrimit të votuesve	Numri
Votues të regjistruar në Listën zgjedhore që kishin të drejtë vote në rrethin e dytë	1.335.556
Votues të regjistruar për votim të hershëm	7.645
Votues të shtuar në Listat zgjedhore në ditën e zgjedhjeve	684

**ZGJEDHJET PËR KRYETARË TË KOMUNAVE, RRETHI I DYTË, 31 TETOR 2021<sup>122</sup>**

Komuna	Votues të regjistruar	Pjesëmarrja (%)	Koalicioni i LSDM-së		Koalicioni VMRO-DPMNE-së		BDI		Koalicioni i ASH/A		BESA		Të pavarur		Të tjera		Vota të pavlefshme	
			Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	Për qind			Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	
Haraçina	10.026	59,71	2.873	47,99			3.026	50,54									88	1,47
Manastir	80.882	60,21	21.978	45,13	24.708	50,73											2.016	4,14
Bogovina	28.307	35,93					6.336	62,30	3.696	36,34							138	1,36
Bërvenica	15.732	45,12			3.486	49,11							3.450	48,61			162	2,28
Komuna Qendër	43.951	52,55	11.982	51,88	10.016	43,99											954	4,13
Çairi	58.208	45,53					14.647	55,27	10.581	39,93							1.274	4,81
Çashka	6.171	67,25	2.327	56,07			1.734	41,78									89	2,14
Çeshinova - Oblesheva	5.390	71,15	1.693	44,15	2.030	52,93											112	2,92
Çuçer - Sandeva	7.936	64,83	2.610	50,73									2.407	46,78			128	2,49

<sup>122</sup>

Duke përfshirë rezultatet e rrethit të dytë në komunën e Dibrës, të mbajtur më 14 tetor.

Komuna	Votues të regjistruar	Pjesëmarrja (%)	Koalicioni i LSDM-së		Koalicioni VMRO-DPMNE-së		BDI		Koalicioni i ASh/A		BESA		Të pavarur		Të tjera		Vota të pavlefshme	
			Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	Për qind			Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	
Dibra*	19.211	44,95					4.291	49,69	4.153	48,09							192	2,22
Debarca	4.350	65,56	1.276	44,74									1.506	52,81			70	2,45
Demir Hisari	6.965	77,44	2.524	46,79	2.681	49,70											189	3,50
Demir Kapija	3.250	81,69	1.323	49,83	1.287	48,47											45	1,69
Dollneni	11.840	57,09	3.053	45,16			3.467	51,29									240	3,55
Gjevgjelia	19.076	69,54	5.130	38,67	7.546	56,88											590	4,45
Gostivar	81.083	39,92					12.982	40,11	18.685	57,73							698	2,16
Karposhi	54.639	54,84	13.420	44,79										14.864 (GROM)	49,61		1.678	5,60
Kërçova	50.746	48,11			10.828	44,35	12.935	52,98									651	2,67
Koçani	32.972	54,62	8.681	48,20	8.697	48,29											631	3,50
Konçeja	2.769	78,40	1.060	48,83	1.083	49,88											28	1,29
Kratova	7.862	65,34	1.869	36,38	3.078	59,92											190	3,70
Kumanova	93.986	49,23	19.468	42,07									25.587	55,30			1.218	2,63
Llozova	1.984	79,03	744	47,45	783	49,94											41	2,61
Makedonska Kamenica	6.735	64,87	1.865	42,69	2.228	51,00											276	6,32
Makedonski Brodi	4.978	78,06			1.903	48,97							1.876	48,28			107	2,75

Komuna	Votues të regjistruar	Pjesëmarrja (%)	Koalicioni i LSDM-së		Koalicioni VMRO-DPMNE-së		BDI		Koalicioni i ASH/A		BESA		Të pavarur		Të tjera		Vota të pavlefshme	
			Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	Për qind
Novo Sella	11.309	47,24	2.514	47,06	2.727	51,05											101	1,89
Ohri	52.477	59,31	13.186	42,37	16.993	54,60											941	3,02
Pehçeva	4.072	71,86	1.346	46,00	1.499	51,23											81	2,77
Probishtipi	12.545	74,76	4.649	49,57	4.338	46,25											392	4,18
Radovishi	24.540	51,78	4.792	37,71	7.466	58,76											448	3,53
Rankovca	3.014	78,87	1.104	46,45	1.225	51,54											48	2,02
Resnja	16.378	53,04	4.011	46,17	4.350	50,07											326	3,75
Rosomani	3.343	82,02	1.471	53,65	1.215	44,31											56	2,04
Shuto Orizari	24.230	33,47	3.509	43,27										4.170 (LDP/DOM)	51,42		426	5,25
Staro Nagoriçan	3.262	59,35	1.076	55,58										811 (TMRO)	41,89		49	2,53
Struga	61.437	43,02					13.763	52,07	11.711	44,31							956	3,62
Studenicani	16.593	49,91					4.060	49,02						4.119 (PDSH)	49,73		103	1,24
Tearca	22.450	37,38					4.687	55,86	3.557	42,39							147	1,75
Tetova	85.577	46,01					16.542	42,02			21.591	54,84					1.238	3,14
Vasileva	10.688	63,33	3.306	48,84	3.332	49,22											131	1,94
Vevçani	2.075	81,83	796	46,88	856	50,41											46	2,71

Komuna	Votues të regjistruar	Pjesëmarrja (%)	Koalicioni i LSDM-së		Koalicioni VMRO-DPMNE-së		BDI		Koalicioni i ASH/A		BESA		Të pavarur		Të tjera		Vota të pavlefshme	
			Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	Për qind			Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	Për qind	Votat e hedhura	
Vrapçishti	26.383	38,05					4.770	47,51	5.119	50,99							150	1,49
Zelenikova	3.738	67,90	1.177	46,38	1.308	51,54											53	2,09
Zhelina	24.485	42,27					5.102	49,29			5.171	49,96					78	0,75
Qyteti i Shkupit	467.373	46,49	90.662	41,72									118.792	54,67			7.843	3,61
<b>Gjithsej</b>	<b>1.335.556</b>	<b>49,65</b>	<b>146.813</b>		<b>125.663</b>		<b>108.342</b>		<b>57.502</b>		<b>26.762</b>		<b>153.618</b>		<b>23.964</b>		<b>25.418</b>	<b>2,89</b>

## SHTOJCA II: LISTA E VËZHguesVE NË MISIONIN PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE TË ODIHR-IT

### Vëzhguesit afatshkurtër të MVZ-së së ODIHR-it

Dhimiter	GJODEDE	Shqipëri
Andon	KUME	Shqipëri
Erion	META	Shqipëri
Elshan	ASGAROV	Azerbajxhan
Ramil	ISKANDARLI	Azerbajxhan
Ramin	NURALIYEV	Azerbajxhan
Abbas	PANAHOV	Azerbajxhan
Kilian	DE SAEGER	Belgjikë
Lore	HENS	Belgjikë
Bojan	DOKIC	Bosnja dhe Hercegovina
Milica	MITROVIĆ	Bosnja dhe Hercegovina
Dijana	TABORI DOROVIĆ	Bosnja dhe Hercegovina
Mubera	VULOVIĆ	Bosnja dhe Hercegovina
Gabriela	NIKOLOVA	Bullgari
Ivana	VEJIĆ	Kroaci
Martina	MATULÍKOVÁ	Republika Çeke
Petr	ŠMEJKAL	Republika Çeke
Lukáš	TESKA	Republika Çeke
Martin	TUŠL	Republika Çeke
Claus Thomas Michael	DETHLEFSEN	Danimarkë
Peter	HELLMERS	Danimarkë
Peder	LARSEN	Danimarkë
Kirsten	LIND	Danimarkë
Hanne	RODEN	Danimarkë
Hanne	SEVERINSEN	Danimarkë
Erik	THAU-KNUDSEN	Danimarkë
Christina Helena Gerda	JÜRGENSON	Estoni
Timothée	DEMEILLERS	Francë
Guillaume	JAVOUREZ	Francë
Marion	JOUANNET	Francë
Amandine Charlotte	MARQUES	Francë
Stephanie	MARSAL	Francë
Marine	MATHÉ	Francë
Mounir	ZAÏR	Francë
Klaus	AUER	Gjermani
Eva	CREYDT	Gjermani
Kai	FRANKE	Gjermani
Harald	HAENDEL	Gjermani
Caspar Johannes	HAMACHER	Gjermani
Nico	HEINEMANN	Gjermani
Henry	JUNG	Gjermani

Raporti përfundimtar i Misionit të ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve

---

Christian	KONRAD	Gjermani
Isabella	LAUBER	Gjermani
Karla	MARKERT	Gjermani
Lisa Helen	NASER	Gjermani
Ulrike	NEUNDORF	Gjermani
Reinhold	OSTERHUS	Gjermani
Rainer	OTTER	Gjermani
Cosima	PEISSKER-MEYER	Gjermani
Christine	RADOMSKY	Gjermani
Marielle Véronique	RATTER	Gjermani
Claudia	SCHÄFER	Gjermani
Ursula	SCHULZE- ABOUBACAR	Gjermani
Manuel	SEIFERT BONIFAZ	Gjermani
Stephani	STRELOKE	Gjermani
Peter	VOGL	Gjermani
Jürgen	WAYAND	Gjermani
Anna	FÜLÖP	Hungari
Viktoria	OLAH	Hungari
Balogh	ZOLTAN	Hungari
Nicolae	PANFIL	Moldavi
Corneliu	PASAT	Moldavi
Alexandru	SIMIONOV	Moldavi
Grigore	STEGARESCU	Moldavi
Ana	ĆUPIĆ	Mali i Zi
Milivoje	KRIVOKAPIC	Mali i Zi
Marija	LATKOVIC	Mali i Zi
Leonardus Wilhelmus	DEN BIGGELAAR	Holandë
Thomas	HERMANS	Holandë
Wilma	THEUWS	Holandë
Charlotte	WAGENAAR	Holandë
Dag	HALVORSEN	Norvegji
Kristin	HAUGE	Norvegji
Carl	PETERSEN	Norvegji
Gent	RAMADANI	Norvegji
Lana	AVAKUMOVIĆ	Serbi
Marko	BRKIĆ	Serbi
Vuk	MARIČIĆ	Serbi
Ana	MIHAJLOVIĆ	Serbi
Maja	BALANT SLOBODANAC	Slloveni
Samo	RUS	Slloveni
David	CORRAL HERNÁNDEZ	Spanjë
Jesus Antonio	CORTIÑAS- GUNTÍN	Spanjë

Jorge	ESTÉVEZ RODRÍGUEZ	Spanjë
Manuela	ROJAS SANTIAGO	Spanjë
Ursula	URDILLO LORENZO	Spanjë
Eva	DALEKANT	Suedi
Bengt	FRYKMAN	Suedi
Anita Mikaela	JÄRNBERT	Suedi
Johanna		
André	NILÉN	Suedi
Eva	RIMSTEN	Suedi
Helen	RONEN	Suedi
Manne Olof Oscar	WÄNGBORG	Suedi
Sascha	ALDERISI	Zvicër
Fabrizio Mario	COMANDINI	Zvicër
Giuseppe		
Johanna	ESTERMANN	Zvicër
Hans-Peter	PORTMANN	Zvicër
Halyna	BAKHMATOVA	Ukrainë
Dina	MARTINA	Ukrainë
Denys	RYBACHOK	Ukrainë
Serhii	SERZHAN	Ukrainë
Deborah	ALEXANDER	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Pedro	ALONSO	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Marta	BARBOSA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Rikardo	CANNAVO	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
John	CAVANAUGH	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Victoria	DONAHUE	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Megan	DUFFY	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Fred	FELLER	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Devontae	FREELAND	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Robert	FROST	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Rebecca	GRAHAM	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Andrew	GRIDINSKY	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Robert	HELWIG	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Mary-Margaret	HESSE	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Sheila	JAGHAB	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Oiena	LENNON	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Laura	LOCKARD	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Ann	MERRILL	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Cornelius	NOLEN	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Phebe	PHILIPS-ADEYELU	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Constance	ROBINSON	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Mary-Lynn	SFERRAZZA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Jake	SLEGGERS	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Steven	SMITH	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
James	WELLOCK	Shtetet e Bashkuara të Amerikës

### Vëzhguesit afatgjatë të MVZ-së së ODIHR-it

Gazmend	AGAJ	Shqipëri
Miroslav	BROZMAN	Republika Çeke
Valdemar	URUBA	Republika Çeke
Hanne	BANG	Danimarkë
Véronique	LASSERRE-FY	Francë
Khatchig	SOUKIASSIAN	Francë
Nadia	YAKHLAF- LALLEMAND	Francë
Hildegard	ROGLER-MOCHEL	Gjermani
Marie Luise	VON HALEM	Gjermani
Andras	RADVANSZKI	Hungari
Filip	PEJOVIĆ	Mali i Zi
Darko	PAVLOVIĆ	Holandë
Kine	RUSTEN	Norvegji
Ružica	JOVANOVIĆ	Serbi
Sigrid Marie	UTTERMAN	Suedi
Christine	BEGUELIN SARGENTI	Zvicër
Raphaël	BERGER	Zvicër
Nataliia	KHARCHENKO	Ukrainë
Azita	RANJBAR	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Patrick	REILLY	Shtetet e Bashkuara të Amerikës

### Ekipi kryesor i MVZ-së së ODIHR-it

Tana	DE ZULUETA	Shefe e Misionit	Itali
Armen	MAZMANYAN		Armeni
Marcela	MAŠKOVÁ		Republika Çeke
Caroline	GONTHIER		Francë
Stefan	KRAUSE		Gjermani
Peter	MARRON		Irlandë
Max	BADER		Holandë
Malgorzata	FALECKA		Poloni
Aleksandra	PECZSZ-OKOŃSKA		Poloni
Daniela	DIACONU		Rumani
Kira	KALININA		Federata Ruse
Valentina	KREMLEVA		Federata Ruse
Karolina	SEMINA		Federata Ruse
Ranko	VUKČEVIĆ		Serbi
Oleksandr	STETSENKO		Ukrainë
Wiktorija	WISLOWSKA		Ukrainë
Nicholas	JAHR		Shtetet e Bashkuara të Amerikës



## RRETH ODIHR-IT

Zyra për institucione demokratike dhe të drejtat e njeriut (ODIHR) është institucioni kryesor i OSBE-së që u ndihmon vendeve anëtare "të sigurojnë respektim të plotë të të drejtave të njeriut dhe lirive fundamentale, t'i përmbahen sundimit të ligjit, t'i promovojnë parimet e demokracisë dhe (...) t'i ndërtojnë, t'i përforcojnë dhe t'i mbrojnë institucionet demokratike, si dhe ta promovojnë tolerancën në gjithë shoqërinë" (Dokumenti i Samitit të Helsinkit të vitit 1992). Kjo pjesë njihet si dimension i njerëzor i OSBE-së.

ODIHR-i, me seli në Varshavë të Polonisë, u krijua si Zyrë për zgjedhje të lira në Samitin e Parisit në vitin 1990 dhe filloi me punë në maj të vitit 1991. Një vit më vonë, emri i Zyrës u ndryshua për ta pasqyruar mandatin e zgjeruar, për t'i përfshirë të drejtat e njeriut dhe demokratizimin. Sot ajo ka mbi 150 të punësuar.

ODIHR-i është organizata kryesore në Evropë në fushën e vëzhgimit të zgjedhjeve. Për çdo vit, ajo e koordinon dhe e organizon shpërndarjen e mijëra vëzhguesve për të vlerësuar se a janë zhvilluar zgjedhjet në rajonin që e përfshin OSBE-ja në përputhje me përkushtime e OSBE-së, obligimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike dhe legjislacionin kombëtar. Metodologjia e saj unike ofron një qasje të thellë në tërësinë e procesit zgjedhor. Me anë të projekteve për ndihmë, ODIHR-i u ndihmon vendeve anëtare ta përmirësojnë kornizën e tyre zgjedhore.

Aktivitetet e Zyrës në fushën e demokratizimit përfshijnë: sundimin e të drejtës, mbështetjen ligjore, qeverisjen demokratike, emigrimin dhe lirinë e lëvizjes, dhe barazinë gjinore. ODIHR-i për çdo vit zbaton një numër programesh të dedikuara për mbështetje, me të cilat synohet zhvillimi i strukturave demokratike.

ODIHR-i poashtu u ndihmon vendeve anëtare t'i përmbushin obligimet e tyre për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive fundamentale që është në përputhje me përkushtimet e OSBE-së për dimensionet njerëzore. Kjo realizohet duke punuar me partnerë të ndryshëm për ta kultivuar bashkëpunimin, për t'i ndërtuar kapacitetet dhe për të ofruar ekspertizë në fushat tematike, duke i përfshirë të drejtat e njeriut në luftën kundër terrorizmit, avancimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut të personave të trafikuar, edukimin dhe trajnimin për të drejtat e njeriut, mbikëqyrjen dhe raportimin për të drejtat e njeriut, të drejtat e njeriut të grave dhe sigurinë e tyre.

Në fushën e tolerancës dhe të mosdiskriminimit, ODIHR-i u ofron përkrahje vendeve anëtare në përforcimin e kapacitetit për t'iu përgjigjur krimeve të urrejtjes dhe incidenteve të racizmit, ksenofobisë, antisemitizmit dhe formave të tjera të mostolerancës. Aktivitetet e ODIHR-it që kanë të bëjnë me tolerancën dhe mosdiskriminimin janë të fokusuar në këto fusha: legjislacioni, trajnimet për zbatimin e ligjeve, mbikëqyrja, raportimi dhe ndjekja e përgjigjeve ndaj krimeve dhe incidenteve të motivuara nga urrejtja, si dhe aktivitete edukative për promovimin e tolerancës, respektit dhe mirëkuptimit të ndërsjellë.

OSBE/ODIHR-i u ofron këshilla vendeve anëtare për politikën e tyre që kanë të bëjnë me romët dhe sintit. Ajo e promovon ndërtimin e kapaciteteve dhe rrjetëzimin te komuniteti rom dhe ai sinti, dhe e inkurajon pjesëmarrjen e përfaqësuesve romë dhe të sinti në organet e politikë-bërjes.

Të gjitha aktivitetet e ODIHR-it realizohen në koordinim dhe në bashkëpunim të ngushtë me vendet anëtare të OSBE-së, institucionet dhe operacionet e OSBE-së në terren, si dhe me organizatat e tjera ndërkombëtare.

Më tepër informacione mund të gjeni në ueb-faqen e ODIHR-it ([www.osce.org/odihr](http://www.osce.org/odihr)).